

NJOHJE ISLAME

Autor: Ministria e Arsimit në Republikën Islamike të Iranit

Përkthyes: Medrit MUSTAFARAJ

Redaktor:
Jerida KULLA

Pjesa e parë

Njohuri mbi njeriun (1)

- * *Njohja e njeriut*
- * *Karakteri i njeriut*
- * *Njeriu dhe liria*
- * *Njeriu dhe fati*
- * *Roli i faktorëve shpirtërorë në fatin e njeriut*
- * *Qëllimi i jetës*
- * *Qëllimi i krijimit të njeriut dhe i botës*
- * *Sistemi edukativ islam*
- * *Pendimi ose rikthimi te Zoti*

Shoqata

Fladi

Njohja e njeriut

Një nga pikat më të rëndësishme, të çfarëdolloj ideologjie, është njohja e njeriut sipas pikëpamjes së saj. Çdo ideologji, në bazë të dijeve që ka mbi njeriun dhe veçoritë e tij, mundohet t' u japë përgjigje pyetjeve të komplikuar.

Pjesa e parë e këtij libri trajton pikërisht pikëpamjen islame në lidhje me njeriun.

Rëndësia e njohjes së njeriut

Njeriu është objekt studimi i shumë shkencave të ndryshme. Psikologjia, historia, biologjia, mjekësia, sociologjia dhe shkenca të tjera e studiojnë njeriun sipas këndvështrimit të tyre, por ajo që është më me rëndësi në këtë mes, është njohja e ndërlikimit të brendshëm shpirtëror. Ashtu siç dihet, të gjitha përpjekjet dhe mundimet e njeriut, si ato shkencore, edhe praktike, kryhen për një qëllim të vetëm, arritjen e lumturisë. Është e pamundur të arrihet lumturia njerëzore pa njohjen e thellë të vetë njeriut dhe veçorive të tij, nga ka ardhur dhe ku do të përfundojë. Për këtë arsye, njohja e njeriut ka përparësi, në krahasim me çdo pikëpamje tjetër. Madje mund të thuhet, pa njohjen e njeriut përpjekjet në fusha të ndryshme nuk japin rezultat.

Rëndësinë dhe vërtetësinë e njohjes së njeriut e thekson me forcë Islami dhe udhëheqës të ndryshëm shpirtërorë.

Kur'ani i Madhëruar thotë: *“O besimtarë! Ju keni përgjegjësi vetëm për veten tuaj! Ai që është i humbur nuk mund t'ju dëmtojë, nëse jeni në rrugë të drejtë. Tek Allahu do të ktheheni të gjithë e do t'ju lajmërojë për atë që keni punuar.”* (El-Maide: 105)

Imam Aliu, në lidhje me këtë çështje, thotë: “Njohja e vetvetes është dija më e mirë.” Nga pikëpamja islame, njeri perfekt është ai që e njeh veten e tij më mirë se sa të tjerët njohin atë. Për ta sqaruar më mirë vetënjohjen, do të trajtojmë lidhjet që ajo ka me pika të tjera kyçe njohjeje në përgjithësi.

Lidhja e njohjes së njeriut me njohjen e Zotit

Njëra nga rrugët më të mira për njohjen e Zotit është vetënjohja. Çdo dukuri apo fenomen, me të gjitha cilësitë dhe veçoritë e tij, kur ndodh ose prezantohet është pasqyrë e krijuesit të vet. Është e qartë se, sa më e përsosur të jetë dukuria apo krijesa, madhështia e vetë krijuesit duket më qartë dhe më lehtë. Edhe Kur'ani Fisnik e vë në dukje këtë cilësi në suren “Edh-Dhariat, në ajetin 20-21: *“Ne e kapëm atë me ushtrinë e tij dhe e hodhëm në det; ai e meritoi. Mësim ka edhe në historinë e fisit Ad, kur i dërguam erën shkatërruese.”*

Duke pasur parasysh që shpirti i njeriut ka një madhështi dhe përsosmëri tepër të lartë, aq sa nuk mund të krahasohet me asnjë krijesë tjetër, kjo mund të merret edhe si një nga shenjat më të dukshme të Krijuesit të vet.

Pejgamberi Muhammed (paqja dhe bekimi i All-llahut goftë mbi të), në lidhje me këtë, ka thënë: *“Kushdo që njeh veten, padyshim që njeh edhe Krijuesin e vet (Zotin).”* Sigurisht që njohja e Zotit ka shkallë dhe nivele të ndryshme, ku çdo njeri, mbi bazën e kapacitetit të tij mendor dhe shpirtëror, mund t'i arrijë këto nivele.

Lidhja midis njohjes së njeriut dhe profetëve

Vetënjohja me profetët lidhet në dy mënyra:

1- Fakti se njeriu, për të arritur nivele të larta të përsosmërisë dhe të lumturisë së vërtetë, ka nevojë për udhëheqjen e profetëve, tregon qartë për lidhjen që ekziston midis vetënjohjes dhe profetëve. Pa udhëheqjen profetike është e pamundur që njeriu të gjejë lumturinë e vërtetë. Gjithashtu, ekziston dhe lidhja e anasjelltë se vetënjohja ka nevojë për një drejtim të saktë profetik. Në këtë kontekst, ekzistenca e lidhjes forcohet edhe më shumë.

2- Duke pasur parasysh se mes njerëzve ka pasur të tillë që kanë arritur shkallët profetike, kjo në vetvete është një vetënjohje. Grupe njerëzish, bashkëkohës të profetëve, duke mos pasur të tillë vetënjohje, vunë në dyshim lajmin profetik dhe nuk i besonin profetëve, duke thënë: “Në qoftë se Zoti do të vendosë ndërmjetës midis njerëzve dhe Vetes, përse nuk ka zgjedhur engjëjt për këtë detyrë? Si ka mundësi që njeriu të komunikojë me Zotin dhe më pas Zoti ta zgjedhë atë si ndërmjetës midis Vetes dhe gjithë njerëzimit, krijesave të veta?”

Lidhja e vetënjohjes me Ditën e Gjykimit

Dita e Gjykimit, gjithashtu, ka lidhje të drejtpërdrejtë dhe të thellë me vetënjohjen.

Shpirti, si diçka e pashkatërrueshme, mund të qëndrojë në mënyrë të pavarur nga trupi, deri në kohën e ngritjen së përgjithshme, në Ditën e Gjykimit, duke iu drejtuar jetës së Përjetshme.

Pra, në këtë kontekst, shpirti, si e vërtetë jo materiale dhe i pashkatërrueshëm, i jep kuptim më të thellë Ditës së Gjykimit dhe, po ashtu, përbën pjesën më thelbësore të vetënjohjes. Si përfundim, në bazë të kuptimit themelor të shpirtit, duket qartë lidhja që ka vetënjohja me Ditën e Gjykimit.

Lidhja e njohjes së njeriut me edukatën

Një çështje tjetër, që tregon për rëndësinë e njohjes së njeriut, është efekti i pamohueshëm që kjo njohje krijon në sjelljen e njeriut. Ky efekt mund të trajtohet, të paktën, në dy drejtime kryesore.

1- Në qoftë se njeriu kërkon ta njohë veten ashtu siç është, duhet të hedhë një shikim në të kaluarën e tij të largët, për të parë se çfarë ka qenë dhe në çfarë periudhash ka kaluar. Në një kohë të largët njeriu ka qenë dhe më vonë transformohet në bimë dhe lëndë ushqimore dhe më pas kalon në trajtën e spermës dhe të një pike uji pa vlerë dhe, pas disa shkallëve të tjera transformimesh, shfaqet si njeri me karakteristika të plota. Ky fakt i pamohueshëm, por që rrallë përmendet në ndonjë faqe libri, përbën thelbin e një edukatë të mirëfilltë. Pra, njeriu, duke pasur parasysh që është krijuar nga një lëndë e përbuzur, e pistë dhe e pavlerë, mund ta përdorë këtë fakt në mënyrë të shkëlqyer për të frenuar egon, mburrjen, si dhe të gjitha veset e shëmtuara të kësaj familjeje.

Imam Aliu (paqja dhe bekimi i All-llahut qoftë mbi të), ka thënë: *“Njeriu nuk ka arsye pse të mburret, duke pasur parasysh që është krijuar nga një pikë sperme dhe në fund të jetës është një kërmë me erë të keqe, po ashtu, edhe gjatë jetës nuk mund t’i sigurojë dot të ardhurat materiale në mënyrë të pavarur, si dhe vdekjen nuk mund ta shmangë dot.”*

2- Një përfundim tjetër me rëndësi, që mund të dallojë njeriu tek vetënjohja është që të jetë i informuar për madhësinë e shpirtit, si dhe të dijë të vlerësojë veçoritë që i janë falur. Në qoftë se njeriu vihet në dijeni dhe mëson se, pas atij krijimi dhe fundi, i janë falur edhe veçori të pabesueshme, si dhe talente të shkëlqyera, të cilit i japin një vend me vlerë më të lartë nga të gjitha krijesat e tjera të Zotit. Për këtë arsye njeriu nuk do ta krahasonte kurrë veten e tij me një kafshë, si dhe t’ia dorëzonte kërkesat e veta arsyes së një kafshe. Njeriu do ta ndiejë madhësinë e shpirtit të vet në kohën kur do të dijë të vlerësojë dhuntitë që Zoti i ka falur atij.

Iman Aliu (paqja dhe bekimi i All-llahut qoftë mbi të), në lidhje me këtë pikë, është shprehur: *“Ai njeri, që ndien në vetvete superioritetin e madhështisë së shpirtit, asnjëherë këtë cilësi të lartë nuk e shndërron në mëkate materiale të kësaj bote.”*

Prandaj, njohja e njeriut e vë në dijeni atë për vlerën e ekzistencës së vet dhe kjo bëhet shkak që ai ta shikojë botën materiale nga një këndvështrim tjetër më i lartë dhe si rezultat të mos njolloset nga papastërtitë dhe mëkatet e kësaj bote, përkundrazi, këtë cilësi ai e shfrytëzon si një mburojë për t’i bërë ballë sfidave të jetës. Po ashtu, edhe e anasjella e kësaj çështjeje është e vërtetë, ku një njeri, që personalitetin e tij njerëzor e ka humbur, është më tepër i predispozuar për të përvetësuar vese negative. Për këtë çështje, imam Hadi (paqja dhe bekimi i All-llahut qoftë mbi të), është shprehur: *“Mos ki besim tek ai njeri që e ka humbur personalitetin e tij shoqëror.”*

Lidhja e njohjes së njeriut me ligjet shoqërore

Të gjitha ligjet shoqërore, si: ligjet e drejtësisë, ligjet ekonomike, politike etj, janë të lidhura ngushtë me njohjen e njeriut, domethënë derisa njeriu të mos njohë me saktësi vetveten, nevojat dhe lidhjet e tij mbeten ende të panjohura, si dhe ligjet e nevojshme për të mbeten të paqarta. Po ashtu, edhe zbatimi i tyre në atë formë nuk do të sillte mirëqenien dhe lumturinë që kërkon. Është e vërtetë, që në dritën e Zotit të Madhëruar mund të gjejmë dhe të pranojmë të tilla ligje, por të kuptuarit drejt e tyre mbetet dimension i njohjes së njeriut. Duke përmbledhur ç’ka thamë më lart, themi: E gjithë njohja islame në përgjithësi lidhet ngushtë me njohjen islame të njeriut, sa mund të themi që vetënjohja është një pasqyrë ku njohja islame duket tepër qartë. Njohja e njeriut është aq e rëndësishme, saqë mund të konsiderohet si baza ose themeli i të gjitha shkencave shoqërore dhe dijeve njerëzore, sepse në të gjitha këto

njohuri shoqërore, në përgjithësi, trajtohet vetë njeriu dhe prezenca e njohjes së tij duket qartë.

Karakteri i njeriut

Një nga pyetjet më kryesore, në lidhje me njeriun, është: A është njeriu i pajisur me cilësi shpirtërore qëkur lind apo është një tablo e bardhë, ku nuk është vizatuar asgjë e më pas ajo mbushet me çfarëdolloj shkrimi e vizatimi?

Çdo përgjigje që japim, i jep përgjigje të gjitha çështjeve të njohjes së njeriut. Për t'i dhënë një përgjigje të saktë kësaj pyetjeje, më parë do të krahasojmë njeriun me kafshët.

Të përbashkëtat e njeriut dhe kafshëve

Fëmija, kur lind, është i pajisur me disa instinkte, të cilat, me kalimin e kohës, zhvillohen dhe bëhen më të shumëllojshme, për shembull: kur fëmija është i uritur, kërkon qumështin e nënës, ndërsa gradualisht, duke u rritur vihet në kërkim të ushqimeve të tjera. I njëjtë është edhe instinkti i vetëmbrojtjes, i cili e shmanget fëmijën nga rreziqe të ndryshme. Me kalimin e kohës fëmija bëhet i vetëdijshëm dhe më luftarak, kështu që mund të përballojë rreziqe dhe shqetësime të shkallëve më të larta. Këto instinkte ekzistojnë edhe tek kafshët, janë plotësisht të lindura dhe të pamësuar. Pra, instinktet janë pjesa e përbashkët midis njeriut dhe kafshëve. Për këtë arsye njeriu shpesh klasifikohet si vazhdim i dimensionit të kafshëve.

Të veçantat midis njeriut dhe kafshëve

Studimi i jetës së njerëzve ka treguar më së miri se ekzistojnë ndryshime thelbësore midis njerëzve dhe kafshëve, ku mund të klasifikohen në dy grupe të ndryshme.

1- Ndryshimi i parë dhe më themelor është se njeriu vepron në bazë të një logjike dhe zgjedhjes, pra, në bazë të këtij boshti ndërton jetën e vet, gjë që nuk ekziston te kafshët. Madje njeriu është në gjendje të mposhtë disa instinkte mbi bazën e zgjedhjes dhe të logjikës dhe të veprojë në kundërshtim me instinktin e shfaqur.

2- Besnikëria ndaj vlerave njerëzore është një tjetër cilësi, që njeriun e dallon nga kafshët. Disa vlera, si: kërkimi i së vërtetës, dashuria, sakrifica, ndjenja e mirësisë, që janë në kundërshtim me egon e njeriut, nuk mund të shpjegohen dot nëpërmjet botës materiale.

Bota materiale nuk është në gjendje të shpjegojë martirizimin dhe sakrifikimin e jetës për qëllime me vlera të larta, jashtë kuadrin të instinkteve. Pra, këto vlera, që njeriu i qëndron besnik, nuk perceptohen dot te kafshët dhe janë në nivele më të larta, pasi kafshët kanë një kapacitet të kufizuar. Këto lloj cilësish, që u përmendën më lart, në çfarëdolloj shoqërie vlerësohen lart dhe konsiderohen të shenjta, dhe gjithmonë janë bërë objekt nderimi për të tjerët. Pra, çdo njeri, që zotëron më shumë cilësi të tilla, konsiderohet si më i plotë dhe më perfekt.

Kuptimi i karakterit

Siç u pa edhe më lart, njeriu përbëhet nga dy grupe cilësish, grupi i parë ishte grupi i instinkteve, që ishte i përbashkët midis njerëzve dhe kafshëve, kurse grupi tjetër ishte grupi i cilësive “të larta”, që ishte veçori vetëm e njerëzve. Në këtë kontekst, është grupi i dytë, grupi i cilësive të “larta”, ai që specifikon karakterin e njeriut, sepse grupi i parë nuk është në gjendje të përcaktojë karakterin e njeriut. Grupi i dytë, i cilësive të larta, ekziston që me lindjen e njeriut, pra, është i formuar në gjendjen e tij fillestare, por me kalimin e kohës dhe me pjekurinë e njeriut këto cilësi gradualisht fillojnë të lulëzojnë dhe të dallohen qartë. Pra, karakteri i njeriut, në fillimin e jetës së

tij, ekziston në mënyrë metaforike në formën e vezëve, të cilat, me kalimin e kohës, zhvillohen me anë të një edukimi të mbarë dhe të saktë. Në qoftë se njeriu, me një edukim të rregullt, arrin t'i zhvillojë në shkallë sipërore këto cilësi, thuhet se ka arritur "vlerat njerëzore", ndërsa, nëse ai, me anë të një edukimi të vakët apo të një keqedukimi, i zhvillon këto cilësi në kah negativ, thuhet se është transformuar.

Tani jemi në gjendje t'i përgjigjemi pyetjes së trajtuar në fillim të këtij kapitulli: A është njeriu i pajisur me cilësi shpirtërore qëkur lind apo është një tablo e bardhë, ku nuk është vizatuar asgjë e më pas ajo mbushet me çfarëdolloj shkrimi e vizatimi? Përgjigjja është e qartë, njeriu, që në fillim të lindjes, është si një tablo e bardhë, ku mund të vizatohet çfarëdolloj figure. Vërtet që në fillim karakteri i tij është i përcaktuar, por është i pa zhvilluar në aspektin pozitiv të tij. Pra, njeriu ka të injektuar që në fillim shpirtin dhe aftësitë e të përsosurit, por i duhet shumë punë për arritur këtë përsosmëri.

Dimensionet e karakterit

Tani, që u qartësua kuptimi i karakterit, do të përpiqemi të trajtojmë dimensionet e ndryshme të tij, ku te disa prej tyre do të ndalemi më hollësisht.

1- Drejtësia apo kërkimi i së vërtetës, është një nga dimensionet kryesore të karakterit, që në vetvete përbën një forcë të brendshme tërheqëse në drejtim të së vërtetës. Që në kohët e lashta, dëshira për të gjetur të vërtetën e ka shtyrë njeriun, që, pavarësisht vështirësive që haste, të përparonte në drejtim të dijes dhe të pranonte mendimet e dijetarëve të ndryshëm, sepse një gjë e tillë e qartësonte dhe e bindte për diçka që ishte e paqartë dhe që e vërteta në lidhje me të nuk dihej.

Kjo tregon që, kur njeriu arrin të njohë të vërtetën, ndien kënaqësi, që është edhe forca motorike që e vë në lëvizje për probleme më të thella. Duhet theksuar se njerëzit, që këtë veçori e kanë më të theksuar dhe e kanë të zhvilluar në nivele më të larta, ndiejnë kënaqësi më të madhe në rastet kur gjejnë një të vërtetë. Për shembull, shkencëtarët, filozofët dhe çdokush që merret me kërkime, këtë veçori e kanë më të zhvilluar se të tjerët dhe e kanë mbajtur gjallë në brendësi të tyre duke e kultivuar me kujdes. Pjesë të autobiografive të njerëzve të mëdhenj tregojnë për forcën e madhe tërheqëse që zotëron ky dimension i karakterit.

Kërkimi i së vërtetës te fëmija shfaqet në formën e kureshtjes, duke bërë herë pas here pyetje të ndryshme. Në qoftë se ky lloj dimension i zhvillohet në kah pozitiv, fëmija arrin kulmin e kureshtjes, që gjithmonë është në gjendje të aktivizuar dhe e shqetëson atë. Një dimension i tillë ka ekzistuar te njeriu në të gjitha kohërat, duke u klasifikuar si virtyt i lartë.

Po ashtu, njerëzit që përpiqeshin ta zhvillonin më tej këtë dimension, siç është rasti i shkencëtarëve, kanë qenë të respektuar nga masa e gjerë.

Nga ana tjetër, njerëzit që ishin pronarë të pasurive të mëdha, asnjëherë nuk e kanë arritur atë shkallë shoqërie që u mundësonte dimensionin e kërkimit të së vërtetës. Rruga për mbajtjen gjallë të këtij virtyti të shenjtë është dorëzimi dhe heqja dorë nga çdo lloj kundërshtimi dhe rezistence përballë së vërtetës. Ai njeri, që këtë virtyt e ka të zhvilluar në kahun negativ, gjithmonë shfaq rezistencë dhe dyshim në lidhje me të vërtetën dhe nuk e pranon atë. Ai, këtë pishtar të shenjtë, e mban të fikur brenda vetes.

2- Dëshira për të bërë mirë: Kuptimin e kësaj shprehjeje do ta shpjegojmë në dy drejtime, atë personal dhe atë shoqëror. Cilësitë, si guximi për të bërë mirë, dëshira për rregullin, etj., përbëjnë drejtimin personal të dëshirës; kurse cilësitë, si: ndihma për tjetrin, sakrifica, të ardhurit keq, të bërit shoqëri, etj., përbëjnë grupin shoqëror të këtij dimension. Njeriu, sa më shumë ta ketë të zhvilluar dëshirën për të bërë mirë, aq

më shumë ai ndien gëzim dhe kënaqësi pas një veprimi të tillë. Për këtë arsye, tek persona të ndryshëm, kënaqësia dhe gëzimi janë të ndryshme.

Njerëzit, që më tepër kanë të zhvilluar instinktet trupore, ndiejnë kënaqësi vetëm në rast të plotësisht të dëshirave të tyre trupore dhe nuk mund të shikojnë dot me larg se kaq dhe nuk janë në gjendje të konceptojnë dot se çfarë është sadakaja (ndihma për njerëzit në nevojë).

3- Pëlqimi i së bukurës, është një tjetër dimension i karakterit të njeriut. Edhe kjo cilësi është vendosur në shpirtin e tij në mënyrë të tillë që ai të ndiejë kënaqësi kur përballet me diçka të bukur. Njeriu, jo vetëm kënaqet nga bukuritë e natyrës, por edhe nga bukuria e krijimit, p.sh: të bukurën nuk e gjejmë vetëm në art, po edhe te prodhimi i produkteve të ndryshme. Edhe në krijimin e njeriut kemi të bëjmë me një bukuri, që njeriu nuk mund të tregohet indiferent. Kjo gjë vërteton edhe faktin se njerëzit, që në kohët e hershme i pëlqenin artet e bukura. Gjetja e figurave dhe e pikturave të shumëllojshme në shpella e vërteton këtë. Edhe Kur'ani i Madhëruar e thekson këtë fakt, duke cituar se bukuritë e botës janë në dispozicion të njeriut falas. Bukuria ndahet në disa grupe:

a) Bukuria e ndjeshme është ajo lloj bukurie që mund të perceptohet me ndihmën e pesë shqisave njerëzore, si për shembull: piktura, muzika, etj.

b) Bukuria shpirtërore, në vetvete, ndahet në dy nëngrupe, ku nëngrupi i parë përfshin vetë kuptimin e fjalës, si për shembull: bukuria e krijesave të ndryshme, ekuilibri i saktë që është vendosur kudo, etj. Nëngrupi i dytë ka të bëjë me bukuritë e një shkalle më të lartë, që i bashkëngjiten shpirtit, siç janë: pastërtia shpirtërore, drejtësia, trimëria, durimi, etj. Njeriu, sa më i pastër të jetë nga pikëpamja shpirtërore, aq më shumë i ndien dhe i kupton këto lloj bukurish, në krahasim me bukuritë e ndjeshme. Po ashtu, ky njeri është në gjendje të dallojë me saktësi edhe të shëmtuarat, si për shembull: gënjeshtrenë, tradhtinë, egon, shtypjen, agresionin, të cilat i sjellin një ndjenjë të fortë urrejtjeje. Prandaj, ai asnjëherë nuk do të donte që të ndotej në të tilla cilësi të shëmtuara. Shembulli më i mirë për bukurinë shpirtërore janë vetë ajetet kur'anore. Kur'ani i Madhëruar është ndërtuar në mënyrë të tillë, që, si nga pikëpamja kuptimore, (detyrat, të drejtat, mendimet filozofike dhe shkencore), ashtu edhe nga pikëpamja e bukurisë së fjalës, nuk mund të krahasohet me asgjë.

Për këtë arsye Kur'ani gjen vend menjëherë në zemrat e njerëzve dhe krijon në to revolucione shpirtërore, duke i mbushur me dashuri dhe shpresë. Ky ka qenë edhe fakti i revolucioneve të kundërshtarëve të Islamit në përgjithësi, që kanë ndërruar mendje dhe kanë përqafuar Islamin, kur janë përballur me ajetet kur'anore. Pra, bukuria e Kur'anit ka qenë ajo që e ka mbajtur të gjallë vetë Kur'anin gjatë shekujve dhe ka qenë objekt kënaqësie për njerëzit.

4- Nevoja për t'u falur: Njeriu, në thellësi të shpirtit të tij, në mënyrë të pavetëdijshme zotëron një ndjenjë, ku cilësi më të larta se të tijat, të një krijesë tjetër, kërkon t'i arrijë dhe e ndien veten më poshtë se dikush tjetër është me perfekt se ai. Për arsye të këtij perfeksionimi, krijesa perfekte bëhet objekt adhurimi për të.

Në rast se njeriu i afrohet gjithmonë e më shumë asaj, por që për të është e paarritshme, ajo shndërrohet në idhull dhe te njeriu, ndjenja e të qenit i varur prej saj, është gjithmonë e theksuar. Shpjegimi i mësipërm, në vetvete, nuk është gjë tjetër veçse ndjenja për t'u falur një krijesë të tillë kaq perfekte.

Ky lloj dimension i është induktuar në shpirtin e njeriut që në krijimin e tij, pavarësisht se tek njeriu shfaqet vonë dhe në fillimet e tij nuk dallohet qartë. Pra, në të vërtetë, ky dimension është forca motorike që vë në lëvizje njeriun në drejtim të përmirësimit të tij total, duke përballuar vështirësi të ndryshme. Nevoja për t'u falur ka ardhur si domosdoshmëri që njeriu të zhvillohet e të këtë mundësi të përparojë pozitivisht. Por

lind pyetja: Cilës krijese ka nevojë t'i afrohet njeriu dhe a e shikon atë gjithmonë perfekte, që ta ketë shembull në rrugët e jetës? Më parë ne kemi shpjeguar se vetë njeriu, midis krijesave të tjera, është një krijesë që ka një pozicion shumë të lartë, për veçoritë e tij shpirtërore dhe është krijesa më perfekte nga të gjitha. Në këtë kontekst, njeriu nuk ka nga të marrë shembull dhe të ketë idhull ndonjë prej tyre, sepse vetë ai është në një nivel më të lartë. Në bazë të kësaj logjike, përgjigjja është fare e qartë, që njeriu ka nevojë të arrijë vetë krijuesin e tij, që nuk është gjë tjetër përveç Zotit dhe për këtë arsye ai gjithmonë është në zhvillim. Pra, mund të themi se në bazë të dimensionit të nevojës për t'u falur, që ekziston në karakterin e tij që në lindje, njeriu, në një farë mënyrë, e njeh praninë e Zotit dhe lidhjen me të e ka në mënyrë të pavetëdijshme, por nuk është në gjendje ta sinkronizojë saktë se me çfarë ndjenje ka të bëjë. Me kalimin e kohës dhe me zhvillimin e këtij dimensionit në kahun pozitiv, njeriu gjithmonë e më tepër bëhet i vetëdijshëm për praninë e krijuesit të vet. Të gjitha dimensionet e karakterit të njeriut, duke përfshirë edhe ato më kryesoret, që trajtuam më lart, tregojnë qartë përpjekjen e njeriut për të arritur në një stad më perfekt nga ai që ndodhet, pra, kërkon përmirësimin e vetvetes në të gjitha dimensionet e karakterit të tij. Më lart ne treguam se përsosmëria e njeriut kishte lidhje të drejtpërdrejtë me nevojën për t'u falur dhe adhuroar Zotit. Në këtë kontekst, nxjerrim si përfundim se nevoja për t'u falur Zotit është nëna e të gjitha dimensioneve të tjera dhe baza e karakterit të njeriut. Ky fakt, edhe njëherë demonstroi qartë pozicionin e lartë të njeriut si krijesë e Zotit.

Konflikti midis logjikës dhe trupit

Ndonjëherë, midis instinkteve trupore dhe dimensioneve të karakterit, ndodhin konflikte: domethënë, dëshirat, që vijnë si rrjedhojë e instinkteve trupore, janë në kundërshtim me dëshirat që cilësitë e larta njerëzore i diktojnë njeriut. Këto, në gjuhën psikologjike quhen konflikte të brendshme midis logjikës dhe trupit.

Ka njerëz që instinktet trupore, (që janë të përbashkëta midis njeriut dhe kafshës) mbizotërojnë, në krahasim me cilësitë e karakterit të tij në rast konflikti. Vendimet që do të marrë ky njeri do të diktohen nga instinktet e tij të theksuara.

E kundërta do të ndodhë me një njeri që ka më të zhvilluar dimensionet e karakterit, ku përdor logjikën para se të marrë vendim. Nga një pikëpamje tjetër, që mbështetet edhe nga botëkuptimi islam, ky lloj konflikti mund të përkufizohet si konflikti midis shpirtit dhe trupit. Në raste të tilla, njeriu duhet të veprojë në mënyrë të tillë që të mos dëmtohet identiteti i tij njerëzor, edhe në qoftë se instinkti kërkon një veprim të kundërt. Pra, në qoftë se njeriu ndodhet brenda një konflikti të tillë dhe vepron mbi bazën e diktatit të instinkteve të tij, ai e ka humbur humanizmin e tij dhe tashmë është shumë i ngjashëm me një kafshë. Në të vërtetë, veprimet e njeriut janë funksion i përbërë nga këto dy lloje dëshirash dhe nevojash. Në qoftë se njeriu nuk do që të bjerë pre e vendimeve të papajtueshme me identitetin e tij, rruga më e mirë për të është të mendohet duke gjykuar thellë në të gjitha dimensionet dhe pastaj të marrë një vendim. Për këtë gjë njeriu duhet të mbajë të zgjuara dimensionet e larta të karakterit të tij, duke qenë i sigurt se, të tilla dimensione, do ta çojnë në vendime të sakta dhe të pagabueshme.

Islami, pasqyrë e karakterit

Islami, në qendër të vëmendjes, ka mbarëvajtjen dhe zhvillimin e karakterit të njeriut, ose siç mund të thuhet ndryshe, Islami është feja e karakterit. Feja islame ka vendosur një ekuilibër midis të gjitha dimensioneve të karakterit dhe instinkteve të tij dhe asnjë nga këto nuk e mban të ndrydhur, duke krijuar kështu kushte të favorshme për

zhvillimin e tyre paralel. Në mësimet islame mund të gjenden shumë shembuj që përmbajnë këshilla dhe instruksione për zhvillimin e secilit prej dimensioneve të karakterit. Të gjitha këto tregojnë qartë se mësimet islame bazohen në karakterin e njeriut.

Po ashtu, në Islam, me të njëjtin kujdes dhe përpikëri trajtohen edhe instinktet trupore të njeriut. Arsyeja e kësaj vëmendjeje është se feja islame u dërgua nga Ai që e krijoi karakterin e njeriut dhe vetë njeriun, për ta udhëhequr atë deri në fund.

Këto tregojnë se ekziston një përputhje dhe harmoni e plotë midis krijimit (ekzistencës, gjenezës) dhe vendosjes së ligjeve të Islamit, pra, gjithçka është në ekuilibër të përsosur. Edhe Kur'ani i Madhëruar, në lidhje me këtë pikë, sqaron: **“Drejtohu me përkushtim në fenë e pastër monoteiste, natyrën fillestare, në të cilën All'lahu i ka krijuar njerëzit.”** ("Sure Rrum", ajeti 31)

Islami është një fe që nuk njeh ngjyrë vjetërsie, nuk plakët.

Plakje dhe dalje jashtë kohës do të kishim në rast se nuk do të ekzistonte karakteri i njeriut me të gjitha dimensionet e veta. Ligjet, traditat dhe zakonet, që shoqëri të ndryshme vendosin mbi njerëzit, do të bëhen pre e harresës dhe e zëvendësimit të tyre, nëse këto ligje nuk përputhen me karakterin e njeriut dhe nuk janë për ngritjen dhe zhvillimin e tij në përgjithësi. Përkundrazi, ligjet që vendosen në bazë të nevojave të karakterit të njeriut dhe i japin gjithmonë përgjigje atij në çdo kohë është e pamundur të vjetërsohen.

A mund të imagjinohet ndonjëherë që dimensionet e karakterit të njeriut, si për shembull kërkimi i së vërtetës, drejtësia, pastërtia njerëzore, guximi, etj, si këto, të bëhen të pavlera për njeriun?

Kjo është arsyeja që feja qiellore dhe ligjet e saj, me kalimin e shekujve, nuk vjetërsohen, por përkundrazi, vlera e saj mbetet përherë e vlefshme për njerëzit.

Njeriu dhe liria

Një nga pikat kryesore të njohjes së njeriut është liria e tij. Kuptimi i lirisë është pikërisht i kundërt me detyrimin, domethënë, njeriu mund të veprojë me dëshirën e tij ose mund ta detyrojë të kryejë një veprim pa dëshirën e tij, pra, kur është vetë shkaktar i një veprimi me vetëdije ose kur kemi të bëjmë me forca të tjera të jashtme që nuk kanë të bëjnë me këtë njeri që vepron.

Nuk duhet harruar se fjala liri nuk nënkupton që njeriu mund të bëjë ç'të dojë, po ashtu të gjitha veprimet që ndodhin gjatë një kohe të caktuar tek një individ nuk kanë ardhur tërësisht si rrjedhojë e lirisë së tij, pra, dëshira dhe preferencat e tij nuk kanë pasur rolin më të vogël në këto ngjarje. Duhet theksuar se tërësia e vlerave të karakterit të njeriut lidhet ngushtë me lirinë e tij dhe prania e lirisë bën të mundur zgjerimin e dimensioneve të karakterit dhe asnjëherë nuk mund të zhvillohen më lart se sa e lejon liria. Njeriu ka për detyrë të aplikojë dëshirën dhe lirinë që ka.

Në bazë të këtij arsyetimi mund të themi se kushti më i rëndësishëm dhe më i domosdoshëm që njeriu të arrijë lumturinë e merituar nuk është gjë tjetër veçse zgjedhja e lirisë dhe e dëshirës së tij.

Liria si një koncept i perceptueshëm

Liria është vendosur në shpirtin e njeriut si një nga aksiomat themelore të tij dhe nuk ka nevojë për ndonjë arsyetim apo vërtetim të veçantë për ekzistencën e saj. Asnjë nga shkencat natyrore nuk është në gjendje të japë ndonjë shpjegim të saktë për të.

Arsyeja, që këto shkenca nuk e përfshijnë dot në logjikën e tyre lirinë e njeriut, është se këto shkenca veprojnë në bazë të arsyetimeve logjike dhe eksperimenteve të përsëritura. Pra, në qoftë se tema, që do të merret në analizë, nuk do të jetë e

suksesshme në këtë vijë arsyetimi ose nga pikëpamja eksperimentale, atëherë vetë shkenca nuk do të jetë në gjendje t'i japë kuptim kësaj teme që analizohet. Në brendësi të njeriut ka disa ndjenja shpirtërore që, shkencat që ne njohim dhe aplikojmë përditë, nuk u përgjigjen dot pyetjeve tona në lidhje me to. Pra, këto ndjenja nuk kanë nevojë për ndonjë vërtetim, sepse njeriu, në mënyrë të drejtpërdrejtë i ka të bashkangjitura në karakterin e tij dhe është i vetëdijshëm për ekzistencën e tyre, siç është i vetëdijshëm për ekzistencën e vetvetes. Për shembull, njeriu gëzohet, ndien frikë dhe për këto ndjenja ai mund të shpjegojë vetë gëzimin, frikën, e të tjera si këto pa pasur nevojë për ndonjë shkencë të përparuar, ose ndonjë ndërmjetës tjetër që të na vejë në dijeni për ekzistencën e tyre. E vërteta është se njeriu është në gjendje të vetëperceptojë me saktësi absolute dhe pa pikë dyshimi se me cilën ndjenjë ka të bëjë sipas rastit. Nëse dikush do t'ju pyeste se me çfarë arsye e vërtetoni ju gëzimin apo trishtimin tuaj, ju si do t'i përgjigjeshit? A ka ndonjë lloj arsyetimi logjik për të vërtetuar një gjë të tillë? Natyrisht që jo.

Dëshira është një e vërtetë që njeriu e ka pranuar dhe e njeh në brendësinë e tij. Për ta kuptuar më mirë këtë gjë po japim një shembull të thjeshtë: Supozoni një njeri që është i sëmurë me të dridhura të forta dhe nuk i kontrollon dot duart e tij, pra, duart e tij veprojnë në mënyrë jo normale dhe me një farë detyrimi. Në rast se ky njeri do të kryejë një punë, do t'i nënshtrohet dëshirës së tij, për shembull në zhvendosjen e një objekti nga tryeza për në një vend tjetër. Veprimi i parë i ngritjes së objektit është i detyruar, kurse se në ç'vend do ta vendosë atë është në dëshirën e personit. Këto gjëra janë të mirënjohura nga njeriu. Megjithëse dëshira tek njeriu dallohet qartë, ka disa faktorë që tregojnë ekzistencën e saj. Disa prej tyre do t'i diskutojmë më poshtë:

1- Të menduarit dhe të duruarit: Në momente të ndryshme, njeriu, përpara se të kryejë një veprim, mendohet duke e vlerësuar nga shumë pikëpamje dhe në shumë raste qëndron në pritje, duke duruar presione të ndryshme derisa ta kryejë atë. Arsyeja, që njeriu vepron në këtë mënyrë, është se ai është plotësisht i lirë në zgjedhje dhe është i shqetësuar se mos gabon, pra, mendimi dhe durimi tek njeriu janë tregues të lirisë në zgjedhje tek ai.

2- Turpi dhe pendimi: Një tregues tjetër i ekzistencës së lirisë te njeriu është ndjenja e turpit dhe e pendimit. Në qoftë se njeriu nuk do të gëzonte lirinë në veprimet e tij, ai asnjëherë, pas kryerjes së ndonjë veprimi, nuk do të pendohej apo do të turpërohej për gabimin që mund të bëjë. Pra, vetë ndjenja e turpit dhe e pendimit merr kuptim vetëm kur njeriu mund të zgjedhë para se të veprojë.

3- Përgëzimi dhe ndëshkimi: Po ashtu, edhe ky grupim rregullash në shoqëri thekson me forcë për lirinë që ka njeriu në zgjedhjen e tij. Është e qartë se përgëzimi, vlerësimi material, pozitiv apo negativ, si dhe ndëshkimi janë disa rregulla në çfarëdolloj shoqërie njerëzore, që kanë kuptim vetëm në rast se njeriu ka mundësi të zgjedhë me kushte të lira. Asnjë dijetar nuk do ta pranonte, për shembull, ndëshkimin në kushte të një veprimi të detyruar dhe pa dëshirën e vepruesit.

4- Sistemi i arsimimit dhe i edukimit: Nuk ka asnjë dyshim se, në shoqëritë njerëzore, ekzistojnë sisteme zinxhir të mirëorganizuara edukimi dhe arsimimi, për të vetmin qëllim që njeriu të ketë mundësi për të vepruar në mënyrë të drejtë dhe të rrisë aftësinë e tij në zgjedhje. Në qoftë se ai nuk do ta kishte një liri të tillë në zgjedhje, a do të kishte vend për edukimin e tij?

Mos kundërshtimi i lirisë në zgjedhje

Liria në zgjedhje, tek njerëzit, është një fakt i pamohueshëm. Megjithatë, në shoqëri të ndryshme, ka njerëz që e hedhin poshtë këtë fakt dhe nuk e pranojnë që njeriu mund të zgjedhë i lirë. Për këtë sjellin fakte dhe arsyetojnë në një mënyrë absurde, sa

mohojnë dhe ekzistencën e tyre. Ka të tjerë që e mohojnë me fjalë, por në praktikë, kur vihen përballë veprimit, detyrohen ta pranojnë në një farë forme, gjë që tregon se vetë ata, në thellësinë e brendësisë së qenies së tyre, e pranojnë këtë fakt të pamohueshëm. Shkencëtari i madh islam, Abu Ali Sina (Aviçenca), në lidhje me këtë temë shpjegon: “Mënyra më e mirë për të bindur njerëz të tillë është të atakohesh në mënyrë të drejtpërdrejtë me ta dhe të argumentosh se nuk është zgjedhja juaj, por se ishit të detyruar të përballëshit me njëri-tjetrit, kështu që ata do ta kuptojnë hilen dhe do të zgjohen nga kjo gjendje e plogët mendimi.”

Liria dhe filozofia profetike

Baza e të gjitha feve qiellore është aftësia që ka njeriu për të zgjedhur. Kjo liri në zgjedhje nuk është e kufizuar nga asnjë faktor fizik ose natyror. Kjo përbën pikën mbështetëse të feve, së bashku me sistemet përkatëse edukativo-morale. Siç dihet, në kohët e hershme, profetët, njëri pas tjetrit, e kanë ftuar njerëzimin drejt rrugës së drejtë dhe t’i shmangen veprimeve të ndaluara. Përkatësisht, nga secila fe, lind pyetja: Në qoftë se njeriu nuk do të kishte të drejtën e zgjedhjes, a do të kishte kuptim kjo ftesë profetike? Pra, profetët, duke e ditur më së miri një aftësi të tillë te njeriu, i kanë drejtuar atij një ftesë të tillë logjike, të mbështetur më së miri te karakteri i zgjedhjes së tij të lirë. Profetët, përveç udhëzimeve që jepnin për rrugën e drejtë dhe predikimeve që bënin, kishin për detyrë të vinin në dijeni njerëzit për parajsën dhe ferrin. Kjo detyrë e profetëve mbështetet plotësisht te aftësia që ka njeriu për të zgjedhur rrugën e tij. Po ashtu, shprehjet që profetët propagandonin pa pushim, si: përgjegjësia, provat që njeriu jep në jetë, ndëshkimet, udhëheqja, qorrolisja, etj, a do të kishin kuptim nëse njeriu do të kryente gjithçka si një makinë e mirëprogramuar qysh më parë, në mënyrë që të veprojë me përpikëri siç e kërkon inxhinieri i saj dhe pa asnjë shmangie nga programi?

Në Kur’anin Famëllartë shkruhet: **“Natyrisht që Ne i treguam atij rrugën e drejtë, që ai të jetë ose mirënjohës, ose mosmirënjohës.”** (sure "Insan", ajeti: 3)

Pra, arrijmë në përfundimin se, sipas të gjitha feve qiellore, njeriu është një krijesë që zgjedh dhe, në bazë të kësaj zgjedhjeje, përcakton fatin e tij.

Rëndësia e lirisë së zgjedhjes nga këndvështrimi praktik dhe shoqëror

Praktika ka treguar se është me rëndësi të madhe fakti që një njeri të jetë i vetëdijshëm për të drejtën e zgjedhjes në një shoqëri, sepse kjo ndikon në mënyrë të drejtpërdrejtë te sjellja e tij me të tjerët. Kuptohet që sjellja e një njeriu, që e kupton vlerën e lirisë dhe rolin që ajo ka në vendosjen e fatit të tij, me një njeri që mendon se liria e zgjedhjes nuk ka ndikimin më të vogël në paracaktimin e fatit të tij, do të jetë krejt e ndryshme. Mendoj se është me vlerë të theksohet se në jetë asgjë tjetër nuk e ndrydh më shumë shpirtin e njeriut se sa fakti që ai e ka humbur të drejtën e zgjedhjes dhe mendon se është diçka tjetër që e komandon atë plotësisht dhe ai është duke vepruar sipas urdhrave të saj pa kurrfarë rrugëdaljeje. Ndryshimi midis njeriut që beson tek liria e tij dhe atij që nuk ka një mendim të tillë është i madh. I pari është njëlloj si ai zogu i lehtë me krahë të hapur, i cili mund të fluturojë kudo me dëshirën e tij, ndërsa i dyti është si ai zogu që i ka krahët e prera dhe nuk e ka privilegjin e fluturimit sipas vullnetit të tij. Kjo gjë i shkakton dhembje të përhershme shpirtërore. Përveç dëmeve personale, që shkakton mungesa e zgjedhjes së lirë te njeriu edhe dëmet shoqërore janë të konsiderueshme. Mosnjohja e saktë e lirisë, që ekziston te njeriu, në kuptimin e plotë të fjalës, është si virusi që ka infektuar fillimisht vetë personin dhe me pas infekton gradualisht shoqërinë. Më saktë, bën që dora e shtypësve të zgjatet dhe të ligjërohet, ndërsa zëri i të shtypurve të dobësohet dhe të humbasë mbështetjen në ligj.

Ata që zotërojnë pasuri të tjerëve dhe pasuri të mëdha të përbashkëta, mbi bazën e pretekstit, se gjoja fati deshi të ndodhte kështu, harrojnë të falënderojnë Zotin për një gjë të tillë dhe nuk u japin të drejtë të tjerëve për të protestuar dhe ngritur zërin për një gjë të tillë. Kjo është arsyeja që njerëzit dhe vendet agresore zbatojnë diktatin e tyre mbi të dobëtit dhe i lënë ata në një errësirë absolute lirie. Historia islame dokumenton shumë fakte të tilla, ku qeveri të ndryshme mizore dhe diktatura nga më të shumëllojshmet janë munduar me të gjitha mjetet që të fshijnë nga kujtesa e njerëzimit të drejtën themelore që njeriu ka për të zgjedhur.

Njeriu dhe fati

Një nga çështjet më të rëndësishme dhe më të diskutueshme të fetë dhe në veçanti në fenë islame, është fati. Problemi që lind është se mund të përfytyrohet njeriu duke u udhëhequr njëkohësisht, si nga dëshira e lirë në zgjedhje, ashtu edhe nga fati i tij.

Në historinë islame mësojmë se, tek myslimanët e parë, fati, tek i cili ata besonin, zinte një vend shumë të rëndësishëm në jetën e tyre. Por kjo nuk i pengoi ata që të mendonin se ishin një krijesë e komanduar nga të tjerët. Nga kjo pikëpamje, nuk krijuan ndonjë dyshim për këto dy koncepte, që në dukje janë sofizma të njëra-tjetrës. Me sa dimë, kjo çështje është trajtuar me vëmendje nga profeti Muhammed (paqja dhe bekimi i Allahut qofshin mbi të), si dhe nga imam Aliu në veçanti. Vlen për t'u theksuar se, tek myslimanët e parë, ky fakt ishte gjithmonë objekt pyetjesh, u qartësua aq mirë në sajë të fjalimeve të Profetit dhe të imam Aliut, saqë askush nuk mbeti i paqartë.

Kuptimi i fatit

Fatin duhet ta kuptojmë në këtë mënyrë: të përbërë nga dy faktorë kryesorë: ekzistenca e vetë krijesës dhe cilësitë e krijesës. Fillimisht duhet të theksoj se cilado krijesë, pa përjashtim, në të dyja dimensionet e fatit të saj (ekzistencën dhe cilësitë) është në dëshirën e Zotit. Duke pasur parasysh këto dy dimensione, që përcaktojnë kuptimin filozofik të fatit, do të bazojmë edhe arsyetimin tonë për sqarimin e problemeve që mund të krijohen, si për shembull pyetja që trajtuam që në fillim se si mund të mendohet njeriu i përfshirë njëkohësisht në dy kahe të logjikave të kundërta, që vendosin në jetën e tij, siç është fati, me vetëvendosjen e tij. Për t'i dhënë përgjigje kësaj pyetjeje do të analizojmë arsyet, shkaqet ose faktorët e ndryshëm të ekzistencës së një krijese. Fillimisht do të rikujtojmë disa pika hyrjeje.

Faktorët e barasvlershëm

Në ekzistencën e një krijese mund të ndikojnë njëkohësisht shumë faktorë të ndryshëm, ku secili ka një rol të veçantë. Për shembull, të marrim një lule në kopsht. Nëse pyesim veten se cilët janë faktorët që ndikojnë në ekzistencën e saj, fare lehtë mund të radhitim disa prej tyre, siç janë: uji, drita, temperatura, kopshtari, dheu e ndonjë tjetër. Të gjithë këta faktorë bëhen shkak që kjo lule të lindë dhe të rritet, pra, të ekzistojë. Secili nga këta faktorë veç e veç nuk e siguron dot ekzistencën e saj. Në të tilla raste kemi të bëjmë me shkaqe ose faktorë të barasvlershëm.

Faktorë të pabarabartë

Siç u pa dhe në shembullin më lart, përveç faktorëve të barasvlershëm (pra, që kanë të njëjtën rëndësi dhe nuk zëvendësohen nga njëri-tjetri) kemi dhe faktorë të tjerë që kanë lidhje me njëri-tjetrin, pra, njëri ndikon te tjetri, kështu që prioriteti i njërit do të jetë më i lartë ose më i ulët se tjetri, duke i klasifikuar sipas rëndësisë që kanë. Për ta qartësuar këtë pikë ndiqni dy shembujt e mëposhtëm.

Shembulli i parë: Supozoni një divizion ushtarak këmbësorie, i cili komandohet nga një gjeneral. Divizioni në fjalë, në bazë të urdhrimit që ka marrë nga gjenerali i tij është drejtuar për në front, që të luftojë me armikun mbi bazën e një plani të hartuar që më parë nga gjenerali. Divizioni, pas një kohë luftimesh, kthehet me fitore të plotë. Po të analizojmë faktorët që sollën fitoren, padyshim rolin kryesor e kanë ushtarët e divizionit të këmbësorisë. Faktor tjetër përbërës është dhe vetë urdhri i gjeneralit për një veprim të tillë luftarak. Duke i analizuar me vëmendje këta dy faktorë, do të vërejmë se nuk janë të pavarur nga njëri-tjetri, por janë funksion i njëri-tjetrit, pra, të lidhur sipas një funksioni të caktuar. Këta dy faktorë, në krahasim me shembullin e lules, nuk janë në një nivel, por qëndrojnë në nivele të ndryshme.

Shembulli i dytë: Supozojmë një njeri që do të shkruajë një letër. Le të analizojmë faktorët që bëhen shkak për shkrimin e kësaj letrë. 1- lapsi, që me lëvizjen mbi letrën lë gjurmët e fjalëve; 2- dora e njeriut, që shkakton lëvizjen e lapsit; 3- sistemi nervor, i cili drejton lëvizjen e dorës; 4- dëshira e njeriut që aktivizon sistemin e tij nervor; 5- shpirti, i cili kompozon këtë dëshirë për të shkruar letrën. Lind pyetja: Cili faktor u bë shkak për të shkruar letrën: lapsi, dora, sistemi nervor, dëshira, apo shpirti i njeriut? Kuptohet se, po të mos ishte ndonjë nga faktorët e mësipërm, letra nuk do të shkruhej. Faktorët nuk janë në një nivel dhe siç duket, secili faktor është më lart se faktorët paraardhës, duke formuar kështu një varg zinxhir të lidhur ngushtë me njëri-tjetrin. Me fjalë të tjera, secili faktor është funksion i faktorit pasardhës dhe anasjelltas, gjë që nuk vërehej tek shembulli i ekzistencës së lules. Duke bërë një përmbledhje të vogël për sa thamë, do të shpreheshim se në shembullin e ekzistencës së lules faktorët ishin në një nivel apo në një rresht, pa pasur ndonjë lidhje me njëri-tjetrin, kurse në rastin e fitores së divizionit ushtarak dhe shkrimit të letrës, faktorët nuk janë në një nivel apo rresht, por funksion i njëri-tjetrit, sipas një lidhjeje të caktuar.

Tani, që kuptimi i faktorëve të barasvlershëm dhe të pabarabartë u bë i qartë, do të analizojmë lidhjen që ekziston midis Zotit dhe krijesave të ndryshme apo fenomeneve të ndryshme që ndodhin dhe në veçanti me dëshirën e njeriut.

Dëshira e Zotit dhe vargu i faktorëve

Nuk ka dyshim që, në natyrë, shkaku dhe pasoja janë të lidhur me njëri-tjetrin në bazë të një sërë ligjesh, që ne i klasifikojmë si ligje natyrore dhe janë të aplikueshëm kudo. Pra, gjithçka që ndodh është brenda këtij kuadri ligjesh, që ne e quajmë ekuilibër natyror. Disa gjëra veprojnë mbi disa të tjera dhe, si rezultat i veprimeve e kundërveprimeve, lindin fenomene të reja. Për shembull, uji fik zjarrin dhe zjarri djeg drurin; mikrobet prodhojnë sëmundjet, kurse ilaçet i eliminojnë ato; njeriu, duke lëvizur harxhon energji dhe, si rezultat mbetet i uritur ose ka etje, por duke ngrënë dhe duke pirë e eliminon këtë gjendje të krijuar.

Nga ana tjetër, dimë që gjithçka që ndodh, krijohet, apo shuhet, është dëshirë e Zotit. Lind pyetja: Si ta shpjegojmë këtë dualizëm të krijuar? A mos duhet thënë se ligjet natyrore, që mbretërojnë tek sistemi shkak-pasojë, janë të rreme, domethënë, që zjarri nuk është shkak i djegies së drurit, por druri digjet drejtpërsëdrejti si rezultat i dëshirës së Zotit? Përgjigjet e pyetjeve mund t'i japim me lehtësi, duke u bazuar në logjikën që ndoqëm tek faktorët e pabarabartë. Pra, edhe zjarri, edhe vullneti i Zotit ndikon në djegien e drurit. Këta dy faktorë nuk qëndrojnë në të njëjtin nivel. Gjithashtu, nuk mund të themi se sistemi i përbërë nga dy faktorë të pavarur, si zjarri dhe vullneti i Zotit janë shkak i djegies së drurit (faktor të barasvlershëm). Si rezultat i këtyre arsytiveve, arrijmë në rezultatin se besimi te ndikimi i dëshirës së Zotit, tek të gjitha fenomenet që ndodhin në natyrë, (ekzistenca: kuptimi i fatit) nuk është me kuptimin e kundërshtimit të ligjeve natyrore. Për shembull, ekzistenca

(dimensioni i kuptimit të fatit) nuk kundërshton aspak vetinë (cilësitë: dimensionin tjetër i kuptimit të fatit) e djegies së zjarrit apo efektin shërues të ilaçeve etj.

Kjo pikë duhet kuptuar në këtë mënyrë: Çdo fenomen ndodh për shkak të faktorëve të ndryshëm të ligjeve natyrore të barasvlershme ose jo. I gjithë ky sistem, së bashku me faktorët që e shkaktojnë, në një nivel tjetër jo të barabartë, ka lidhje me vullnetin e Zotit. Kur'ani i shenjtë, me gjuhën e profetit Ibrahim, thotë: *“... më ka krijuar dhe më udhëzon (në rrugë të drejtë); i Cili më ushqen dhe më jep të pi; i Cili, kur sëmurem, më shëron; i Cili do të bëjë që të vdes e pastaj do të më ringjallë; dhe i Cili, shpresoj se do të m'i falë gabimet e mia në Ditën e Gjykimit! (Esh-Shuara: 78-82)*

Kjo thënie nuk kuptohet se profeti Ibrahim nuk e njeh efektin shërues të ilaçeve apo vetinë e heqjes së etjes nga uji dhe i kundërshton këto, por, në bazë të njohurive të thella që kishte ky profet, shikonte qartë se gjithçka kishte lidhje me dëshirën e Zotit.

Dëshira e Zotit dhe liria e njeriut

Duhet theksuar edhe një herë se besimi tek fati i njeriut, me të dy dimensionet e tij kuptimore (ekzistenca dhe vetitë e një krijese), asnjëherë nuk është në kundërshtim me faktin themelor të lirisë në zgjedhje, por në të kundërt, fati i njeriut është i bazuar dhe ka kuptim vetëm në rast se njeriu e konceptojmë si një qenie më të lirë. Në rast të kundërt, vetë fati për një njeri, që nuk ka liri në zgjedhje dhe vetëm është i detyruar të veprojë sipas një funksioni të diktuar, nuk do të kishte kurrfarë kuptimi. Kur njeriu vepron, por i mungon dëshira për këtë veprim, atëherë mund të themi se veprimi nuk u krye.

Nga ana tjetër, dëshira dhe veprimi ynë janë të lidhura ngushtë me dëshirën e Zotit. Kjo lidhje është natyrore, por jo në një nivel me shkaqe të tjera, sepse dëshira jonë është në funksion të dëshirës së Zotit. Lidhja midis dëshirës së Zotit me vetë lirinë është një lidhje midis dy shkaqeve apo dy faktorëve të pabarabartë, ku njëri është funksion i tjetrit, në lidhje me një veprim të caktuar të njeriut, ku dëshira e Zotit është në një nivel më të lartë.

Thënie të imam Aliut

Pas luftës së Sefinit, gjatë kthimit nga Sham-i (Siri), një nga bashkëluftëtarët e pyeti imam Aliun se mos kthimi nga Shami ishte dëshira e Zotit. Imam Aliu u përgjigj: “Po, ngjitja dhe zbritja në male të ndryshme ishte dëshira e Zotit.”

Ky njeri e pyeti përsëri: “Po vuajtjet tona në këtë marshim a do t'i llogaritë Zoti? A duhet të jemi në pritje të ndonjë shpërblimi?”

Imami u përgjigj: “Zoti ka për t'ju shpërblyer për çdo veprim: shpërblim për shkuarjen në luftë, sepse shkuat me dëshirën tuaj; shpërblim për qëndresën në front, sepse vetë e zgjodhët; shpërblim për kthimin nga fusha e betejës, sepse u kthyet me dëshirën tuaj. Në të gjitha këto veprime askush nuk ju detyroi. Ndoshta, thënia ime, se vajtja dhe kthimi juaj nga lufta ishte dëshira e Zotit, ju bën të imagjinoni se ju ishit të lirë të vepronit si të donit në këtë zgjedhje, por në rast se do të shkonit në luftë të detyruar dhe pa dëshirën tuaj, asnjë lloj shpërblimi, as në xhehenem nuk do të llogaritej për ju.”

Imam Aliu shprehet se shkuarja e njerëzve me dëshirë në luftë ishte funksion i dëshirës së Zotit. Kjo, nga ana e saj, do të thotë së dëshira e Zotit nuk është detyrim që ia kemi dikujt ose jemi të detyruar ta bëjmë për dikë tjetër. Me fjalë të tjera, shokët e imamit mund të marshonin për në luftë ose mund të mos luftonin fare, dhe që të dyja veprimet janë simbol i dëshirës së Zotit.

Roli i faktorëve shpirtërorë në fatin e njeriut

Në kapitullin e mëparshëm u njohëm me lidhjen ndërmjet fatit dhe dëshirës së njeriut. Ndërsa në këtë kapitull do të trajtojmë rolin që kanë faktorët dhe shkaqet e ndryshme në zgjedhjen e lirë të njeriut.

Siç dihet, sistemi i botës materiale funksionon në bazë të shkaqeve dhe pasojave materiale, pra, në bazë të këtyre faktorëve. Nga këndvështrimi i njeriut material, shkaqet dhe faktorët, që veprojnë direkt tek objektivat e tij, për shembull: vdekja, ushqimi i përditshëm, shëndeti, lumturia, etj, janë materiale. Mendojnë se, me anë të faktorëve materialë do ta afrojnë ose do ta largojnë ditën e vdekjes; do ta shtojnë ose pakësojnë ushqimin e përditshëm; do ta sigurojnë apo humbasin kënaqësinë dhe lumturinë. Nga pikëpamja shpirtërore ekzistojnë faktorë të tjerë jo materialë, që janë efikas në jetën tonë. Këta quhen faktorë shpirtërorë dhe njëkohësisht me faktorët materialë luajnë një rol të rëndësishëm në fatin e njeriut. Në përputhje me këtë pikëpamje ekzistojnë edhe një varg qëllimesh të tjera, që duhen trajtuar. Ai njeri, që ka këndvështrim shpirtëror, ndodhitë e përditshme në botë i shikon në një kompleksitet më të lartë. Kuptohet që zgjedhja e lirë e këtij njeriu ka një amplitudë më të madhe dhe më të larmishme, sepse tek ai ndikojnë një numër më i madh faktorësh materialë dhe jo materialë, të marrë së bashku. Më poshtë do të trajtojmë disa nga këta faktorë, që kanë rëndësi në filozofinë islame.

Përpjekja në rrugën e së vërtetës

Në qoftë se një njeri apo një grup njerëzish ecin në rrugën e drejtë të së vërtetës, përpiqen ose luftojnë për të qenë në këtë rrugë, do ta mbështesin pa rezerva sistemin shkak-pasojë.

Kur'ani i Madhëruar, në lidhje me këtë, thotë: *“Ata që luftojnë për çështjen Tonë, sigurisht, Ne do t’i udhëzojmë drejt udhëve Tona. Vërtet, Allahu është me punëmirët!” (El-Anke’but: 69)*

Në një vend tjetër Zoti thekson: *“O besimtarë, nëse e ndihmoni Allahun,¹ edhe Ai do t’ju ndihmojë dhe do t’ju bëjë të qëndroni fort në këmbët tuaja.” (Muhammed: 7)*

Po ashtu edhe e kundërta, në qoftë se një njeri apo një popull do të ecë në rrugë të shtrembër, të përbërë nga hile, agresion, shtypje, etj si këto, edhe sikur të jetë i pajisur me mjete të përparuara materiale, Zoti padyshim do të urdhërojë shkatërrimin e plotë, deri në zhdukje të tij.

Besimi te Zoti

Një faktor tjetër me rëndësi në përcaktimin e fatit është besimi te Zoti. Ky lloj besimi nënkupton se, në qoftë se një njeri është duke ecur në rrugën e drejtë të së vërtetës, nuk duhet t’i krijohen dyshime për këtë gjë dhe duhet të jetë i sigurt se e vërteta është qëllimi i tij në këtë rrugë dhe për këtë ai do të ketë ndihmën e gjithanshme të Zotit.

Kur'ani Famëlartë, në lidhje me këtë, thotë: *“Pasaniku le të shpenzojë sipas pasurisë që ka, ndërsa i varfri le të shpenzojë sipas asaj që i ka dhënë Allahu; Allahu nuk e ngarkon askënd mbi sa i ka dhënë. Pas vështirësisë, Ai sjell lehtësimin.” (Et-Talak:7)*

Predikimi dhe lutja

Një faktor tjetër që ndikon në fatin e njeriut, saktësisht në dimensionet e fatit, që janë ekzistenca dhe vetitë e një fenomeni, që është në gjendje të ndryshojë rrjedhën e

¹ Pra, çështjen e Tij.

rezultatit së bashku me të, është lutja. Lutja është në gjendje të pengojë një fenomen ose të krijojë një fenomen të ri në favor të besimtarit. Sigurisht që lutja ka disa kushte, ku trajtimi i tyre është jashtë nivelit të këtij libri.

Lëmosha dhe favoret

Lëmosha dhe favoret janë faktorë të tjerë shpirtërorë të rëndësishëm, që ndikojnë në ndryshimin dhe përcaktimin e fatit të njeriut. Imam Sadiku (paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të), thotë: “Njerëzit që vdesin, si rezultat i mëkateve të tyre, janë shumë herë më shumë se ata që vdesin si rezultat i plakjes së tyre fizike, dhe njerëzit, që jetojnë gjatë, si rezultat i të mirave që kanë bërë, janë shumë herë më shumë se ata që jetojnë aq sa i lejon plakja e tyre fizike.”

Të bërit mirë krijesave që kanë shpirt

Kushdo që keqtrajton krijesat që kanë shpirt: kafshët dhe njerëzit në përgjithësi dhe edukuesit e tij në veçanti (nënë, babain, mësuesin) ose u krijon atyre vështirësi dhe mërzitje në jetë, padyshim që do të ketë pasoja të rënda negative në fatin e tij.

Si përmbledhje, me fjalë të tjera, drejtësia dhe shtypja, të bërit pishman dhe të mos bërit pishman, të bërit mirë dhe të bërit keq, lutja dhe anashkalimi i saj dhe të tjerë shembuj si këta, janë faktorë kryesorë që ndikojnë drejtpërsëdrejti në fatin e njeriut nga pikëpamja e jetëgjatësisë, sigurimit të ushqimit të përditshëm, shëndetit etj. Në këtë kontekst, këta faktorë duhen parë si një varg efikas qëllimesh jomateriale.

Favoret e besimit

Në fund të këtij kapitulli do të radhisim favoret e besimit te fati.

1- Shikimi i sistemit botëror sipas qëllimit: Ai njeri, që njeh pushtetin e plotë të Zotit mbi tokë, e shikon sistemin botëror në një këndvështrim tjetër, mbi bazën e një qëllimi dhe të një ideali të saktë për të cilin është krijuar. Pra, me pak fjalë, Zoti ka pasur një qëllim që e ka krijuar tokën si çdokush tjetër që krijon diçka me një qëllim të caktuar. Krijimi i tokës nuk është nisur nga hiçi, tokën pa asnjë qëllim. Ky lloj këndvështrimi mbi botën që na rrethon, e bën njeriun të jetë më optimist dhe të shkëputet nga pesimizmi që e ka rrethuar.

2- Besimi te arsyet shpirtërore dhe mos humbja e shpresës nga mungesa e të mirave materiale: Njeriu, që ka besim te faktorët shpirtërorë, nuk bie në mërzitje për arsye të mungesës së të mirave materiale, përkundrazi, shpirti i tij (që nuk ka të bëjë me botën materiale) zhvillohet më tepër dhe më i fortë dhe bashkë me të zhvillohet, me po të njëjtin koeficient, edhe shpresa e njeriut, duke u bazuar se do të jenë faktorë të tjerë shpirtërorë që do të vendosin në favor të tij, duke u bërë të suksesshëm në këtë rrugë.

3- Përballimi i pengesave dhe vështirësive: Ai njeri, që kudo sheh dorën e Zotit të veprojnë dhe ka besim në faktorët e fatit të tij, pa dyshim që është më tepër rezistent ndaj vështirësive të ndryshme materiale apo shpirtërore, si dhe mund t'i bëjë ballë ngjarjeve shumë të rënda që mund t'i ndodhin papritur. Me pak fjalë, ai është i përgatitur shpirtërisht dhe praktikisht i pathyeshëm.

4- Shmangia nga mburrja dhe mendjemadhësia: Njeriu, që ka besim në faktorët shpirtërorë që mbretërojnë kudo, padyshim nuk do të dehet nga gëzimi dhe lumturia e shkurtër e provokuese, nuk do të bjerë pre e mendjemadhësisë dhe e mburrjes. Ndërsa njeriu, që përballë vështirësive pëson humbje, do të bjerë lehtë pre e mendjemadhësisë në kohë të shkurtra lumturie, sepse këtë lumturi e kupton si meritë të tij. Ndërsa ai që suksesin e sheh si një dhuratë të Zotit, nuk ka arsye të bjerë në mendjemadhësi, por falënderon Zotin për një favor të tillë.

Qëllimi i jetës

Filozofia e jetës ose “Qëllimi i jetës” është një nga problemet themelore të njohjes së njeriut dhe tema më e komplikuar e jetës së tij. Në qoftë se njeriu nuk do të jetë në gjendje t’i japë një përgjigje bindëse kësaj pyetjeje dhe të kuptojë në thellësi këtë problem, jeta e tij do të jetë boshe dhe e pakuptimtë. Të gjitha veprimet e vullnetshme dhe me dëshirë të plotë, që njeriu kryen gjatë jetës së tij, marrin kuptim vetëm atëherë kur dihet qëllimi përfundimtar i jetës. Qëllimi i punës, i studimeve, i lindjes, i riprodhimit, madje dhe i të ngrënit tek një njeri është vazhdimi i jetës së tij, ndërsa qëllimi i vazhimit të jetës dhe i vetë jetës lidhet me pikëpamjet që ky njeri ka për botën dhe shoqërinë.

Po të tregojmë pak kujdes, do të kuptojmë me lehtësi se, në qoftë se ne do të kemi parasysh një qëllim të caktuar për jetën tonë, ky qëllim do të ndikojë thellësisht në jetën tonë. Me fjalë të tjera, do t’i japë drejtim dhe kuptim jetës sonë. Arsyeja që njerëzit jetojnë në mënyra të ndryshme nga njëri-tjetri është se kanë qëllime të ndryshme në jetë. Sa më i lartë të jetë qëllimi i jetës, aq më e lartë është edhe mënyra që ndjek njeriu për të jetuar, prandaj lumturia e njeriut ka lidhje me njohjen e qëllimit të jetës ose më mirë të themi me njohjen e filozofisë së jetës. Në përgjithësi, ngaqë njeriu merret pas punëve të përditshme dhe nga gëzimet e ndryshme materiale, harron qëllimin e vërtetë të jetës së tij. Shumë njerëz, pavarësisht se jetojnë shumë vite, kurrë nuk mendojnë për këtë problem. Përvoja ka treguar se, kur njerëzit fillojnë të mendojnë për qëllimin e jetës, sjellin ndryshime të mëdha në jetën e tyre. Personalitete të mëdha, si: Naser Khosro dhe Leon Tolstoi në moshën 40 vjeçare filluan të mendojnë për këtë problem dhe pësuan ndryshime të mëdha në jetën e tyre.

Klasifikimi i zgjedhësve të filozofisë së jetës

Në lidhje me “filozofinë e jetës” njerëzit mund t’i ndajmë në tri grupe:

Grupi i parë: Bëjnë pjesë njerëzit që kënaqen me botën materiale dhe janë familjarizuar me pamjen e jashtme të jetës, nuk mund të shohin ndonjë qëllim tjetër më të lartë. Sipas Kur'anit, këta njerëz janë të vetëkënaqur nga jeta dhe të mbetur në qetësi. Është pikërisht kjo qetësi false që i pengon ata të shikojnë me seriozitet “qëllimin e jetës”.

Grupi i dytë: Bëjnë pjesë njerëzit që qëllimet materiale dhe instinktet fizike njerëzore nuk kanë mundur t’i kënaqin dhe të jetojnë të qetë, por në të njëjtën kohë nuk mund ta shohin dot jetën në një dimension më të lartë. Njeriu i këtij grupi e imagjinon jetën të përmbledhet në disa ditë dhe në këtë jetë, përveç qëllimeve materiale dhe përmbushjeve të instinkteve natyrore, nuk ka ndonjë qëllim tjetër. Pra, jeta shihet si kuti boshe. Nihilistët bëjnë pjesë në këtë grup.

Grupi i tretë: Bëjnë pjesë njerëzit e lirë, që njohin dimensionin sipëror të jetës. Këta njerëz, në sajë të studimit të tyre kuptuan se lumturia është një derë e vogël e dijes së përgjithshme që iu është hapur dhe gjithashtu janë të familjarizuar me madhështinë shpirtërore të jetës. Në këtë mënyrë, këta nuk janë as si grupi i parë, që mbeten të kënaqur vetëm me pamjen e jashtme materiale të jetës dhe as si grupi i dytë, që jetën e shikon si një kuti të zbrazët dhe nuk kanë haber nga qëllimi i saj. Ky grup, duke shtënë në dorë të vërtetën, që nga këndvështrimet e jashtme është e mbuluar dhe e fshehur, ka kuptuar filozofinë e jetës përtej kufijve të botës së jashtme materiale.

Filozofia e jetës dhe dija njerëzore

Për të zbuluar filozofinë e jetës së njeriut, së pari, duhet ta njohim më së miri atë, që të bëjmë një gjykim të drejtë mbi të. Njohja e njeriut, pa marrë parasysh lidhjet që ai

ka me tërë ekzistencën në botë dhe vendndodhjen që ka kjo ekzistencë e vazhdueshme, është e pamundur. Nga kjo pikëpamje, zbulimi i të fshehtave të ekzistencës së tij hyn në grupin e zbulimit të të fshehtave të botës në përgjithësi. Zbulimi i të fshehtave të botës, duke u mbështetur në dijet njerëzore dhe në shkencat që zotëron njeriu, është i pamundur, sepse vetë njeriu është një grimcë e kësaj gjithësie dhe kurrë nuk do të mundet të njohë tërë gjithësinë e ekzistencës. Filozofë të ndryshëm, çështjen e njeriut, me tërësinë e ekzistencës, e kanë krahasuar si peshku me sistemin e deteve dhe të oqeanëve. Ky peshku nuk është në gjendje të dalë jashtë ujit dhe të shkojë të sodisë vende të tjera që nuk kanë të bëjnë me ujin. Edhe njeriu i tillë është dhe nuk mund ta nxjerrë kokën jashtë sistemit të tij jetësor, të sodisë dhe kuptojë plotësisht ekzistencën e gjithësisë. Shkencat empirike janë në gjendje të zbulojnë vetëm fenomene materiale të pjesshme dhe asnjëherë ekzistenca e gjithësisë nuk ka qenë objekt studimi për këto shkenca. Nga ana tjetër, edhe vetë truri i njeriut nuk është në gjendje të përlllogaritë me saktësi këtë lloj ekzistence dhe nuk është projektuar me kapacitet të tillë për të përpunuar të tilla njohuri. Prandaj, lidhur me këtë problem themelor, asnjë lloj shkence njerëzore nuk është në gjendje t'i japë përgjigje. Prandaj njeriu ka nevojë për një orientim të doktrinave profetike (i nevojitet profetizmi), për t'ia qartësuar këtë pyetje të përhershme.

Qëllimi i krijimit të botës

Qëllimi i krijimit të botës ka nevojë për një këndvështrim religjioz. Sipas këndvështrimit fetar, të gjitha krijesat dhe krijimet, së bashku me veprimet e Zotit, kanë një kuptim të saktë dhe të mirëlllogaritur që më parë. Asnjë nga krijesat dhe krijimet e Tij nuk ekziston kot. Kur'ani i Madhëruar thekson në ajete të ndryshme se krijimi i botës është një e vërtetë e pamohueshme dhe nuk është diçka e kotë dhe e paqëllimtë.

“Për ata që e përmendin Allahun duke qëndruar në këmbë, ndenjor ose shtrirë dhe që meditojnë për krijimin e qiejve dhe të Tokës (duke thënë:) “O Zoti Ynë! Ti nuk i ke krijuar kot këto - lartësuar qofsh (nga çdo e metë)! Prandaj na ruaj nga ndëshkimi i zjarrit.” (Al-‘Imran: 191)

“Mos vallë, keni menduar që Ne ju kemi krijuar kot dhe që nuk do të ktheheshit te Ne (për t’ju gjykuar)?” (El-Mu’minun: 115)

“Ne nuk e kemi krijuar qiellin dhe Tokën e ç’gjendet në mes tyre, për të luajtur (pa qëllim). Sikur të donim argëtim, Ne do ta bënim me gjërat pranë Nesh (si engjëjt, hyrijet etj.), nëse do të bënim diçka të tillë.” (El-Enbija’: 16-17), tregojnë qartë se sistemi i krijimit ka një rregull të përsosur dhe të lidhur ngushtë me njëri-tjetrin dhe nuk është pakuptim. Çdo krijim dhe krijesë është matur dhe vlerësuar mirë përpara se të vendoset në ekzistencë dhe të hedhë hapat drejt qëllimit të vet, që i është përcaktuar nga Krijuesi i saj. Pra, edhe njeriu, që është krijesa më perfekte e Zotit, është përfshirë në këtë rregull të përgjithshëm dhe ekzistenca e tij nuk u formulua ashtu kot, rastësisht.

Njeriu, për të arritur këtë qëllim të lartë që i është kërkuar, është krijuar dhe është vendosur në këtë jetë dhe hapat që hedh në këtë rrugë janë një shans që i është falur për të arritur këtë qëllim. Pra, jeta e tij është e qëllimtë. Tani është me vend të bëhen pyetjet: Cili është qëllimi i jetës së njeriut? Për çfarë është krijuar dhe çfarë duhet të arrijë? Cila është filozofia e jetës së tij? Këtyre pyetjeve do t'u japim përgjigje në kapitullin tjetër.

Qëllimi i krijimit të njeriut dhe i botës

Siç u njohëm në kapitujt e mëparshëm, krijimi i botës ishte si përfundim i qëllimit të Krijuesit. Do të vijojmë me trajtimin e llojeve të krijesave, si dhe të lumturisë që është në qendër të vëmendjes sonë dhe shpërndahet nga rrezatimi i Krijuesit. Ne mund ta përfitojmë atë.

Stadet e krijesave

Mes krijesave të Zotit, atë që tregon logjika mendore e theksojnë ajete kur'anore dhe hadithe të ndryshme, që në filozofinë islame njihen me emrin “shpirtërore”. Këto krijesa nuk kanë kushte dhe dimensione materiale, gjithashtu nuk pësojnë asnjë lloj ndryshimi. Ato kanë një kapacitet aq të madh dashurie, sa në një nga ajetet e Kur'anit Famëlartë flitet nga gjuha e engjëjve: **“Çdonjëri prej nesh e ka vendin e caktuar (në qiell, ku adhuron Allahun).” (Es- Safat: 164)**

Sigurisht, që tek këto krijesa ka nivele të ndryshme, që mund të jenë më lart apo më ulët se një nivel tjetër, por secila krijesë qëndron në po atë nivel që është krijuar dhe nuk pëson asnjë ndryshim. Zoti, me mëshirën e Tij të madhe, i krijoi këto krijesa për të ndërmjetësuar në rrjedhën e mëshirës së Tij dhe krijesave me një shkallë më të ulët. Nga krijesat shpirtërore do të kalojmë tek ato materiale. Krijesat materiale janë si krijesat fikse, por të miksuara me lëvizjen dhe dinamizmin. Filozofia e botëkuptimit material nuk është gjë tjetër veç lëvizjes. Në kundërshtim me krijesat shpirtërore dhe jo materiale, që kanë një gjendje lumturie të përhershme dhe të pandryshueshme, krijesat materiale (si për shembull shpirti i njeriut, që në këtë botë është i bashkëngjitur me trupin) kanë aftësi dhe kapacitet të tillë që t'i përshtaten gjendjeve të reja dhe të përfitojnë lumturi të tjera, duke e ndërruar nivelin e krijimit. Për shembull, dheu, në sajë të ndryshimeve që ndodhin, ka veti të shndërrohet në bimë, ose sperma ka vetinë, që në sajë të ndryshimeve që ndodhin në të, të krijojë shpirtin dhe më pas ta shndërrojë në një njeri të plotë. Njëra nga krijesat, që mund të vijë në këtë botë është njeriu. Sipas ajeteve dhe haditheve mësojmë se njeriu është krijesa më komplekse dhe më e saktë që Zoti ka krijuar. Pra, mund të themi se njeriu është madhështia e krijesave.

Por, duke qenë se njeriu është një krijesë e ndryshueshme dhe mund të marrë nivele të ndryshme në këtë botë, jo të gjithë njerëzit janë në një nivel krijimi. Ka njerëz që janë më poshtë se niveli i krijimit të kafshëve, por ka njerëz që kanë një nivel shumë herë më të lartë se engjëjt, saqë engjëjt e nderojnë këtë nivel. Veçorinë, që një krijesë, me dëshirën dhe zgjedhjen e saj të lirë, të arrijë nga një nivel shumë i ulët në një nivel shumë të lartë, e kanë krijesat që ndodhen në botën materiale, në mënyrë që të kenë mundësi të ndryshojnë në bazë të ndryshimeve dinamike që ndodhin. Pra, të tilla krijesa janë të pajisura me një elasticitet të jashtëzakonshëm dhe shumë dimensional. Kjo krijesë, me një veçori të tillë të përkryer, nuk mund të bëjë pjesë në grupin e krijesave të qëndrueshme (shpirtërore). Krijesat e qëndrueshme kanë një gjendje fillestare dhe nuk kanë mundësinë e ndryshimeve. Prandaj, për këto lloj krijesash, me aftësi ndryshimi të jashtëzakonshëm, duhet që bota materiale të ekzistojë patjetër. Arrijmë në përfundimin se bota dhe filozofia materiale është hyrja për tek ekzistenca e njeriut (dhe krijesave të ngjashme me njeriun*).

Qëllimi i krijimit të njeriut nga këndvështrimi kur'anor

Kur'ani Famëlartë, teorinë e mësipërme e thekson me forcë:

Është Ai që ka krijuar qiejt dhe Tokën për gjashtë ditë, teksa Froni i Tij ndodhej mbi ujë, për t'ju vënë në provë kush është më i mirë në vepra. Nëse ti u thua: “Ju do të ringjalleni pas vdekjes”, mohuesit, me siguri do të thonë: “Kjo nuk është asgjë tjetër, përveçse magji e kulluar!” (Hud: 7)

Duke u bazuar në këtë ajet kuptojmë së krijimi gradual i botës (në gjashtë etapa) është faza fillestare e hyrjes që parapërgatit krijimin e një krijese me aftësi të ndryshueshme dhe që mund të ndryshojë në bazë të zgjedhjes së tij të lirë dhe të arrijë në lumturinë e plotë. Po ashtu, në këtë ajet shprehet qartë së qëllimi i krijimit të botës dhe njeriut është vënia në provë e njeriut. Toka është laboratoriu ku testohet njeriu. Zoti e vë në provë njeriun se në cilin drejtim është, atë të tokës apo atë të Zotit.

“Çdo gjë që gjendet në Tokë, Ne e kemi bërë stoli për të, për të provuar se kush prej tyre punon më mirë.” (El-Kehf: 7)

Kuptimet e të gjitha ajeteve, në lidhje me krijimin e njeriut dhe botës, nuk janë të njëjta, sidomos në lidhje me qëllimin e krijimit të njeriut:

“Xhindet dhe njerëzit i kam krijuar vetëm që të Më adhurojnë.” (Edh-Dhariat: 56)

Siç e shikoni në këtë ajet, qëllimi i krijimit të njeriut dhe shpirtit është i përbashkët në detyrat dhe dëshirat, të prezantohet adhurimi i Zotit. Në një ajet tjetër thuhet:

Sikur të kishte dashur Zoti yt, të gjithë njerëzit do t’i bashkonte në një bashkësi të vetme, por ata vazhdojnë të jenë të përçarë, përveç atyre, që i ka mëshiruar Zoti yt. Për këtë qëllim Ai i krijoi ata. Do të plotësohet Fjala e Zotit tënd: “Me të vërtetë që do ta mbush Xhehenemin me xhinde dhe njerëz bashkërisht!” (Hud: 118-119)

Në këtë ajet kuptojmë se qëllimi i krijimit të njeriut është orientimi nga Zoti. Nga këto ajete mund të themi se Zoti i ka dhënë njeriut lirinë për të zgjedhur, duke e vënë atë përballë dy rrugëve. Njeriu duhet të zgjedhë i lirë rrugën e adhurimit të Zotit, që s’është gjë tjetër veçse rruga e lumturisë së tij, duke iu afruar mëshirës së tij. Në përputhje me këto ajete kur’anore, qëllimi përfundimtar i krijimit të njeriut dhe i lumturisë së plotë të tij është afrimi i tij me Zotin. Marrja në provim e njeriut dhe adhurimi ndaj Zotit janë mjete për të arritur qëllimin final, por secila veç e veç nuk është qëllimi final. Me fjalë të tjera, këto janë qëllime dytësore, që janë të nevojshme për të arritur në qëllimin përfundimtar.

Në këtë kontekst është e nevojshme të sqarohet se **afrimi me Zotin** nuk është me kuptimin e afrimit që ne njohim në jetën e përditshme materiale. Por është një e vërtetë e thellë shpirtërore, që njeriu, sa më afër t’i afrohet Zotit, aq më mirë e kupton këtë të vërtetë.

Vëmë në dukje se, duke qenë pranë Zotit, çdo lloj lumturie dhe gëzimi është i pranishëm. Afërsia me Zotin është burimi i të gjitha mirësive, dashurive dhe madhështive.

Afërsia me Zotin nuk është një pikë apo një shkallë, por një seri shkallësh dhe stadesh të ndryshme. Për ta kuptuar më mirë këtë koncept mund të themi se besimi te Zoti është shkalla e parë e afërsisë me Zotin. Ai njeri, që nuk beson te Zoti, nuk është i drejtuar në rrugën Tij. Njeriu, pas besimit tek Zoti, me përpjekjet e tij, mund të hedhë hapa në shkallë të tjera të afërsisë së Zotit. Në Kur’an, shprehja **pranë Zotit** është përdorur në shumë vende dhe ka kuptimin e afërsisë së njeriut me Zotin.

“Allahu ka dhënë si shembull për besimtarët gruan e Faraonit, kur ajo tha: “O Zoti im! Ndërtomë një banesë tek Ti, në Xhenet; më shpëto nga Faraoni dhe veprat e tij dhe më shpëto nga populli keqbërës!” (Et-Tahrim: 11)

Diskutim rreth një pyetjeje

Dikush mund të pyesë: Përse Zoti nuk ia jep njeriut që në fillim masën e lumturisë dhe të kënaqësisë, që i duhet të arrijë? Në qoftë se qëllimi është arritja e mirësisë së Zotit, çfarë rëndësie ka që njeriu të përshkruajë gjithë atë rrugë të gjatë për ta arritur atë?

Këto pyetje janë të bazuara në një nivel mendimi gjatësor. Është njëlloj sikur kemi një enë bosh dhe duam ta mbushim me ujë. Njëra mënyrë është ta mbushim gradualisht,

ndërsa mënyra tjetër është ta mbushim plot menjëherë. Domethënë, ka lindur ideja se çdo lloj krijese mund t'i jepet që në fillim çfarëdolloj mirësie dhe lumturie. Në lidhje me njeriun do të ndeshemi me të tilla pyetje edhe më vonë.

Është me rëndësi të kuptohet se marrja e lumturisë dhe e mirësisë nga Zoti ka nevojë për një kapacitet special. Ky lloj kapaciteti është vendosur tek disa krijesa vetëm në bazë të zgjedhjes së lirë. Ekzistojnë probleme, që zgjidhjet e tyre bazohen në dijet dhe njohuritë që ka krijesa. Vlera e zgjidhjeve të këtyre problemeve kushtëzohet tek kapaciteti që kjo krijesë ka në lidhje me dijet dhe njohuritë. Edhe mirësia dhe lumturia që Zoti ka marrë parasysh si shpërblim është në bazë të zgjedhjes së lirë të tij. Mirësia është e tillë, që, në qoftë se njeriu nuk ndjek një rrugë të gjatë dhe të vështirë, ai nuk mund të përfitojë dot kapacitetin e duhur dhe asnjëherë nuk do të jetë në gjendje të kuptojë vlerën e tij.

Përgjigja e pyetjeve të tjera

Një pyetje tjetër që mund të trajtohet është: Pse Zoti kërkon që ta çojë njeriun drejt lumturisë së plotë? Me fjalë të tjera, përse Zoti e krijoi njeriun, t'i japë mëshirën e tij? Cili është qëllimi i Zotit për krijimin e njeriut dhe orientimin e tij drejt lumturisë?

Për t'i dhënë përgjigje këtyre pyetjeve duhet pasur parasysh se Zoti është Mëshirues e i Pastër dhe ka si veçori krijimin dhe dhënien e mëshirës, e nuk ka kufi. Nëse dikush ka mundësi të përfitojë mirësi, Zoti nuk ia refuzon, sepse kjo bie në kundërshtim me mirësinë absolute të Tij.

Me fjalë të tjera, Zoti, që është lumturia absolute, krijon duke pasur parasysh se krijesa është një lloj si mirësia dhe çdo krijesë që merr nga Zoti ekzistencën e saj përfiton edhe mëshirën dhe mirësinë e Tij dhe e kundërta, në qoftë se nuk do të ishte krijuar, pra, nuk do të kishte marrë ekzistencën e saj, nuk do të merrte as mirësinë, as mëshirën e Zotit. Njerëzit, që janë vendosur në stacionet e larta të lumturisë, e kanë ndier lezetin dhe madhësitinë e ekzistencës dhe praktikisht e kanë kuptuar të vërtetën se jeta është rrezatimi i diellit të mirësisë dhe ekzistenca është vullkani i mëshirës që derdhen pa pushim tek ata. Në qoftë se njeriu do të ndjekë rrugën e këshilluar nga profetët, patjetër do të arrijë lumturinë e kërkuar dhe madhështia e saj nuk mund të matet. Njerëzit, që në këtë botë kanë arritur në mënyrë të pjesshme këtë lumturi, patjetër, u janë bindur udhëzimeve të profetëve.

Sistemi edukativ islam

Në kapitullin e mëparshëm arritëm në përfundim se njeriu, për të arritur lumturinë e plotë, duhet t'i afrohet Zotit. Lind pyetja si dhe ç'rrugë duhet të ndjekim për ta arritur këtë? Përgjigja është e thjeshtë: Nuk ka rrugë tjetër përveç studimit të lumturisë shpirtërore dhe virtyteve edukative. Prandaj në këtë kapitull do të trajtojmë **sistemin edukativ islam**.

Njëra nga çështjet, që ka lidhje të afërt me njohjen e njeriut, është dija edukative. Kjo lidhje është aq e afërt dhe aq e thellë, saqë mund të thuhet se njohja e njeriut është themeli i edukimit dhe sistemi edukativ në përgjithësi. Ndryshimet, në sistemet e ndryshme edukative, rrjedhin si rezultat i mendimeve të ndryshme që kanë në lidhje me njohjen e njeriut. A mund ta shpjegojmë ju këtë lidhje?

Kriteret e virtyteve edukative

Një nga problemet themelore të edukimit është se cilat janë kriteret e virtyteve edukative, d.m.th.: Cilat janë kriteret për ta njohur një veprim si veprim edukativ? Në kapitujt e mëparshëm arritëm në përfundimin se qëllimi përfundimtar i jetës së njeriut është afrimi me Zotin. Pra, në bazë të këtij kriteri themelor ne mund të klasifikojmë

veprimet njerëzore, domethënë, në qoftë se një veprim e afron njeriun me destinacionin që ka, atëherë ky veprim ka vlerë edukative dhe do të quhet virtut edukativ. Në rast se një veprim është i mirë në dukje, por nuk e afron njeriun me Zotin, atëherë, nga pikëpamja islame, ky veprim nuk ka vlerë edukative dhe nuk mund ta quajmë virtut edukativ. Për ta shpjeguar më mirë duhet të dimë se çdo veprim është i përbërë nga dy pjesë plotësisht të qarta:

1- Qëllimi i veprimit, që ka lidhje me dimensionin shpirtëror.

2- Forma e veprimit, që është e lidhur me dimensionin material trupor.

Për shembull, në qoftë se një njeri i fal diçka dikujt, vetë falja e objektit është forma e veprimit, ndërsa shpirti i tjetrit është qëllimi i veprimit. Në sistemin edukativ islam, një veprim do të quhej virtut (ka vlerë edukative), në qoftë se do të ketë një qëllim të pastër për Zotin dhe një formë veprimi në përputhje me urdhrat e Tij. Pra, çdo veprim, me çfarëdolloj qëllimi, nuk mund të quhet virtut. Një veprim, me qëllim të pastër, nuk mund të kryhet në çfarëdolloj forme dhe gjithashtu nuk mund të kryejmë një veprim në formën e duhur pa një qëllim të pastër.

Edukimi është relativ apo absolut?

Siç dihet, karakteri i njeriut, në thelb, ka ndërtim të njëjtë. Në bazë të kësaj, veprime të njëjta, në kushte të barabarta, kanë efekte të njëjta në shpirtin e njeriut. Nuk ka mundësi që i njëjti veprim, në kushte të barabarta, të një njeri të ketë efekt pozitiv dhe të një tjetër të ketë efekt negativ. Në qoftë se një veprim, të një njeri do të grupohej tek virtutet edukative, ky veprim do të jetë për të gjithnjë një virtut, sepse ndihmon në afrimin me Zotin. Përfundimisht themi se vlerat edukative e kanë rrenjën në karakterin e njeriut dhe se karakteri është me ndërtim të njëjtë tek të gjithë njerëzit dhe i pandryshueshëm, këto vlera janë të njëjta dhe të pandryshueshme në kohë dhe vend për të gjithë njerëzit dhe si rezultat, sistemi edukativ është absolut.

Për shembull, kur themi se guximi, trimëria, drejtësia, bamirësia, pastërtia, etj, janë vlera të larta edukative, nuk kemi parasysh një grup të caktuar njerëzish në një kohë të caktuar dhe në një vend të përcaktuar, që bëjnë pjesë në një shoqëri të veçantë, por një përgjithësim të këtyre vlerave për të gjithë, kudo, në çdo kohë dhe në çfarëdo shoqërie qofshin.

Disa doktrina edukative pohojnë se sistemi edukativ është relativ dhe në bazë të kushteve kohore dhe vendore vlerat edukative ndryshojnë.

Arsyet që këto doktrina theksojnë se sistemi edukativ është relativ janë si më poshtë:

1- Karakteri i njeriut nuk ka ndërtim të njëjtë, madje mendojnë se njeriu nuk gëzon liri dhe dëshirat e karakterit, gjithashtu, janë pa një ndërtim të mirëfilltë karakteri.

2- Nuk njohin ekzistencën e Zotit të vetëm dhe Krijuesin e gjithçkaje dhe të çdo ligji, kur nga ana tjetër, në çdo doktrinë të profetëve theksohet me vendosmëri ekzistenca e Krijuesit të përgjithshëm të ligjeve, që tregon nga të gjitha këndet për prezencën e njeriut, dhe është në dijeni të përfitimeve dhe humbjeve, duke mos pasur asnjë konfuzion në këtë pikë. Për këtë arsye, të gjitha fetë kanë sistem edukativ të njehsuar dhe nuk kanë ndryshime në themel midis tyre.

Besimi se sistemi edukativ është relativ do të thotë zhvlerësimin e vetë këtij sistemi, shmangien e njeriut nga detyrat e tij. Në praktikë është vërtetuar se partizanët e relativitetit edukativ, në fillim e nisnin një veprim me dëshirën e tyre dhe më pas, për ta vazhduar dhe për ta mbështetur mbi një bazë logjike, ndikohen nga idetë e tyre në lidhje me relativitetin e sistemit edukativ.

Veçoritë e sistemit edukativ islam

Sistemi edukativ islam përbëhet nga një disa veçori, ku ne do të trajtojmë më poshtë disa prej tyre.

1- Shumëllojshmëria e mësimeve të sistemit edukativ islam

Një nga përparësitë e sistemit edukativ islam është shumëllojshmëria e mësimeve të tij. Mësimet e këtij sistemi janë aq të shumta, sa nuk mundemi t'i paraqesim në një tabelë. Njerëzit, që njohin Kur'anin e Shenjtë dhe hadithet, e kanë të qartë, se sa i gjerë është sistemi edukativ islam. Mund të them pa frikë se asnjë lloj problemi, sado i imët qoftë, nuk është lënë pa trajtuar. Çështjet më problematike dhe më të thella, në lidhje me problemet shpirtërore dhe me edukimin shpirtëror, janë shprehur me fjalë të thjeshta dhe fjali të shkurtër, së bashku me zgjidhjet e tyre. Pikërisht, këto urdhra të shumëllojshme dhe të thella në kuptim përbëjnë mrekullinë më të madhe për të vërtetuar legjitimitetin e kësaj feje qiellore.

2- Dimensioni i përgjithshëm i rregullave edukative islame

Një veçori tjetër e sistemit edukativ islam është se çdokush, në çfarëdo nivel shpirtëror, mendor apo fizik, në çfarëdo kohe dhe vendi qoftë, mund t'i përdorë dhe të përfitojë nga mësimet islame, pra, si kundër mësimeve filozofike që vlejné për një shtresë të caktuar njerëzish me një kapacitet të caktuar, ato janë të vlefshme për këdo, kudo dhe kurdoherë. Duhet të jemi të ndërgjegjshëm se një doktrinë, në një shoqëri të caktuar, nuk duhet të projektohet për një shtresë të caktuar apo për një elitë njerëzish, por duhet që të gjithë, sipas mundësive dhe talentit të tyre, ta kuptojnë dhe ta aplikojnë atë. Mësimet islame janë në një formë të tillë, që, megjithë thellësinë e kuptimit të tyre, janë të konceptueshme dhe të përdorshme për të gjithë. Ata që janë në rrugën e zhvillimit shpirtëror dhe mendor e kuptojnë më mirë thellësinë dhe saktësinë e këtyre mësimeve.

Është me vend të theksohet se thjeshtësia e paraqitjes së jashtme e këtyre mësimeve nuk duhet kuptuar se vetë mësimet janë të një niveli të ulët, por në vetvete kjo tregon edhe një herë për një tjetër mrekulli, nga mrekullitë e panumërta të Islamit, ku thjeshtësinë e jashtme e ka kombinuar shumë bukur me thellësinë e kuptimit.

3- Përputhja dhe sinkronizimi në rritjen dhe zhvillimin e virtyteve njerëzore

Njeri perfekt nuk është ai që zhvillon një ose disa virtyte njerëzore, por ai që i zhvillon të gjitha vlerat dhe virtytet njerëzore në bazë të kapacitetit të tij dhe në mënyrë të sinkronizuar dhe të njëtrajtshme. Zhvillimi i një virtyti sjell zhvillimin e njërit prej dimensioneve të karakterit të njeriut dhe si rrjedhim, zhvillimin e një pjese të talentit të përgjithshëm të njeriut. Mund të thuhet se njeriu arrin lumturinë e tij të plotë kur të gjitha dimensionet e karakterit të tij kanë arritur maksimumin e tyre, duke sjellë zhvillimin e tërë talentit të tij.

Një tjetër veçori e sistemit edukativ islam është se nuk zhvillon vetëm një nga virtytet njerëzore ose disa prej tyre, por ka një këndvështrim total mbi tërësinë e virtyteve njerëzore, duke i zhvilluar ato në mënyrë komplekse, pa anashkaluar ndonjërin prej tyre.

Për shembull, detyrimet personale, në krahasim me detyrimet familjare apo me detyrimet shoqërore, kanë të njëjtin prioritet si dhe shumë të tjera të ngjashme me këto, kështu që duhen zhvilluar paralelisht në mënyrë të barabartë. Personalitete dhe figura të shumta islame janë shembuj të zhvillimit të virtyteve njerëzore dhe jo një apo dy prej tyre.

Duhet pasur kujdes se rritja tej mase e njëres prej virtyteve njerëzore, duke lënë pas dore të tjerat, te një njeri apo një grup njerëzish ose shoqëri, bëhet shkak që ky virtyt të shndërrohet në antivirtyt, dhe ky njeri apo kjo shoqëri të dalë nga gjendja e ekuilibrit. Për shembull, në qoftë se një njeri, do t'i kushtonte më tepër vëmendje predikimit se sa studimit, jo vetëm që nuk do t'i afrohej lumturisë absolute, por do të

krijonte shqetësime dhe dëme tek të tjerët, për shkak të paditurisë dhe injorancës së tij, si dhe anasjelltas.

Ndër fjalimet e Imam Sadik Xhaferit (paqja dhe bekimi i All-llahut qoftë mbi të), kemi: “Dy grupe njerëzish më bëjnë të vuaj. Dijetarët e paskrupullt e të pa fe dhe besimtarët e paditur dhe injorantë. Të parët, me shpirtin e tyre të keq, pengojnë njerëzimin drejt shkencës dhe dijes, ndërsa të dytët, me paditurinë dhe injorancën e tyre, pengojnë shoqërinë drejt predikimit dhe besimit.”

Kriteret e studimit të perfeksionit

Njerëzit, që duan të hedhin hapat e tyre drejt përsosmërisë, duhet të kenë parasysh disa pika, në mënyrë që të jenë të suksesshëm. Më poshtë do të trajtojmë disa prej tyre.

1- Lëvizja graduale: Shkallët e perfeksionit shpirtëror mund të krahasohen me ato të zhvillimit fizik dhe trupor të njeriut. Njeriu, për të arritur një pjekuri fizike, duhet të kalojë disa etapa njëra pas tjetrës, ku në çdo etapë, disa prej pjesëve dhe aftësive trupore marrin formën e tyre të plotë. Duke filluar që nga periudha e shtatzënisë, e qumëshit, e fëmijërisë ... etj, derisa të arrijë formën e tij të plotë, pra, mbi të gjitha njeriut i duhet kohë. E njëjta gjë është edhe me zhvillimin e tij mendor dhe shpirtëror. Nuk duhet pritur që një njeri, në një kohë shumë të shkurtër dhe pa kaluar etapat e duhura, të arrijë një formë të plotë dhe perfekte shpirtërore. Zhvillimi mendor i njeriut, në kushte normale, arrihet në sajë të punës, studimit, përvojës, praktikës dhe pa këta faktorë nuk kemi zhvillim mendor të vetvetishëm. Edhe zhvillimi shpirtëror i njeriut është i pa mundur pa luftën kundër vetive të këqija dhe studimin e hollësishëm të virtyeteve njerëzore. Ndonjëherë lufta kundër një vetie të shëmtuar (si për shembull mendjemadhësisë, gënjeshtërisë, vjedhjes, xhelozisë etj) mund të zgjasë me vite dhe më në fund të duruarit do t'ia dalin mbanë duke qenë të lirë dhe në rast të kundërt do të mbeten pesimistë.

2- Stabiliteti dhe qëndrueshmëria e hapave: Duke pasur parasysh se rruga e perfeksionit shpirtëror është rrugë e gjatë dhe e vështirë, hedhja e hapave të qëndrueshëm dhe rezistenca në këtë rrugë janë faktori kryesor i suksesit. Disa njerëz, në fillim, mund të ecin me shpejtësi drejt perfeksionimit, por me kalimin e kohës nuk i qëndrojnë dot vështirësive dhe lodhen shpejt, duke mbetur në vend dhe duke mos pasur progres. Që të shmanget ky fenomen negativ, duhet që njeriu, me rezistencën e tij, t'u bëjë ballë vështirësive dhe kohës së gjatë që mund t'i duhet për të arritur atje ku dëshiron.

Ndjekës i perfeksionimit nuk është ai që ecën me shpejtësi dhe lodhet shpesh, por ai që ecën ngadalë në këtë rrugë dhe në mënyrë të vazhdueshme.

3- Njohuri dhe dije: Për të qenë të qëndrueshëm në rrugën drejt perfeksionimit duhet të respektojmë disa kushte, ku më i rëndësishmi prej tyre është dija dhe njohuritë mbi të vërtetën. Dëshira mund të dobësohet dhe të humbasë me kalimin e kohës për shkak të vështirësive të ndryshme. Njerëzit që i hedhin hapat mbi bazën e ndjenjave ose të ndikuar nga të tjerë, pa u mbështetur në dijet dhe njohuritë e tyre që kanë mbi të vërtetën, pas një farë kohe do të humbasin dëshirën e tyre. Të tillë njerëz, në hapat fillestare besojnë se gëzimi dhe kënaqësia do t'i shoqërojnë gjatë gjithë rrugës, por me kalimin e kohës dhe shkallëzimin e vështirësive nuk mbetet asgjë nga gëzimi dhe kënaqësia fillestare, sepse nuk është e bazuar në njohuritë dhe dijen, por në ndjenjat dhe të ndikuar nga faktorë të tjerë të jashtëm. Në këtë kontekst, këta njerëz i humbasin forcat për të vazhduar gjatë kësaj rruge. Ndërsa njerëzit, që i bazojnë hapat e tyre në dijet dhe njohuritë që kanë mbi të vërtetën, jo vetëm që nuk lodhen dhe nuk e humbasin dëshirën për të vazhduar këtë rrugë, për shkak të përshkallëzimit të

vështirësive dhe pengesave, por u rritet dëshira dhe forcat shpirtërore për të hedhur hapa të tjera të sigurt në rrugën e Zotit.

Sigurisht që nuk duhet harruar se, pas përkshimit të këtyre hapave dhe kalimit të etapave të ndryshme, duhet falënderuar Zoti, duke pasur besim të plotë tek Ai dhe nuk duhet të bëhemi pesimistë nga mëshira e Tij. Zoti në Kur'anin Famëlartë u ka premtuar njerëzve, që përpiqen në rrugën e Tij, se do t'i ndihmojë në përballimin e pengesave dhe do t'i orientojë drejt rrugës së vërtetë. Ky është një premtim qiellor dhe në premtimin e Zotit nuk ka dyshime dhe iluzione.

“Ata që luftojnë për çështjen Tonë, sigurisht, Ne do t'i udhëzojmë drejt udhëve Tona. Vërtet, Allahu është me punëmirët! (El- Ankebut: 69)

Pendimi ose rikthimi drejt Zotit

Pendimi është virtyt njerëzor

Një nga virtytet njerëzore, që e dallon njeriun nga krijesat e tjera (kafshët, objektet pa shpirt, bimët) është pendimi. Pendimi, në vetvete, është ndryshimi i rrugës së njeriut në formën e një revolucioni të brendshëm kundër tij. Ky është i vetmi virtyt që njeriu mund t'i rebelohet vetvetes. Ndoshta mund të lindë pyetja: “Si mund t'i rebelohet njeriu vetvetes?” Siç e kemi theksuar edhe në kapitujt e mëparshëm, shpirti i njeriut ka nivele të ndryshme, të larta apo të ulëta, gjithashtu njeriu ka virtyte dhe dëshira të ulëta. Mëkati, në vetvete, është mbretërimi i instinkteve të ulëta të njeriut dhe i një stadi të ulët shpirtëror, ku si reagim i kësaj gjendjeje të krijuar është pendimi në formën e një revolucioni të brendshëm që krijohet si rezultat i virtyteve njerëzore dhe stadeve më të larta shpirtërore, kundër kësaj gjendjeje të ulët satanike. Rebelimi i brendshëm është në mënyrë të tillë që virtytet njerëzore, kur sulmohen nga instinktet e ulëta, japin një kundërveprim respektivisht në përpjesëtim të drejtë me nivelin dhe stadin e virtyteve dhe me pastërtinë shpirtërore të njeriut. Pra, sa më të larta të jenë virtytet e njeriut, aq më i ashpër dhe i menjëhershëm është rebelimi i brendshëm i tij. Një shpirt i pastër ka një ndjeshmëri shumë të lartë dhe kundrejt gabimit më të vogël reagon vrullshëm. Në rast se shpirti i njeriut është i infektuar dhe i ndotur, e humbet ndjeshmërinë e tij duke u errësuar gradualisht dhe si rezultat nuk reagon, madje edhe kur ka të bëjë me mëkate të mëdha. Në këtë kontekst, pendimi është një ndryshim dinamik dhe një revolucion i brendshëm plot vlera tek njeriu. Pendimi luan një rol thelbësor në përcaktimin e fatit të tij, prandaj studimi i pendimit zë një vend të rëndësishëm në njohjen e njeriut.

Pendimi dhe pastërtia e mëkatit

Kur njeriu bëhet i vetëdijshëm për fundin e hidhur të mëkateve dhe vështirësive që e presin, zgjohet nga gjumi që e ka kapur dhe vihet në kërkim të shpëtimit, duke e ditur se, përveç Zotit, nuk ka tjetër që ta shpëtojë. I rikthehet rrugës së Zotit për të gjetur shpëtim në ndihmën e pafund të Tij. Kush përveç Zotit i fal mëkatet? Profeti Muhammed (paqja dhe bekimi i All-llahut qoftë mbi të), ka thënë: *“Për çdo dhembje ka një ilaç dhe ilaçi i mëkateve është pendimi dhe kërkimi i ndjesës.”*

Çdo njeri, që zgjohet, e kupton batakun që e ka mbuluar. Nuk duhet të ketë dyshim se rruga më e mirë për të është pendimi dhe rikthimi drejt Zotit. Në qoftë se nuk e hedh këtë hap, ai nuk mund të hedhë dot hapa të tjerë drejt Zotit, sepse pendimi është krahasuar si dera që të ndihmon për të hyrë në dyer të tjera. Pra, hapi i parë në drejtim të Zotit është pendimi.

Pendimi është një revolucion i brendshëm që zgjon njeriun dhe e drejton atë drejt Zotit. Si rezultat i këtij rebelimi të brendshëm, zemra e njeriut pastrohet nga ndryshku i mëkateve, duke shpëtuar nga vdekja shpirtërore. Mund të themi se pendimi është uji i jetës së zemrave dhe pastërtisë së shpirtit. Imam Aliu (paqja dhe bekimi i All-llahut qoftë mbi të), ka thënë: “Pendimi i ruan zemrat e pastra dhe i lan ndotjet e mëkateve.”

Sihariqi i mëshirës dhe i shpresës

Zoti i ka këshilluar të gjithë besimtarët për pendesë, që të shpresojnë për shpëtim. *“...Të gjithë ju o besimtarë, kthehuni tek All'llahu të penduar, që të arrini shpëtimin.” (ajeti 31-sure Nur).*

Më pas jep sihariqin e pranimit të pendimit duke iu dhënë shpresë zemrave të mjeruara: *“Ai e pranon pendimin e robëve të Vet i, fal gjynahet dhe i di të gjitha çfarë punoni ju.” (ajeti 25-sure Shura).*

Edhe në hadithin Kudsî thuhet: *“Në qoftë se ata që largohen prej Meje, po ta dinin se sa shumë i dua Unë, padyshim se, nga dashuria e madhe, do të vdisnin për Mua.”*

Pendimi i vërtetë

Siç thamë edhe më lart, pendimi ndodh kur njeriu e kupton gabimin dhe përpiqet ta rregullojë atë. Në qoftë se njeriu nuk e kupton apo nuk përpiqet ta rregullojë gabimin e tij, atëherë nuk kemi pendim të plotë. Shenja dalluese e pendimit është kur njeriu bie viktimë e keqardhjes, sepse cilido, që e shikon veten në kufirin e humbjes dhe të dështimit, ndien keqardhje dhe mërzitje. Prandaj, derisa në shpirtin e njeriut të rëndojë frika dhe keqardhja për gabimin e bërë, nuk do të kemi pendim të plotë. Mbi bazën e kësaj keqardhjeje dhe frike, humbja dhe dështimi që ka pushtuar zemrën e njeriut tretet dhe sheshohet plotësisht.

Në lidhje me pendimin e vërtetë, Profeti Muhammed (paqja dhe bekimi i All-llahut qoftë mbi të), ka thënë: *“Ai njeri që pendohet pas gabimit, është njëlloj si ai njeri që nuk ka bërë gabim.”*

Për shkak të keqardhjes së pendimit, që vendoset në shpirtin e njeriut, shija e ëmbël e mëkatit shndërrohet në një shije të hidhur, të padëshirueshme dhe derisa shija e ëmbël e mëkatit të mbetet në shpirtin e njeriut, edhe pendimi nuk do të jetë i plotë. Një nga profetët, për të pranuar pendimin e njërit prej çifutëve, u lut dhe meditoi. “Profetësia u dërgua: “Edhe sikur të gjithë qiellorët për nderin tim të luteshin në favor të pendimit të tij, nuk do të pranohej derisa ëmbëlsia e gabimit të mbetet në zemrën e tij.”

Duhet theksuar se pendimi nuk është një veprim i jashtëm dhe sa për sy e faqe, por një ndryshim dinamik i fuqishëm, që ndodh brenda njeriut dhe e transformon plotësisht gjendjen e tij të mëparshme. Nuk duhet imagjinuar se me një të thënë “Estagfir-u-llah” mund të neutralizohen qindra gabime, tradhti dhe kundërshtime. Por duhet të ndikojë thellë në shpirt, në mënyrë që të neutralizohen të tilla mëkate. Ata, që kalojnë orë, ditë dhe net të tëra duke qarë për shkak të një gabimi, tregojnë se e kanë kuptuar rëndësinë e pendimit dhe për këtë qëllim kalojnë kohë të vështira për forcimin dhe stërvitjen shpirtërore. Duke qenë në dijeni të mëkateve të tyre, ata nuk pretendojnë që Zoti e ka për detyrë t’u falë mëkatet, apo me një thënie “Audhu-bi-lah” dhe me një pendim sipërfaqësor të mund t’i rrëmbejnë mëshirën Zotit, por e kuptojnë se ishin vetë ata që, me dorën e tyre, krijuan një disfatë shpirtërore të tillë dhe kundërshtuan në të njëjtën kohë urdhrat e Zotit. Në këtë mënyrë, ata janë duke zgjatur duart e tyre për të kërkuar mëshirën e Zotit dhe për t’iu afruar Atij. Kjo është e vetmja mënyrë që Zoti ia fal mëkatet dhe në të njëjtën kohë të mos bëhen pesimistë nga mëshira e Zotit. Humbja e shpresës tek mëshira e Zotit është në vetvete një mëkat i pallogaritshëm,

ose siç thuhet nga personalitetet e ndryshme fetare, nuk ka mëkat më të madh se sa humbja e shpresës tek Zoti.

Kushtet e pendimit të plotë

Si çdo gjë, edhe pendimi ka kushtin e tij. Nëse njeriu bën një gabim e pendohet, pendimi i tij pranohet. Por nëse ai përsërit disa herë të njëjtin gabim e vazhdimisht pendohet dhe kërkon falje duke ndier keqardhje për këtë gabim, pendimi i tij nuk pranohet.

Imam Rizai (paqja dhe bekimi i All-llahut qoftë mbi të), thotë: “Ai që nxjerr mësim nga gabimi dhe e përsërit atë, është njëlloj sikur tallet me Zotin.”

Nga ana tjetër, edhe pse pendimi dhe kërkimi i ndjesës e pastrojnë njeriun nga gabimi, nuk janë në gjendje që të drejtën e shkelur ta kompensojnë. Kur njeriu shkel të drejtat e tjetrit (të drejta kundrejt njerëzve), përveç pendimit dhe kërkimit të ndjesës, duhet t’ia rikthejë këto të drejta atij menjëherë dhe në të njëjtën kohë të marrë aprovimin e tyre, edhe në qoftë se ka detyrime në predikim (të drejta kundrejt Zotit) duhet t’i kryejë ato. Njeriu që pendohet duhet të shikojë me vëmendje të madhe të kaluarën e tij. Në qoftë se ka borxhe të ndryshme dhe ka shkelur të drejtat e të tjerëve, duhet që në radhë të parë t’i rikthejë ato, ose, nëse nuk ka mundësi, t’i kompensojë. Nga ana tjetër, me anë të predikimit dhe dritën e lutjeve mund të neutralizojë errësirën e mëkateve të tij dhe borxheve që i ka Zotit. Me fjalë të tjera, ai duhet të mbledhë kënaqësinë duke i kompensuar dhe rikthyer gjërat që i ka përfituar pa të drejtë nga njerëzit dhe duhet të falënderojë Zotin për pranimin e pendimit të tij. Çdo lloj pakënaqësie dhe mërzi, dëmtimi material dhe shpirtëror që ka shkaktuar tek të tjerët në të kaluarën, duhet patjetër dhe me çdo kusht ta shlyejë duke kërkuar falje dhe duke qenë i sigurt që është falur. Në lidhje me këtë, kemi një thënie të imam Muhamed Bekirit (paqja dhe bekimi i All-llahut qoftë mbi të): “Derisa t’i jepet e drejta e plotë atij që i është mohuar, pendimi nuk do t’i pranohet penduesit.”

Në këtë këndvështrim, mund të kuptohet "e drejta njerëzore" dhe vlera e saj. Në rast se njeriu shkel të drejtat materiale, sidomos ato shpirtërore, që në kohën e pendimit nuk ka mundësi t’i kompensojë, si për shembull, njerëzit që pengojnë të tjerët drejt së vërtetës, hedhin gurë në rrugën dhe në të vërtetat shpirtërore, plakin njerëzit, i drejtojnë të tjerët në mënyrë të drejtpërdrejtë ose indirekt në drejtim të mëkateve, i nxisin mëkatet në forma të ndryshme, etj, ato mbeten të mbartura në jetën e tij dhe nuk mund t’i kompensojë dot, koha e mbartjes është e gjatë, shumë e gjatë, madje edhe pas vdekjes derisa njeriu të përballet me Ditën e Gjykimit dhe aty të informohet për të tilla mëkate.

Thuhet: “Lum ai që vdes dhe bashkë me të vdesin dhe mëkatet e tij.” Gjithashtu, tregojnë se një dijetar çifut u pendua. Për Profetin e kohës u dërgua profetësia që të thotë: *"Në qoftë se mëkati është ndërmjet meje dhe teje e kam falur, dhe ti u pendove, po me fisin, që drejtoje, çfarë të bëjmë?"*

Nga këto fjalë kuptojmë se pendimi varet edhe nga rëndësia e pozicionit të njeriut dhe se sa varen të tjerët prej tij. Si për shembull: prindërit, mësuesit, drejtuesit, klerikët, shkrimtarët etj.

Njeriu të analizojë me saktësi kushtet e pendimit, duke parë se mos ka borxhe të ndryshme dhe në rast se po, duhet t’i rikthejë ato. Vetëm në këtë rast ai mund të ketë shpresë për pranimin e pendimit të tij. Në qoftë se i ka mbetur ndonjë pikë dyshimi në lidhje me pendimin e tij, duhet të jetë i sigurt se ky dyshim vjen si rezultat i mos plotësimin të kushteve të pendesës, në rast të kundërt, dyshimi dhe mendimi i tij, se pendimi nuk është pranuar, nuk është i vlefshëm. Prandaj, njeriu duhet që, me aq sa mundet, të krijojë kushtet e një pendimi të plotë, derisa të përfshihet në faljen qiellore.

Pendimi i plotë nga pikëpamja e imam Aliut (paqja dhe bekimi i All-llahut qoftë mbi të)

Gjithçka që u trajtua për pendimin e vërtetë, shprehet edhe në hadithin e Emirit të besimtarëve (paqja dhe bekimi i All-llahut qoftë mbi të): Dikush, në praninë e imam Aliut (paqja dhe bekimi i All-llahut qoftë mbi të), tha “Estagfir-u-llah”.

Hazreti Ali i tha: “A e di se çfarë do të thotë fjala estagfir?”

Më pas i tha: “Estagfir është një gradë e lartë dhe për të duhen plotësuar 6 kriteret.

- 1- pendim të plotë dhe keqardhje për ndodhi të tilla nga e kaluara;
- 2- vendimi për lënien dhe mos përsëritjen e saj përgjithmonë;
- 3- respekto të drejtat e të tjerëve, që, kur të vdesësh, të jesh i pastër dhe kur të takohesh me Zotin, të mos i jesh borxhli askujt;
- 4- çdo urdhër dhe rregull, që nuk ke respektuar, ta kompensosh;
- 5- duhet ta tretesh me dhembje mishin që është haram në trupin tënd, derisa lëkura të bashkëngjitet me kockën dhe më pas të rritet mishi i ri;
- 6- prefero mundimin e lutjeve dhe predikimeve, siç preferove ëmbëlsinë e mëkatit dhe kur t'i kesh bërë të gjitha këto thuaj: “Estagfurullah!”.”

Sigurisht, dy ndarjet e fundit janë kushte të pendimit perfekt dhe në këtë mënyrë njeriu arrin në nivelet e perfeksionimit.

Pjesa e dytë

Njohuri mbi njeriun (2)

- * *Grupet e ligjeve në jetën e njeriut*
- * *Njeriu në shoqëri*

Familja në Islam

- * *Të drejtat familjare në Islam*
- * *Kushtet e zgjedhjes së bashkëshortit*
- * *Sistemi familjar i dëshiruar*

Grupet e ligjeve në jetën e njeriut

Zhvillimi i ngjarjeve në botë është një seri ligjesh fikse të lidhura ngushtë me njëra-tjetrën. Këto ligje, në të vërtetë, përbëjnë gjithë filozofinë e shkakut dhe të pasojës. Këto ligje, në gjuhën fetare, quhen tradita qiellore.

“Pastaj do të thonë: “Lavdi Allahut, i Cili e ka larguar hidhërimin nga ne. Vërtetë, Zoti ynë është Falës dhe Falënderues.” (El-Fatir: 34)

Zbulimi i këtyre ligjeve i përket shkencave të ndryshme. Çdo ligj shkencor, fizik, shoqëror etj, është pjesë e sistemit të përgjithshëm të ligjeve të Zotit. Ligjet shkencore nuk janë në kundërshtim me ligjet e përgjithshme të krijimit që mbretërojnë kudo dhe anasjelltas, por në përputhje të plotë me njëri-tjetrin. Këtë fakt e vë në dukje dhe Kur'ani i Madhëruar.

Një pyetje që mund të lindë këtu është: Në qoftë se këto ligje fikse janë përcaktues të ngjarjeve të ndryshme në botë dhe si rezultat i fatit të njeriut, atëherë çfarë roli ka zgjedhja e lirë tek njeriu?

Në përgjigje të kësaj pyetjeje duhet të themi se njeriu është një krijesë e pajisur me dëshirë dhe të drejtë zgjedhjeje dhe, çdo veprim që ai kryen, në bazë të kësaj dëshire, bën pjesë në njërin nga grupet e sistemit të përgjithshëm të ligjeve të Zotit. Për shembull: ai njeri që beson, bën pjesë në **ligjin e provimit** të sistemit të përgjithshëm

të ligjeve. Pra, besimi i tij vihet në provë në mënyra të ndryshme dhe me një fjalë, është në një provim të gjatë dhe të vazhdueshëm, ku çdo sukses në këtë provim, bën të mundur lartësimin e pozicionit të shpirtit të tij, duke e kaluar atë në një nivel më të lartë dhe duke e afruar më shumë me Zotin. Po ashtu, në qoftë se nuk do të jetë i suksesshëm në këtë provim të pandërprerë, shpirti i tij nuk do t'i fitojë ato grada të larta, e në këtë mënyrë nuk do t'i afrohet Zotit, duke mbetur jashtë zhvillimit të perfeksionimit të tij. Njeriu, në këtë rast, vepron me dëshirën e tij dhe veprimet e tij bëjnë pjesë në **ligjin e provimit**, ku në bazë të saj do të përcaktohet edhe mëshira e Zotit për të. E njëjta gjë është edhe me shoqëri të ndryshme, që marrin vendime në grup, duke pasur parasysh se veprimet e tyre nuk janë gjë tjetër veçse pjesë e një grupi të caktuar ligjesh në tërësinë e përgjithshme të ligjeve të krijimit. Më poshtë do të trajtojmë disa nga ligjet kryesore që mbretërojnë kudo.

Ligji i provimit

Një nga ligjet e përgjithshme të rregullave qiellore është grupi i provimit. Ndryshimi midis provimit të njeriut dhe provimit qiellor është se në lidhje me të vërtetat e krijesave nuk kemi dijeni dhe përpiqemi që, me anë të eksperimenteve dhe provimeve të ndryshme, të zbulojmë brendësinë dhe thellësinë e ndërtimit të tyre. Në këtë mënyrë ne zvogëlojmë paditurinë tonë në lidhje me to. Por një veçori të tillë nuk mund t'ia veshim kurrë Zotit të Ditur dhe të themi se provimi i Zotit ka të njëjtën karakteristikë të përvetësimit të dijeve si të krijesave të Tij. Provimi qiellor është me qëllim që të krijojë kushte dhe forma të ndryshme për të shfaqur karakterin dhe veçoritë e brendshme njerëzore, ku në çdo rast, njeriu, mbi bazën e zgjedhjes së tij të lirë, të shfaqë dëshirën e zgjedhjes. Në çdo rast njeriu nuk ka më shumë se dy rrugë për të zgjedhur, atë të së vërtetës dhe atë të mëkatit. Mbi bazën e këtyre zgjedhjeve, në fund do të zbulohet edhe tërësia e tij. Provimi qiellor nuk i përket vetëm një pjese të njerëzve dhe është plotësisht i pavarur në lidhje me kohën dhe vendin. Të gjithë njerëzit, pa përjashtim, bëjnë pjesë brenda kufirit të provimit të Zotit. Jetën e përditshme e konsiderojmë si një rrjedhë të zakonshme dhe jo si një provim apo test dhe mendojmë se provimet janë në pika apo momente të veçanta të jetës, ku kemi të bëjmë me ngjarje të veçanta. Pikërisht, në këto momente besimi i njeriut vihet në provë me anë të pendimit. Por, në qoftë se do ta shikojmë problemin më thellë, do të konstatojmë se çdo orë e jetës sonë është e shoqëruar me dhjetëra ose qindra provime qiellore. Sukseset dhe humbjet tona, nga momenti në moment, regjistrohen me përpikëri në dosjen tonë. *“Vërtet mendojnë njerëzit, se do të lihen të thonë “Ne besojmë”, pa u vënë në provë?!” (El- Ankebut: 2)*

Mënyrat e provimit

Mënyrat e provimeve qiellore janë të ndryshme në bazë të çështjeve dhe rasteve me të cilat njeriu përballet. Ndonjëherë provimi qiellor ka të bëjë me dëshirat e brendshme të tij dhe ndonjëherë me veprime dhe faktorë të jashtëm.

Provimi i dëshirave dhe qëllimeve të brendshme: Mendimet dhe dëshirat e brendshme të njeriut mund të jenë një mënyrë provimi për njeriun, për shembull, gjykimi rreth njerëzve të ndryshëm mund të merret në provim, dhe mjafton që ai të ketë mendim të keq për një njeri, pa ndonjë shkak, që të hedhë një hap negativ në besimin e vet. Njeriu ka për detyrë që, në lidhje me besimtarët dhe besimtare, të ketë mendim të mirë dhe të jetë optimist, duke shmangur kështu një hap prapa në besimin e tij. Zemra e besimtarit duhet të jetë qendra e dëshirave të mira dhe pozitive. Edhe nëse gjatë jetës së tij mund të mos kryejë veprime të tilla, ai duhet të ketë dëshirën që të tilla veprime pozitive të ndodhin. Drita e besimit, mbi bazën e këtyre dëshirave të

pëlqyeshme nga Zoti, forcohet dita-ditës. Në lidhje me këtë pikë, Imam Sadiku (paqja dhe bekimi i All-llahut qoftë mbi të), thotë: “Unë fakiri të kërkoj ty o Zot të më forcosh dëshirën për të kryer punë të mira, sepse Ti, o Zot, e njeh në thellësi pastërtinë e dëshirave të mia dhe më vonë do të më japësh të njëjtin shpërblim, edhe sikur këto punë të mira të mos kryhen me shpërblimin e kryerjes së tyre.”

Përveçse dëshirave pozitive, që u përket një shpërblim në Ditën e Gjykimit, nganjëherë vërtetësia e besimit provohet edhe prej këtyre dëshirave. Profeti i Islamit (paqja dhe bekimi i All-llahut qoftë mbi të), për këtë çështje na thotë: *“Myslimani që nuk është përpjekur për të mbrojtur Islamin dhe nuk ka pasur në zemrën e tij një dëshirë të tillë, pas vdekjes, është njëllë si i pa fe.”*

Pra, sikur gjatë jetës së njeriut të mos ketë kushte për të mbrojtur Islamin, ai duhet të ketë në brendësi të tij dëshirën për të zbatuar një rregull të tillë. Kjo në vetvete është një provim për të matur besimin e tij. Pra, pa këtë provim, nuk pastrohet pluhuri nga fytyra e besimtarit.

Provimi i veprimeve të jashtme: Ndonjëherë te njeriu testohen veprimet e jashtme që kryhen nga shqisat dhe gjymtyrët e tij. Respektimi i të drejtave të të tjerëve, kryerja e detyrave që janë caktuar mbi ne, mos kryerja e veprimeve, që për ne janë të ndaluara dhe të tjera të ngjashme me këto, tek çdo njeri janë objekte provimi.

Shkallët e provimit

Secili, sipas pozicionit dhe gjendjes së tij personale dhe asaj shoqërore, si dhe duke pasur parasysh kapacitetin e tij mendor dhe shpirtëror, do të merret në provim. Për shembull, profetët dhe njerëzit që janë shumë afër Zotit, detyrimet si dhe mëkatet e mëdha dhe të vogla nuk bëjnë pjesë në provim, sepse në këtë nivel kanë përparësi predikimi dhe veprimet që duhen kryer me saktësi të lartë. Niveli shpirtëror i këtyre njerëzve është aq i lartë, sa ndjeshmëria është shumë e madhe, ku pakujdesia më e vogël, në lidhje me përparësitë, do t’u shkaktonte shumë dëme të mëdha shpirtërore.

Me po të njëjtën rritje të niveleve shpirtërore rritet edhe vështirësia e provimit, derisa edhe gabimi më i vogël, i paparamenduar, do të shoqërohej me dëmtime shpirtërore të konsiderueshme. Prandaj njerëzit më perfekt janë ata që dalin me sukses nga këto provime. Në lidhje me këtë, kemi një thënie të imam Sadikut (paqja dhe bekimi i All-llahut qoftë mbi të): “Besimi i besimtarëve qëndron në një anë të peshores, ndërsa provimi qëndron në anën tjetër, në mënyrë të tillë që gjithmonë të jenë në ekuilibër.”

Pra, sa më i madh është besimi, edhe provimi është në po të njëjtën shkallë vështirësie. Në Kur'anin e Madhëruar përmenden shumë raste për provimet e profetëve. Në qoftë se njeriu do t’i lexonte, do të kishte një këndvështrim më të mirë në këtë çështje. Për shembull, në lidhje me profetin Ibrahim (paqja dhe bekimi i All-llahut qoftë mbi të), thuhet se ky personalitet qiellor i kaloi me sukses të gjitha provimet, duke arritur një nivel të lartë, ku përveç gradës “Imam” fitoi edhe gradën e “Profetit”: *“Kur Allahu e provoi Ibrahimin me disa urdhërime, të cilat ai i plotësoi, Allahu i tha: “Unë do të të bëj ty imam (prijës) të njerëzve!”*

- *“Po pasardhësit e mi?” - pyeti ai. Allahu tha: “Premtimi Im nuk i përfshin të padrejtët.” (El- Bekare: 124)*

Llojet e provimeve

Shpesh provimi qiellor është në kuadrin e vështirësive, ngjarjeve të rënda, vdekjeve etj. Vështirësitë dhe vuajtjet janë ato që gjatë jetës së njeriut merren si temë provimi. Detyra e njeriut, përballë këtyre provimeve, është durimi dhe rezistenca, si dhe ekzistenca e ndjenjës së frikës nga Zoti.

“Sigurisht që Ne do t’ju provojmë me frikë dhe uri, me dëmtim të pasurisë, të njerëzve dhe të të lashtave! Prandaj, përgëzoji të duruarit...” (El- Bekare:155)

Ndonjëherë provimi është i veshur me rrobat e dëshirës dhe në më të shumtën e rasteve provimet, mbi bazën e dëshirave, janë më të rënda se provimet për vështirësitë dhe vuajtjet, sepse falënderimi për dëshirat është më i vështirë. Në qoftë se njeriu do të përpiqet të kuptojë të vërtetën e dëshirave, atëherë Zoti do t’ia shtojë këto dëshira dhe anasjelltas. Në qoftë se nuk do të falënderonte për ato që i janë dhuruar, mirësia do të zëvendësohej me përbuzjen.

Kur'ani Famëlartë përmend raste të popujve të ndryshëm, të cilëve u janë dhuruar virtyte të shumta, por, duke mos falënderuar, janë përballur me humbje të rënda.

Ligji i drejtimit

Një nga rregullat e përgjithshme qiellore për njerëzimin është ligji i drejtimit. Pas këtij grupi, ku u zgjodh dhe u dërgua Profeti për drejtimin e njerëzimit, rregulla të tjera u formuluan, me qëllimin që njerëzit të përgatiteshin më shumë për ftesën qiellore. Më poshtë do të trajtojmë disa prej këtyre rregullave.

Vështirësitë dhe vuajtjet

Po të vihet re, në përgjithësi, sa herë që dërgohej një Profet për drejtimin e njerëzimit dhe u kërkonte vendosjen e një sistemi drejtues (qeveri) qiellor, njerëzit dhe shoqëritë e tyre përsëri përballeshin me vuajtje të shumta dhe me vështirësi nga më të ndryshmet dhe të gjitha këto janë me qëllimin e vetëm që të krijohen kushte më të favorshme për drejtimin e sigurt të njerëzve. Kur'ani Famëlartë e thekson këtë fakt: **“Ne iu kemi dërguar shumë popujve profetë para teje dhe i kemi dënuar ata me skamje dhe fatkeqësi, për t’u bërë të dëgjueshëm.” (El- En’am: 42)**

Vështirësitë dhe vuajtjet krijojnë kushte të favorshme që njeriu, mbi bazën e nevojave të veta, të zhvishet nga mendjemadhësia dhe me thjeshtësinë e mëparshme të pranojë më lehtë ftesën e profetëve.

Shumëllojshmëria e dëshirave dhe rënia në persekutim

Megjithëse Zoti, mbi bazën e përhapjes së drejtimit, i përball njerëzit me vështirësi, kjo dhuratë qiellore, e veshur me petkun e vuajtjeve, nuk ka ndikim në përgatitjen e dorëzimit vullnetar të zemrave drejt së vërtetës, vetëm në rastin kur vendoset një ligj i egër dhe i ashpër, duke ndryshuar kështu të gjithë rrjedhën e jetës, ku më pas vuajtjet ia lënë vendin qetësisë dhe vështirësitë shndërrohen në mirësi, duke pasur parasysh se Zoti i dërgon këto jo nga rruga e mirësisë, por nga rruga e ashpërsisë.

Dhënia pas qejfeve materiale i bën zemrat të bien në agoninë e mëkateve dhe në fillimet e humbjes së besimit. Në këtë mënyrë, fati dhe rrjedha e një shoqërie shkon drejt errësimit dhe, hap pas hapi, derisa shtypja e degjenerimi e kalojnë masën. Në këtë kohë hyn në fuqi ligji për zhdukjen përfundimtare të tyre.

Kur'ani i Madhëruar, në lidhje me bollëkun e mirësive dhe pakësimin e vuajtjeve pas vështirësive të kaluara, shprehet: **“Pastaj ua shndërronim fatkeqësinë në lulëzim. Por, kur shtoheshin e begatoheshin, ata thoshin: “Edhe etërit tanë i patën goditur hidhërimet e gëzimet”. Kështu që Ne i dënonim papritmas, pa e marrë vesh ata.” (El- A'raf: 95)**

Rregullat e Zotit vendosen kur një njeri apo një grup njerëzish (shoqëri) degjenerohen aq shumë, saqë nuk ka më shpresa për rikthimin e tyre në rrugë të drejtë. Në këto raste Zoti nuk u jep kohë të gjatë këtyre lloj viruseve shoqërore, por urdhëron zhdukjen e tyre. Zhdukja e tyre ngandonjëherë bëhet me anë të ndonjë torturimi qiellor, nganjëherë nëpërmjet ndonjë fatkeqësie të madhe natyrore ose nga

dora e ndonjë njeriu apo grupi tjetër shoqëror. Kjo duhet kuptuar kështu: Kur një njeri apo një popull agresor, që shtyp dhe shkel të drejtat e të tjerëve, mundet që dora e hekurt e ligjit të Zotit, del nga mënga e njerëzve të zgjedhur të tij, zhdok plotësisht dhe mbulon me harresë këtë popull gjakatar. Në lidhje me këtë, Kur'ani Famëlartë thotë: *“Luftoni kundër tyre, që Allahu t’i dënojë ata me duart tuaja, t’i poshtërojë, t’ju ndihmojë juve kundër tyre, t’i shërojë shpirtrat e besimtarëve.”* (Et- Teube: 14)

Rregulli i ndihmës

Përsa i përket pranimit të ftesës profetike, njerëzit ndahen në dy grupe: grupi që i përgjigjet pozitivisht thirrjes, së vërtetës, duke pranuar drejtimin qiellor dhe grupi tjetër, që i shpall armiqësi dhe është i mjaftueshëm me jetën materiale. Mbi bazën e zgjedhjes midis këtyre dy grupeve është formuluar një ligj, që quhet **ligji i ndihmës**.

Zoti në ajetet e sures “Isra”, përveç prezantimit të këtyre dy grupeve, shprehet: *“Sa për atë që dëshiron këtë botë, Ne shpejtojmë që t’i japim çfarë të dëshirojmë atij që duam. Pastaj ia caktojmë atij Xhehenemin, në të cilin ai do të përvëlohet, duke qenë i turpëruar dhe i dëbuar. Sa për atë që dëshiron botën tjetër dhe përpiqet për të me gjithë shpirt e duke qenë besimtar, përpjekja e tij do të shpërblehet. Ne i mbështesim të gjithë me dhuratat e Zotit tënd: edhe këta, edhe ata. Dhuratat e Zotit tënd nuk i mohohen askujt.”* (El-Isra: 18-20)

Rregulli i Zotit është i tillë që çdokush, me dëshirën e tij, zgjedh një rrugë midis së keqes dhe së mirës ose midis Zotit dhe shejtanit dhe në këtë mënyrë, krijon kushte të tilla që rrugën e zgjedhur ta vazhdojë dhe të dalë në pah karakteri i vërtetë. Sa më e keqe të jetë rruga e zgjedhur, aq më tepër do të urrehet nga Zoti. Duke pasur parasysh që rruga e jetës së njeriut është e bazuar mbi zgjedhjen e lirë, duhet të marrim në konsideratë edhe kushtet për të dy grupet e njerëzve. Në të vërtetë, Zoti mirësinë e Tij (që ka për besimtarët) ua rimerr njerëzve që kanë zgjedhur rrugën e shejtanit dhe i lë plotësisht të lirë të vazhdojnë rrugën që kanë nisur. Pra, me një fjalë, kushtet që vendosen për të dy grupet, vendosen me dëshirën e Zotit dhe bëjnë pjesë në ndihmën e Tij.

Suksesi me Zotin

Një ndihmë të veçantë Zoti Fuqiplotë u jep atyre që, me dëshirë të pastër, ndjekin rrugën e drejtë. Këta e njohin mirë botën materiale dhe atë shpirtërore dhe për të arritur suksesin, përpiqen drejt perfeksionimit. Arritja e këtij sukcesi ndodh si shkak i përpjekjeve të vazhdueshme të njeriut në rrugën e Tij dhe Ai (Zoti) i krijon atij kushte që ta arrijë qëllimin më shpejt dhe më lehtë.

Në kapitujt e mëparshëm kemi thënë se duhen kushte të shumta që njeriu, mbi bazën e zgjedhjes së lirë, të kryejë një veprim që ngandonjëherë mungesa e ndonjë kushti shkakton mos realizimin e qëllimit që njeriu ka me këtë veprim. Në lidhje me njerëzit që përmendëm më lart dhe që kërkojnë perfeksionin në rrugën e Zotit këto kushte, që kërkojnë për suksesin e një veprimi, plotësohen njëri pas tjetrit nëpërmjet dëshirës së Zotit, duke i dhënë atij shanset dhe mjetet e duhura për ta arritur qëllimin. Nga ana tjetër, Zoti eliminon pengesat që u dalin përpara dhe që ata të shijojnë mundimin e tyre. Ndonjëherë Zoti u jep ndihmë shpirtërore dhe jo materiale për t’u bërë ballë vështirësive të ndryshme. Kjo lloj ndihme shpirtërore rrit besimin te besimtarët dhe u shton forcat, duke u krijuar edhe qetësinë shpirtërore. Kjo lloj ndihme u jepet njerëzve ose grupe njerëzish apo edhe shoqërive të caktuara. Arsyeja, që ushtri dhe popuj të vegjël janë rreshtuar në sheshin e luftës përballë kundërshtarëve shumë herë më të mëdhenj në numër dhe në mjete dhe kanë dalë fitimtarë, është se fronti i tyre është

përforcuar nga ndihma shpirtërore e dhuruar nga Zoti, duke ua forcuar besimin për fitore.

... *“Por ata që ishin të bindur se do të takoheshin me Allahun, thanë: “Sa herë, me ndihmën e Allahut, një ushtri e vogël ka ngadhënjyer mbi një ushtri të madhe! Allahu është me të durueshmit.” (El- Bekare: 249)*

Historia islame ka raste të shumta që tregojnë për ndihmën e Zotit dhe për ata që janë në rrugën e vërtetë. Një nga këto është edhe lufta historike e Bedrit, ku pas fitores së çuditshme të myslimanëve, Zoti zbuloi perden e kësaj çudie duke thënë:

“A nuk i sheh ata (hebrenj) që u është dhënë një pjesë e Librit?! Atyre iu bëhet thirrje të vijnë te Libri i Allahut për t’i gjykuar, por një pjesë e tyre kthejnë shpinën, duke mos ia vënë veshin. Kjo, sepse ata thonë: “Neve nuk do të na prekë zjarri i Xhehenemit, përveçse disa ditë”. Shpifjet që bënin i kanë mashtruar ata në besimin e vet. Çfarë do të ndodhë me ata, kur t’i tubojmë në Ditën (e Gjykimit), për të cilën s’ka pikë dyshimi, kur çdokujt do t’i jepet shpërblimi i veprave të veta e askujt nuk do t’i bëhet padrejtësi?” (Al- Imran: 23-25)

Ligji i vazhdimit dhe ligji me afat kohor

Për ata që zgjedhën me vetëdije rrugën e shejtanit dhe i shpallën armiqësi së vërtetës, ligji i Zotit është në një formë tjetër, ku dinakëria e Tij ua thëllon gradualisht shmangien e rrugës së zgjedhur, në mënyrë të tillë që, nëse i ka mbetur ndonjë fije shprese, drita e së vërtetës t’ua ndriçojë zemrën, në rast të kundërt, s’i mbetet gjë tjetër veçse torturimit të përjetshëm. Sigurisht që Zoti u jep mëkatarëve kohë të mjaftueshme për t’u zgjuar nga agonia ku kanë rënë. Në qoftë se mëkatarët e vazhdojnë rrugën e tyre me kthesa dhe mëkati u bëhet zakon, atëherë Zoti, në bazë të ligjeve dhe rregullave të veta, i lë të vazhdojnë në këtë rrugë derisa t’u mblidhet filli përfundimisht.

Ky lloj rregulli quhet **ligji me afat kohor**.

“Le të mos mendojnë kurrsesi jobesimtarët se për ata është mirë që ua zgjasim jetën. Ne ua zgjasim jetën vetëm për t’i shtuar gjynahet; për ata ka ndëshkim poshtërues.” (Al Imran: 178)

Nga ana tjetër, ligji me afat kohor mund të shoqërohet herë pas here edhe me dhënien e favoreve të ndryshme, në mënyrë që mëkatarin të mos e kuptojë dhe të jetë larg së vërtetës, duke iu drejtuar ferrit të përjetshëm. Këtë mënyrë afrimi gradual me xhehenemin e quajmë **ligji i vazhdimit**.

“Ndërsa ata që i mohojnë shpalljet Tona, dalëngadalë Ne do t’i shpiem drejt shkatërrimit, pa e kuptuar e do t’u japim afat. Me të vërtetë, plani Ynë është i fortë.” (El- A’rafat: 182-183)

Sigurisht që ekzistojnë ligje dhe rregulla të tjera, si për njerëzit, ashtu edhe për shoqëritë, ku secili ligj zbatohet në raste të veçanta dhe është vendimtar për fatin e njeriut.

Njeriu në shoqëri

Një nga dimensionet e ekzistencës së njeriut është dimensionin shoqëror i tij. Saktësimi i lidhjeve të njeriut me llojin e tij është një çështje me rëndësi në njohjen e njeriut. Në të vërtetë, lloji i njohjes, që ka një doktrinë në lidhje me njeriun si krijesë që jeton në shoqëri, luan rol kryesor në përcaktimin e boshtit orientues të kësaj doktrine. Një grup njerëzish që jetojnë në bazë të ligjeve, traditave, zakoneve të caktuara, përbëjnë një shoqëri të caktuar. Kushti i jetës në shoqëri nuk është që një grup njerëzish të jetojnë pranë njëri-tjetrit të përdorin të njëjtin ujë, ajër dhe ushqime. Edhe pemët e një kopshti janë pranë njëra-tjetrës, ushqehen me të njëjtin ujë dhe lëndë ushqimore dhe përdorin

të njëjtin ajër, por në këtë rast pemët nuk përbëjnë një jetë shoqërore dhe nuk formojnë shoqëri. Ndryshimi midis jetës së njerëzve dhe të kafshëve është se jeta e njerëzve ka dimension shoqëror, domethënë, nga njëra anë nevojat, fitimet, veprimet, aktivitetet, detyrat, profesionet etj, pjesëtohen mbi bazën e rregullave dhe ligjeve, duke përbërë jetën shoqërore dhe shoqërinë në tërësi, ndërsa nga ana tjetër, shumica ka të njëjtin mendim, logjikë, sjellje dhe temperament, që pranohet nga të gjithë dhe si rezultat i siguron unifikimin dhe barazi kësaj shoqërie.

Nevojat e përbashkëta të shoqërisë, si dhe lidhjet e veçanta të jetës shoqërore i bëjnë njerëzit aq të lidhur me njëri-tjetrin, saqë gjithmonë janë në lëvizje për tek njëri-tjetri. Pjesën më të madhe të kohës e kalojnë pranë njëri-tjetrit, sipas nevojave që kanë e kështu, në këtë mënyrë, duke qenë pranë njëri-tjetrit, ata kanë ngjashmëri dhe varësi të fatit midis tyre, e po ashtu pësojnë edhe rreziqe të njëjta. Në lidhje me këtë kemi një hadith të bukur nga Profeti i Islamit (paqja dhe bekimet e All-llahut qofshin mbi të): *“Problemi i njerëzve në një shoqëri është një lloj si problemi i një grup njerëzish të ndodhur brenda një anijeje në mes të detit. Secili është i ulur në vendin e vet dhe bën detyrat e veta në lundrimin e anijes. Një nga këta njerëz tha: “Vendi ku jam ulur është i imi dhe mund të bëj çfarë të dua, sepse më përket mua.” Me sendet që kishte në dorë e shpoi pikërisht pjesën që ndodhej poshtë tij. Në qoftë se njerëzit e tjerë do ta kishin ndaluar, që të mos e bënte një veprim të tillë, nuk do të ishin mbytur, duke u bërë pengesë edhe për mbytjen e tij.”*

Ekzistenca e shoqërisë

Shumë herët janë diskutuar dhe trajtuar faktorët që çuan në krijimin e shoqërisë. Lind pyetja: Njeriu, që në fillim, është krijuar i shoqërueshëm, domethënë, që në fillim u krijua si një element i tërësisë së krijimit njerëzor, me cilësinë që vetvetiu t'i bashkëngjitet kësaj bashkësie të madhe apo nuk u krijua i shoqërueshëm, por ishin faktorët e jashtëm ata që e detyruan të bëhet i shoqërueshëm dhe të pranojë jetën shoqërore? A mos vallë, në natyrën dhe karakterin e tij nuk ekziston asnjë fije lidhëse me jetën shoqërore? Përvoja e tij tregon se i vetëm nuk mund ta vazhdojë jetën, kështu që u detyrua, në kundërshtim me dëshirat e tij, ta pranojë shoqërinë. Njeriu nuk u krijua as i shoqërueshëm, as nuk u detyrua nga ndonjë faktor i jashtëm ta pranojë shoqërinë, por mbi bazën e arsyesimit dhe të logjikës së tij arriti në përfundimin se mund të jetonte më mirë duke zgjedhur shoqërinë, se sa nga vetë dhuratat e dhëna nga Krijuesi.

Nevojat jetësore

Përpara se të trajtojmë se si është krijuar shoqëria, do t'i hedhim një sy niveleve të para të jetës së njeriut.

Nuk ka dyshim se vetia më rrënjësore te njeriu është kënaqësia që ndien për veten. Kjo lloj kënaqësie përbën thelbin kryesor të të gjitha veprimtarive njerëzore në të gjitha nivelet, që nga koha e krijimit të tij e deri me sot.

Duke pasur parasysh se dhuntitë shpirtërore, mendimet, idealet te njerëzit e parë nuk ishin të zhvilluara (këto gjëra duken qartë në fise të ndryshme të paqytetëruar, që jetojnë ende nëpër pyje), veprimtaritë e tyre bazoheshin tek nevojat jetike. Vetia e parë njerëzore ishte afrimi midis dy sekseve të kundërta dhe lindja e dashurisë midis dy partnerëve. Më pas lindja e fëmijëve e zgjeron rrethin shoqëror dhe dashuria për familjen e forcon lidhjen midis pjesëtarëve të kësaj qelize shoqërore.

Nga ana tjetër, njeriu i hershëm e kishte kuptuar se, pa shoqërinë e krijesave të tjera të ngjashme me të, nuk mund t'i zgjidhte dot nevojat e tij jetike. Në këtë kontekst, ai u orientua drejt lidhjes me njerëzit e tjerë, duke hedhur bazat e shoqërisë së parë.

Kriteret dytësore

Në fillimet e veta, njeriu, mbi bazën e kënaqësisë dhe dashurisë që ndiente për veten dhe duke u munduar të plotësonte nevojat e veta jetike, u përfshi në jetën shoqërore që e orientoi atë drejt njerëzve të tjerë, edhe pse nuk ishte në dijeni të përparësive dhe favoreve të tjera që i mundësonte jeta shoqërore.

Në hapat e mëtejshëm të njeriut, lidhjet njerëzore i tejkaluan kufijtë e nevojave jetike, duke u futur në një etapë tjetër shoqërore. Në këtë mënyrë, ndjenjat njerëzore dhe dëshira për njëri-tjetrin, u rritën gradualisht. Nga mundësitë e ndryshme ishin edhe lidhjet mendore dhe kulturore që lindën mes njerëzve. Me zhvillimin e të folurit, të shprehurit dhe shkrimit, mendimet u zhvilluan shumë dhe bashkë me to u zhvillua shkenca dhe dija. Pak nga pak, nën petkun e kulturave të ndryshme, morën formë ideologjia dhe doktrina të ndryshme, që e përfshinë shoqërinë njerëzore në grupe edhe me të mëdha, duke u lidhur ngushtë me njëri-tjetrin. Pra, këto shkaqe dytësore, bënë që shoqëria njerëzore të dalë në nivele më të larta se sa i kërkonin nevojat jetike.

Vlerat e larta

Duke pasur parasysh faktorët e mësipërm, studimi i shoqërive të ndryshme tregon se lidhja e ndërsjellë midis njerëzve nuk varet vetëm prej këtyre faktorëve. Por, ashtu siç dihet, shoqëria e përbashkët e njerëzve në shumë raste ka qenë e mbushur plot me urrejtje dhe ndarje, madje njerëzit janë përballur me njëri-tjetrin duke marrë jetët e njëri-tjetrit. Kjo tregon se faktorët e lartpërmendur, megjithëse janë shumë vendimtarë në krijimin e shoqërisë dhe afërsisë së njerëzve, nuk janë të mjaftueshëm për vazhdimësinë e afërsisë së njerëzve dhe qëndrueshmërinë e shoqërisë midis tyre.

Në kohën kur lidhjet e ndërsjella njerëzore marrin përmasa shpirtërore, atëherë mund të jemi të sigurt për vazhdimësinë e një shoqërie. Pa një përmasë të tillë, një lidhje e rregullt midis njerëzve nuk do të ishte e suksesshme. Pra, në këtë kohë, të gjithë njerëzit e një shoqërie, një nga një, e kuptojnë origjinën dhe ndikimin e besimit në thellësitë e brendësisë se tyre, zgjidhen nga lidhëset vetjake të tyre dhe të gjithë marrin rrugën drejt një terminali të përgjithshëm, duke u zhveshur plotësisht nga egoja personale dhe si përfundim, përftojnë lidhjen e vërtetë të një shoqërie me vlerë.

Në lidhje me këtë, Kur'ani i Madhëruar: *“Sikur të shpenzoje tërë pasurinë që gjendet në Tokë, nuk do t'i bashkoje zemrat e tyre, por All'llahu i bashkoi ato. Vërtet, Ai është i Ploftfuqishëm dhe i Urtë”*. (ajeti 63, sure eL-Enfal)

Myslimanët unik

Duke pasur parasysh se lidhjet njerëzore nuk janë mbi bazën materiale, por me bazë të thellë shpirtërore, bën që të thyhen të gjithë kufijtë gjeografikë dhe historikë, duke i bashkuar të gjithë njerëzit në një zinxhir të vetëm.

Ky është kuptimi i myslimanëve unik. Të gjithë popujt i bashkon nën petkun e vet. Në historinë islame duket qartë kjo gjë, duke pasur në radhët e Abudhar Gaffarin, Selman Farsin, Bilal Habeshin, Sohib Romin, etj.

Nuk duhet ngatërruar feja islame, me kuptimin e internacionalizmit marksist, sepse internacionalizmi marksist u themelua në bazë të interesit ekonomik të përbashkët dhe nuk kishte të bënte fare me lidhjet shpirtërore dhe dashuritë njerëzore që të mund t'i afronte zemrat së bashku.

Përmasa shoqërore e njeriut

Studimi i njeriut ka vërtetuar se një pjesë e mirë e dhuntive natyrore në karakterin e tij shfaqen dhe zhvillohen vetëm në jetën e tij shoqërore. Në qoftë se nuk do të kishim një jetë shoqërore, këto dhunti nuk do të shfaqeshin fare.

Edukata, rregullat dhe mësimet shoqërore zënë një vend të rëndësishëm në fenë islame. Mësimet, në lidhje me përkrahjen e të shtypurve, zemërmadhësinë, këmbënguljen në rrugën e Zotit, ndihma për të vobektit, dashuria mes njëri-tjetrit, sakrifica, etj. janë të gjitha në përmasat shoqërore të njeriut. Në këtë kontekst, arrijmë në rezultatin se njeriu është krijuar në mënyrë të tillë që, vetëm duke pasur jetë shoqërore dhe duke qenë në shoqëri, mund të arrijë qëllimin e përmirësimit. Për këtë arsye, të gjithë faktorët që e drejtojnë atë në mënyrë natyrore drejt shoqërisë nuk janë gjë tjetër veçse një hyrje ose një korridor që të çon në terminalin përfundimtar të zhvillimit shpirtëror në të gjitha përmasat e tij, që në vetvete është përmasa dhe lumturia e tij. Me fjalë të tjera, rruga për në terminalin e fundit të njeriut kalon nga shoqëria dhe kjo përputhet plotësisht me kuptimin e thellë të të qenit shoqëror të njeriut.

Vendosja e ligjeve

Një çështje me shumë rëndësi në shoqëri është vendosja e ligjeve të saj. Fjala ligj, në të vërtetë, ka dy kuptime, që nuk duhen ngatërruar me njëri-tjetrin.

1- Shpesh, ligj thuhet për një teori të përgjithshme, që shpreh lidhjen e drejtpërdrejtë midis dy objekteve. Kjo lidhje, me fjalë të tjera, nuk është kontratë njerëzore, por e vendosur jashtë kuadrit dhe fuqive njerëzore. Si shembull mund të marrim ligjet e fizikës ose të kimisë: siç dihet, trupi, që e ka peshën specifike më të madhe se pesha specifike e ujit, zhytet në ujë, ose nitratet treten në ujë. Duket qartë se këto ligje nuk i vendosim ne, por ne vetëm mund t'i zbulojmë dhe të vërtetojmë që në natyrë një ligj i tillë është i vërtetë.

2- Ligji mund të kuptohet edhe një kontratë njerëzore e planifikuar nga një grup njerëzish dhe e zbatuar prej tyre. Për shembull, ligjet e qarkullimit rrugor mund të konsiderohen si ligje të përbëra, që ndihmojnë transportin rrugor. Këto lloje ligjesh janë funksion i njeriut dhe si të tillë mund të ndryshohen sipas rasteve.

Këtu, në lidhje me ligjet shoqërore, nënkuptojmë shpjegimin e parë në lidhje me ligjin.

Nuk ka dyshim se midis njerëzve të një shoqërie, lidhjet shoqërore konsiderohen si një e vërtetë e jashtme. Kuptohet se njerëzit ndikojnë tek të tjerët dhe ndikohen nga të tjerët, pra, ndikimi është i dyanshëm. Çdo brez trashëgon nga e kaluara mendime, ideale, vlera morale, tradita, zakone, profesione, dashuri të ndryshme, kulturë, etj. Këto i trashëgon nga shekujt e mëparshëm dhe nga pika të ndryshme historike. Këtë fenomen mund ta krahasojmë me një ortek të nisur në kohët e lashta, që është gjithmonë aktiv e sa vjen bëhet më i madh dhe më i fortë, duke përfshirë gjithmonë e më shumë njerëz. Shoqëria dhe njerëzit, në përgjithësi, duke qenë nën ndikimin e këtij orteku gjigant, e pranojnë në mënyrë të vetvetishme, duke e ditur se zgjedhja e tyre për këtë ortek nuk ishte rezultat i dëshirës së tyre të lirë. I gjithë ky ndikim mund të konsiderohet si një ligj fizik, që mund të zbulohet. Pra, këto ligje shoqërore nuk janë gjë tjetër veçse rregulla të krijuara nga Zoti për njerëzit. Kur'ani i Madhëruar, në pjesë të ndryshme të tij, bën fjalë për këto ligje dhe në disa raste i përcakton disa prej tyre, si p.sh:

“Sikur banorët e atyre qyteteve të besonin dhe të ruheshin prej gjynaheve, Ne do t’u dërgonim bekime nga qielli dhe toka, por ata mohuan, prandaj i dënuam për atë që bënë.” (El- A’Raf: 96)

“Njeriu ka përcjellës (engjëj), para tij dhe pas tij, që e mbikëqyrin atë me urdhrin e Allahut. Me të vërtetë, Allahu nuk e ndryshon gjendjen e një populli, derisa ata të ndryshojnë ç’kanë në vetvete. Kur Ai dëshiron ta ndëshkojë një popull, askush nuk mund ta pengojë Atë; dhe ata, përveç Tij, s’kanë asnjë ndihmës.” (Er-Ra’d: 11)

“Zoti yt kurrë nuk do t’i shkatërronte qytetet padrejtësisht, nëse banorët e tyre do të ishin të ndershëm.” (Hud: 117)

Filozofia e historisë

Historia nuk është gjë tjetër veçse ndryshimi i shoqërisë njerëzore në rrjedhën e kohës. Kur pranojmë ligjet e shoqërisë, në një farë mënyre, kemi njohur historinë dhe kemi pranuar ligjet e saj. Fjala histori, të paktën, ka dy kuptime:

1- Kuptimi i parë është i ngjashëm me një bashkësi, ku bëjnë pjesë të gjithë njerëzit dhe ngjarjet që kanë të bëjnë me ta. Pra, me fjalë të tjera është si një fuçi e mbushur plot me njerëz dhe ngjarjet e tyre rrokullisen. Njerëzit nuk mund të ndryshojnë dot rrjedhën e saj dhe rrokullisja e fuçisë mund t’i çojë njerëzit nga të dojë.

Një këndvështrim tjetër, historia mund të përfytyrohet si një krijesë e përbërë nga trupi dhe shpirti. Trupin e saj e përbëjnë njerëzit, kurse shpirti është i pavarur prej tyre dhe ka një rrugë të përcaktuar.

Hegeli thotë: “Historia është vendi i vrasjes së dëshirave të lira njerëzore.” dhe në vende të tjera përmend poshtërsitë, dredhitë dhe pabesitë e saj.

Marks i shpreh se njerëzit, përballë ngjarjeve të historisë, janë vetëm faktorë që ndihmojnë në shtatzëninë e historisë, por nuk janë të zotë të ndikojnë mbi fëmijën e saj.

Engelsi, zotin e historisë e konsideron si zotin më të pashpirt të të gjithë zotave, ku karroca e fitoreve të tij kalon mbi skeletet e njerëzve të vdekur që kundërshtojnë historinë.

2- Historia nuk është gjë tjetër përveçse ngjarjeve njerëzore në shoqëri. Me fjalë të tjera, njerëzit dhe ngjarjet e tyre, kur i mbulon pluhuri i kohës, janë vetë historia dhe jo me kuptimin se ata bëjnë pjesë në histori. Ky shpjegim përputhet me lirinë e njeriut dhe fatin e tij dhe atë të shoqërisë.

Sigurisht që liria njerëzore nuk mund të shpjegohet pa ndihmën e shpirtit dhe karakterit të njeriut. Domethënë, njeriu me dimensionin e tij transmaterial, hedh hapat në botën materiale dhe është pikërisht ky dimension që formon në mënyrë të plotë brumin e personalitetit të tij. Më pas, në bazë të rrethanave të ndryshme dhe të edukimit të tij, merr formën e qëndrueshme. Ky dimension, që formon personalitetin njerëzor, është i tillë, sa që ndikon jo vetëm mbi historinë, por edhe mbi bazën e dëshirës së vet, duke përcaktuar edhe drejtimin e historisë. Dëshira e njeriut vendos që jeta e tij shoqërore të marrë drejtimin që ai do dhe kurrë nuk përputhet me kuptimin se arsye qorre, të papërcaktuara, të drejtojnë rrjedhën e fatit të tij dhe të historisë.

Ligjet e historisë

Disa mendimtarë, si: Hegeli, Marks, ... etj, e shpjegojnë historinë si të pavarur nga dëshirat njerëzore. Ata mendojnë se historia është një krijesë që përpiqet të arrijë një qëllim specifik, duke kaluar në etapa të përcaktuara, ku shoqërive njerëzore nuk u mbetet gjë tjetër veçse të kundërshtojnë veprimtarinë e kësaj krijese. Madje, marksizmi, dogmën e vet për këtë çështje, e shpreh si një temë shkencore ose një dokumentar mbi përvojën, duke e prezantuar larg mendjeve. Po ashtu, edhe doktrinat e tjera të ngjashme me marksizmin, në këtë pikë i ndrydhnin mendimet dhe i afrohen më tepër imagjinare. Pikërisht, këtë çështje ne do ta trajtojmë këtu.

A është e gjithë historia mbi bazën e përvojës?

Ligji shkencor mund të lidhet me një fenomen apo dukuri që ndodh vetëm në rast se kjo dukuri mund të jetë provuar dhe të kemi një përvojë rreth saj. Kur themi të kemi përvojë, nënkuptojmë një përvojë të përgjithshme, ku të gjithë mund të eksperimentojnë, jo vetëm një grup i veçantë. Në jetën e përditshme ndodh që njeriut ose një grupi të caktuar t'i ndodhë një ngjarje që lidhet me vendin, kohën dhe gjendjen e personit, ku ai fiton një përvojë dhe të tjerët, që nuk kanë të bëjnë me këtë ngjarje, nuk kanë të bëjnë as me këtë përvojë. Kjo është një përvojë personale dhe nuk ka të bëjë me të tjerët. Përvoja që trajtohet në shkencë është e një lloji tjetër. Domethënë, duhet që në kushte të barabarta të jetë e provuar për të gjithë. Në bazë të shpjegimit të mësipërm mund të themi se kushti i një fenomeni empirik (i provuar, ose mbi bazë të përvojës) është përsëritja e tij dhe në rast se nuk do të kemi përsëritje, shkencën nuk mund të vendosë dot ligj mbi këtë fenomen.

Edhe historinë mund ta gjykojmë në dy pikëpamje, nga elementët përbërës, si dhe nga tërësia e saj. Përsa i përket elementeve përbërës të historisë mund të merren në analizë dhe të studiohen, si ata, ashtu edhe raste të ngjashme me to, duke nxjerrë konkluzione për ekzistencën dhe formimin e tyre, si dhe të funksioneve varëse të ndryshme. Në bazë të këtyre rezultateve njeriu është në gjendje, madje edhe të parashikojë situata të ngjashme në të ardhmen. Këtë lloj arsytimi e quajmë shkencën e historisë.

Ndërsa përsa i përket tërësisë së historisë mund të themi se ajo është unike dhe ka përshkuar vetëm një rrugë të vetme, e shoqëruar nga ngjarje të veçanta dhe të papërsëritshme. Kështu që kurrë nuk mund të bëhen parashikime dhe të merren konkluzione ose të veprohet në mënyrë të ngjashme dhe të jemi të suksesshëm, ose të mund të gjejmë rrugë të favorshme mbi bazën e tërësisë së historisë.

Në këtë kontekst, duke pasur parasysh se tërësia e historisë është e vetme dhe e papërsëritshme, mund të themi se nuk mund të vihet ndonjë ligj apo të përftohet ndonjë përvojë deri në pafundësi. Edhe ata që mendojnë dhe pretendojnë për ndonjë ligj apo përvojë që mbretëron mbi tërësinë e historisë, duke bazuar fjalimet e tyre në shkencë dhe përvojë, historinë e tyre, dijen e tyre, pozicionin e tyre, nuk e njohin si pjesë përbërëse të historisë.

1- A mundemi të parashikojmë të ardhmen e historisë?

Duhet pasur parasysh se parashikimi shkencor, për arsye se njeriu nuk ka dijeni të plotë për gjithë faktorët që ndikojnë në një ngjarje, kurrë nuk është i prerë dhe i pakundërshtueshëm. Mundet që faktorë të paparashikueshëm të ndikojnë mbi një ngjarje, duke e ndryshuar plotësisht rrjedhën e saj. Kjo mungesë sigurie në problemet shoqërore trajtohet me seriozitet të madh, sepse aktori kryesor i skenave shoqërore, është një krijesë, e cila, në sajë të dëshirave dhe zgjedhjes së lirë, veprimet, sjelljet dhe reagimet, duke u mbështetur edhe në ligjet shkencore, nuk mund t'i parashikojë dot në mënyrë të saktë, madje as me përafërsi.

Ndërsa përsa i përket parashikimit të historisë, problemi është edhe më i ndërlikuar, sepse jo vetëm që roli i njeriut dhe ndikimi i zgjedhjes së tij të lirë i prish të gjitha përlllogaritjet shkencore, por edhe çështja e historisë, si kundër atyre shoqërore, nuk është nën kontrollin e kërkuesve dhe dijetarëve. Në këtë kontekst, saktësia e parashikimit të historisë, në lidhje me parashikimet e tjera shkencore (të gjitha parashikimet janë të kushtëzuara), është më e pakët dhe aq më tepër në lidhje me tërësinë e historisë (rrugën dhe fundin e saj), siç e theksuam edhe më lart, mbi bazë shkencore nuk mund të jepet asnjë gjykim.

Bëjnë përjashtim rastet kur kemi të bëjmë me dhënie fjale, të qenit në dijeni të prerë me të ardhmen, parashikimi i profetëve, ose heqja e kushteve, që s'kanë të bëjnë fare me shkencën, por janë punë të gënjeshtarëve ose të profetëve të vërtetë dhe janë jashtë kuadrit shkencor. Parashikimi i historisë, që mund të sjellë fitoren përfundimtare të këtij grupi ose kësaj klase njerëzish, përveç vetisë reklamuese dhe tërheqëse të fjalimit, nuk ka asnjë vlerë shkencore.

Doktrina e fesë

Në fenë islame dhe në veçanti në Kur'anin e Madhëruar, historisë i është dhënë një rëndësi e madhe. Duhet theksuar se Islami nuk është doktrinë e njohjes së shoqërisë, as e filozofisë së historisë, po ashtu dhe Kur'ani Famëllartë nuk është libër shkencor, as filozofik dhe as historik, por është libër drejtimi për njerëzit, e në të njëjtën kohë mund të nxirren një numër i madh shkencash që janë përmendur në Të.

Kur'ani dhe tërësia historike

Pikëpamja e Kur'anit Famëllartë, në lidhje me parashikimin e së ardhmes së historisë së njerëzimit, është plotësisht e qartë. Sipas Kur'anit, në tokë do të mbretërojë rregulli dhe qetësia, paqja dhe mirëqenia, drejtësia dhe mirësia. Me vendosjen e një sistemi qeverisjeje të tillë, njerëzimin do ta mbulojë një lumturi dhe gëzim i papërshkrueshëm, ku premtimet e të gjithë engjëjve dhe ambasadorëve qiellorë në tokë do të veshin rrobat e veprimit. Madje, në pjesën e dytë të kësaj qeverie botërore, të gjitha dimensionet shpirtërore të njeriut do të zhvillohen plotësisht. Megjithëse na duhen vite dhe shekuj të gjatë për të arritur deri atje, duhet theksuar se e gjithë historia njerëzore, që nga gjeneza dhe deri te arritja e një qeverie qiellore për të gjithë botën, është vetëm një hyrje e vogël përballë pjesës tjetër që mbetet pas kësaj qeverie.

“Allahu u ka premtuar atyre prej jush, që besojnë dhe që bëjnë vepra të mira, se do t'i bëjë mëkëmbës në Tokë, ashtu si i ka bërë ata para tyre dhe që do t'ua forcojë fenë e tyre, me të cilën Ai është i kënaqur dhe që frikën do t'ua shndërrojë në siguri. Le të më adhurojnë Mua e të mos Më shoqërojnë asgjë (në adhurim). Sa për ata që, pas kësaj, mohojnë (besimin), pikërisht ata janë të mbrapshtët.” (En-Nur: 55)

Gjithashtu, edhe në ajete të tjera, si dhe në ajetin e mëposhtëm, Zoti thotë:

“Ne shënuam në Zebur, pas Teuratit, që tokën (e Xhenetit) do ta trashëgojnë robërit e Mi të mirë.” (En-Enbia: 105)

Nuk ka asnjë dyshim se këto ajete nuk janë fjalime shkencore, që janë nxjerrë mbi bazën e përvojës ose mbi bazën e parashikimit shkencor, sepse, siç e theksuam edhe në fillim të kapitullit, të gjitha parashikimet shkencore janë të kushtëzuara dhe jo të prera. Në Kur'an kemi të bëjmë me një parashikim të prerë dhe të padiskutueshëm, të bazuar mbi dije dhe njohje qiellore dhe profetike dhe jo mbi bazën e ndonjë studimi shkencor mbi historinë.

Kur'ani dhe elementë përbërës të historisë

Shumë ajete kur'anore tregojnë momente të ndryshme të historisë. Kur'ani, mbi bazën e ligjeve qiellore, ka ndjekur hap pas hapi pjesë të ndryshme të historisë, ngjarje të të parëve tanë dhe ndryshimet që kanë pësuar ata. Në disa ajete bëhet fjalë për gjendjen dhe fatin e popujve, që, për arsye të ngjashmërisë së pozicionit që kanë pasur, kanë përfunduar në një fat të përbashkët.

“Eh, sa e sa fshatra e qytete i kemi zhdukur Ne, sepse banorët e tyre bënë jetë të shfrenuar! Ja tek janë shtëpitë e tyre, të cilat janë banuar pas tyre fare pak ose aspak. Jemi Ne trashëgimtarët e fundit.” (El-Kasas: 58)

Në shumë ajete të tjera, paralajmërohet për kushtet e nevojshme dhe të mjaftueshme, për ngritjen dhe rënien e popujve dhe shoqërive, duke marrë si shembull të kaluarën. Për këtë arsye, Kur'ani e konsideron historinë mësim dhe jep udhëzime mbi bazën e saj.

“Para jush kanë kaluar shumë shembuj (popujsh nga ndjekësit e profetëve që iu ndodhi ajo që po ju ndodh edhe ju). Prandaj udhëtoni nëpër botë dhe shihni si ishte fundi i atyre që i përgënjeshtroan profetët.” (Al- Imran: 137)

Duke u bazuar në studimin e së kaluarës, Islami, historinë e prezanton si burim dijesh dhe njohjesh. Duhet mësuar dhe marrë shembull nga e kaluara, në mënyrë që të zgjedhim një rrugë të drejtë në të ardhmen.

Ligjet familjare në islam

Një nga veçoritë e karakterit të njeriut është krijimi i familjes. Jeta familjare e njeriut është plotësisht natyrore dhe jo e paracaktuar, domethënë, e vendosur, që në krijimin e tij, të ketë familje dhe fëmijë. Ngjarjet historike na tregojnë se njeriu, në të gjitha periudhat kohore, ka pasur jetë familjare, ku burri dhe gruaja asnjëherë nuk kanë jetuar veç e veç. Madje edhe në periudhën e njerëzve të egër, që njihet si periudha më e largët, po kështu ishte.

Roli i pazëvendësueshëm i familjes

Familja ka peshë të rëndësishme dhe vitale në jetën e njeriut. Në të kaluarën ju jeni njohur dhe i keni ndeshur këto rezultate, që në këtë pjesë ne nuk do t'i përmendim, vetëm se do të mjaftohemi me analizën e disa pikave të rëndësishme në këtë fushë.

1- Lumturia dhe mirëqenia e një shoqërie varet nga ligje të sakta dhe të ngrohta familjare. Thyerja e ligjeve familjare do të shoqërohet me çrregullime të mëdha në jetën shoqërore. Me fjalë të tjera, lumturia e çdo shoqërie farkëtohet në familjet përbërëse, ku shoqëri të sakta kanë nevojë për familje të sakta.

2- Njeriu, që në fëmijëri, duhet të njihet me rrugën e drejtë të jetës, ku vlerat njerëzore të rriten dhe të zhvillohen në mënyrë natyrore. Transmetimi i vlerave njerëzore dhe kulturore në çdo shoqëri i përket në radhë të parë familjes. Në shoqëritë e përbëra, nga familje të paqëndrueshme ose që nuk janë në gjendje të kryejnë detyrat përkatëse, lidhjet kulturore, shoqërore, njerëzore etj, midis brezit të ri dhe brezit të vjetër dëmtohen jashtë mase, madje edhe shpëputen nga njëri-tjetri, ku si rezultat, brezi i ri mbetet pa bazat themelore të vlerave shoqërore. Ky lloj brezi nuk mund ta zotërojë dhe ta transmetojë identitetin kulturor të tij dhe në luhatjet e ndryshme shoqërore, kulturore etj, rrezikon të humbasë vlerat e veta deri në zhdukjen e plotë.

3- Familja, në vetvete, është një ligj për të rritur dhe zhvilluar brezin e ri. Në bazë të këtij ligji, brezi i ri, nën rrezatimin e dashurisë familjare, duhet të zhvillojë ndjenjat dhe vlerat e tij të larta dhe të njihet me dashurinë njerëzore, duke hedhur në këtë mënyrë farat e mirësisë në karakterin e tij. Duhet theksuar se ndjenja e dashurisë tek njeriu është një nga investimet më të mëdha jo vetëm për jetën e tij, por edhe për jetën shoqërore. Në qoftë se njeriu, që në fillimet e tij, familjarizohet me të tilla ndjenja, edhe më vonë do të jetë gjithmonë në kërkim të këtyre ndjenjave dhe asnjëherë nuk do t'i nënvleftësojë ato. Ai shumë shpejt do të njohë sakrificën, e shikon lumturinë e tij tek lumturinë e të tjerëve, e krahason shoqërinë me ambientin e tij familjar. Me fjalë të tjera, ai njihet plotësisht me vlerat njerëzore, duke përfutur kështu dashurinë njerëzore, si dhe shumë investime të tjera në botën e tij shpirtërore, duke rritur dhe zhvilluar gjerësisht të gjitha ndjenjat e fshehura shpirtërore.

Njohja e detyruar e detyrave familjare

Ai që ka vendosur të krijojë familje, për të arritur këtë qëllim, duhet të ketë parasysh se organizmi i familjes, ashtu si dhe shumë organizma të tjera shoqërore, ka një bosht drejtimi, ose me fjalë të tjera, është e përbërë nga principe themelore. Vetëm në bazë të njohjes së këtij boshti dhe kryerjen me korrektësi të detyrimeve që rrjedhin nga principet mund të arrihet në qëllimin e duhur. Mosnjohja e këtij boshti bëhet shkak i dëmtimeve të pa kompensueshme në strukturën e familjes, madje gruaja dhe burri, së bashku me fëmijët e tyre, mund të mos arrijnë lumturinë e kërkuar. Arsyeja, që disa familje janë në gjendje kritike dhe të mbuluara me keqkuptime është se çifti i ri, përpara se të hedhë hapin për krijimin e familjes, nuk ka pasur njohjen e duhur dhe ka qenë fare i papërgatitur në lidhje me të drejtat dhe detyrat familjare, duke e konsideruar si një hap të parëndësishëm në jetë, por më vonë, me kalimin e një kohe relativisht të shkurtër, e kuptojnë se në çfarë përmasash ka qenë gabimi i tyre.

Ajo që e bën me tepër të detyrueshëm njohjen e sistemit familjar dhe i rrit rëndësinë kësaj njohjeje është fakti se ekzistojnë një numër i madh rrugësh dhe mënyrash të gabuara në këtë mes. Fatkeqësisht, që në fillimet e krijimit të familjes, lloje të ndryshme traditash dhe zakonesh ose këndvështrime të gabuara, të bazuara në injorancë, mendjemadhësi, mosnjohje të principeve themelore etj, lëshojnë rrënjë, duke u bërë pengesë e pakapërcyeshme për çiftin e ri, në rrugën e tij drejt lumturisë. Madje, disa nga këto doke dhe zakone të gabuara bëhen shkak që shumë vajza dhe djem të mos krijojnë familje. Ata që ndikohen me tepër nga bota materiale, pa u menduar për të tjerët, jo vetëm që ndjekin këto rrugë të gabuara, por pak nga pak u shtojnë diçka amplitudës së këtyre zakoneve. Tek disa të tjerë, këto dëmtime dhe humbje të rënda në jetën e tyre familjare vijnë si rezultat i këndvështrimeve të gabuara që bashkëshorti dhe bashkëshortja kanë në lidhje me njëri-tjetrin dhe me pozicionin e tyre në familje.

Në këtë kontekst, do të përpiqemi që lexuesi të njihet më tepër me disa nga ligjet themelore në këtë fushë dhe të kuptojë rëndësinë e problemit në fjalë, në mënyrë që me njohuri të mjaftueshme dhe të sakta, në këtë shkallë të jetës, sa e rëndësishme, po aq dhe serioze, të hedhë hapin e duhur.

Natyra dhe pozicioni i familjes në islam

Po të hedhim një sy mbi mësimet islame, do të kuptojmë se problemi i martesës, së bashku me etapat dhe të vërtetat që lidhen me të, zë një vend të rëndësishëm në Islam. Në kundërshtim të plotë me disa nga doktrinat e tjera, që sugjerojnë beqarllëkun si zgjidhje të problemeve njerëzore, Islami, martesën e konsideron të shenjtë dhe e ndalon filozofinë e të qenit beqar. Profeti Muhammed (paqja dhe bekimi i All-llahut qoftë mbi të), ka thënë: *“Asnjë strukturë në Islam nuk është ndërtuar dot në mënyrë që pranë Zotit të jetë me e dashur se martesa.”*

Në fjalime të tjera thuhet: *“Martesa është nga rregullat e mia dhe çdokush që do ta shkelë atë, nuk është nga të mitë.”*

Nga ana tjetër, Islami, detyrat dhe të drejtat e gruas, burrit, dhe fëmijëve në jetën familjare i ka shprehur në mënyrë të përmbledhur dhe të renditura mirë, që njihen si **sistemi i të drejtave familjare në Islam**. Ky sistem është krijuar mbi një bazë të veçantë, ku për një shpjegim më të thellë rreth tij duhet një studim i mirëfilltë.

Pikëpamja islame në lidhje me të drejtat në familje

Islami, në lidhje me të drejtat familjare të burrit dhe gruas, ndjek një filozofi të veçantë, e cila, sigurisht, në lidhje me jetën e sotme, ndryshon me atë të jetës së katërmëdhjetë shekujve më parë.

Islami nuk ka përcaktuar të drejta dhe detyra të njëjta midis burrit dhe gruas. Por në të njëjtën kohë, nga pikëpamja e të drejtave njerëzore, burrin dhe gruan i njeh të barabartë. Pra, Islami pranon barazinë midis burrit dhe gruas në tërësi dhe mohon të drejta dhe detyra të barabarta për secilin.

Për ta kuptuar më mirë këtë pikë duhet pasur parasysh se barazia në këtë rast është me kuptimin e barazisë jo identike. Le të marrim një shembull: Babai i disa fëmijëve zotëron një pasuri, të përbërë nga toka bujqësore, zyra tregtie, kompani ndërtimi, si dhe biznese humanitare. Këtë pasuri ai e ndan në mënyrë të barabartë midis fëmijëve të tij, mbi bazën e njohjes që ai ka për aftësitë e ndryshme të fëmijëve të tij. Fëmijës së parë i jep tokën bujqësore, duke qenë i bindur në dhuntitë që ky fëmijë ka për bujqësinë, krahasuar me fëmijët e tjerë; fëmijës së dytë i jep zyrat e tregtisë, pasi edhe për këtë ka bindje të plotë dhe kështu me radhë e ndan pasurinë e tij, duke marrë në konsideratë karakterin dhe fushat ku fëmijët e tij kanë talent. Kështu që babai e ndau pasurinë e tij në mënyrë të barabartë midis fëmijëve, por jo në mënyrë identike. Pra, ai ruajti barazinë midis fëmijëve, duke preferuar një ndarje më të vlefshme mbi bazën e prirjeve të fëmijëve të tij. Kjo lloj barazie mund të krahasohet me sasinë me cilësi të ndryshme. Po kështu, edhe Islami, barazinë totale midis burrit dhe gruas e ka ruajtur dhe nuk i jep asnjërit prej tyre prioritet mbi tjetrin, duke mos pranuar barazinë identike në të drejta dhe detyra midis tyre.

Këtu lind pyetja: Përse Islami nuk i ka përcaktuar të drejtat dhe detyrat e burrit dhe të gruas në të gjitha rastet e mundshme? Si do të ishte më mirë, që të drejtat dhe detyrat e burrit, në lidhje me gruan të ishin të barabarta identike apo të ishin të barabarta dhe jo identike?

Për t'i dhënë përgjigje këtyre pyetjeve duhet të trajtojmë tri çështje:

- 1 - Mendimin islam, në lidhje me pozicionin njerëzor të gruas;
- 2 - Për çfarë qëllimesh janë ndryshimet fizike që ekzistojnë në krijimin e burrit dhe të gruas? A mundet që këto ndryshime të përcaktojnë edhe barazinë jo identike në të drejta dhe detyra midis burrit dhe gruas?
- 3- Mbi ç'filozofi bazohen ndryshimet në të drejta dhe detyrat, që ekzistojnë midis burrit dhe gruas në islam? A është ende në fuqi kjo filozofi?

Gruaja nga pikëpamja islame

Siç e dimë, Kur'ani i shenjtë, me shpjegimin e krijimit të gjithësisë, na jep një këndvështrim dhe një ide të përgjithshme, ku, mbi bazën e këtij këndvështrimi, renditën të gjitha rregullat dhe ligjet e tij. Një nga çështjet, që nuk është heshtur dhe është shpjeguar në Kur'an, është krijimi i mashkullit dhe i femrës.

Kur'ani i shenjtë, në kundërshtim me disa nga doktrina, gruan dhe burrin i njeh të ndërtuar nga e njëjta substancë. Në lidhje me këtë pikë, Kur'ani i Madhëruar, me qartësi të plotë, në një numër të shumtë ajetesh, thekson se femrën dhe mashkullin i krijoi nga e njëjta substancë. ***“O njerëz! Frikësojuni Zotit tuaj, i Cili ju krijoi prej një njeriu, ndërsa prej atij krijoi bashkëshorten e tij, kurse prej këtyre të dyve krijoi shumë meshkuj e femra. Dhe frikësojuni Allahut, me emrin e të Cilit ju kërkoni të drejtat e ndërsjella dhe ruani lidhjet farefisnore. Se vërtet, Allahu është përherë Mbikëqyrës mbi ju.”*** (En- Nisa': 1) Po ashtu diku tjetër thotë: ***“Ai ju formon në mitër, ashtu siç dëshiron Vetë; s'ka zot tjetër që meriton të adhurohet, përveç Tij, të Plotfuqishmit, të Urtit!”***(Al-Imran: 6)

b- Sipas filozofisë së doktrinave fetare, gruaja prezantohet si objekt mëkati dhe si burim i të gjitha të këqijave. Thuhet se, shejtani nëpërmjet gruas, arrin të gënjejë burrin, pasi drejtpërdrejtë nuk mund ta mashtrojë dot. Shejtani në fillim mashtrroi Havanë dhe më pas Havaja mashtrroi Adamin.

Kur'ani e ka trajtuar historinë e Adamit dhe kurrë nuk ka thënë se shejtani mashtrio Havanë dhe më pas Havaja mashtrio Adamin. Kur'ani i Madhëruar as Havanë nuk e njih si shkaktare dhe as nuk e përjashton atë nga problemi. Kur'ani, duke venë në dukje se baza e se keqes është shejtani, përdor termin e dualitetit. *“Shejtani ata të dy i mashtrio.”* Ose në një vend tjetër thuhet: *“Shejtani ata të dy i orientoi për nga mëkati.”* Gjithashtu thuhet: *“Shejtani u betua përballë të dyve se përveçse të mirën e të dyve nuk kërkonte gjë tjetër.”* Në këtë kontekst, Kur'ani, lidhur me mendimin e gabuar të asaj kohe, që fatkeqësisht është i pranishëm edhe në ditët tona, po lufton fuqishëm, dhe gruan, nga akuzimi si objekt mëkati dhe burim i të gjitha të këqijave, e shndërroi në idhull të pafajësisë.

c- Një mendim tjetër jo i drejtë, i mbetur nga e kaluara, në lidhje me gruan dhe dhuntinë e saj shpirtërore është se disa besojnë se gratë nuk mund të arrijnë dot nivele të larta shpirtërore ashtu si burrat. Domethënë, ato nuk mund t'i afrohen Zotit. Kur'ani Famëllartë, në lidhje me këtë pikë, ka qartësuar se shpërblimi i së ardhmes dhe afërsia me Zotin nuk ka të bëjë me gjininë e njeriut, por me besimin dhe veprimet e njeriut. *“Cilindo mashkull apo femër që kryen vepra të mira, duke qenë besimtar, Ne do ta bëjmë që të kalojë jetë të bukur dhe do ta shpërblejmë sipas veprave më të mira, që ka bërë.”* (En-Nahl: 97)

Kur'ani, përballë çdo njeriu të madh dhe të shenjtë, gjithmonë përmend një grua në po të njëjtën lartësi. Në lidhje me bashkëshortet e hazretit Adem dhe Ibrahim, si dhe nënat e hazretit Musa dhe Isa (paqja dhe bekimi i All-llahut qoftë mbi ta), ka shprehur një respekt të merituar. Nga ana tjetër, tregon edhe për bashkëshortet e hazretit Nuh dhe Lut, të cilat nuk kanë qenë të denja për burrat e tyre. Gjithashtu, përmendet se bashkëshortja e Farunit ishte një grua e lartë. Kur'ani ka mundur të ruajë ekuilibrin, në historitë e tij të mos përmendë vetëm burrat.

Po ashtu, edhe nga pikëpamja shpirtërore ishte aq e zhvilluar, saqë profeti i kohës (hazreti Zakaria (paqja dhe bekimi i All-llahut qoftë mbi të), u zhyt në konfuzion dhe u la pas prej saj. Në historinë islame gra të tilla, me pozicion kaq të lartë, ka shumë. Të paktë janë njerëzit që mund të jenë në nivelin e Hadixhes dhe, asnjë burrë, përveç profetit Muhammed (paqja dhe bekimi i All-llahut qoftë mbi të), dhe imam Aliut (paqja dhe bekimi i All-llahut qoftë mbi të), nuk mund të ngjiten në nivelin e hazretes Zahro (paqja dhe bekimi i All-llahut qoftë mbi të).

Ajo, në lidhje me fëmijët e saj, që janë imamë dhe në lidhje me profetët e tjerë, përveç profetit të Islamit, është në pozicion më të lartë.

ç- Një mendim tjetër i prapambetur nga e kaluara është se gjoja gruaja është shtojcë e burrit dhe është krijuar pikërisht për të. Me fjalë të tjera, është shkaku i krijimit të tij. Kur'ani i Madhëruar asnjëherë nuk ka thënë që gruaja është krijuar për burrin, por thekson me forcë se gruaja dhe burri janë krijuar për njëri-tjetrin. *“Ato janë petk për ju e ju jeni petk për ato...”* (El-Bekare: 187), i ngjashëm me këtë është *“Dhe një prej shenjave të Tij është që prej jush krijoi për ju bashkëshortet tuaja, që të qetësoheni pranë tyre, duke vënë ndërmjet jush dashuri dhe mëshirë. Me të vërtetë, në këtë ka shenja, për njerëzit që mendojnë.”*(Er- Rum: 21)

d- Një mendim i gabuar, në lidhje me gruan, është se ajo konsiderohej si një pikë negative për jetën e burrit dhe mendonin se ajo ishte burim i të gjitha të këqijave dhe halleve të burrit. Kur'ani, në lidhje me këtë, ka thënë se gruaja për burrin është burim qetësie, rehati e zemrës dhe shpirtit të tij. Tërheq vëmendjen se gruaja është një pikë pozitive për burrin.

Islami, të gjitha këto mendime dhe tradita të trashëguara nga e kaluara dhe mbi asnjë bazë logjike dhe shoqërore, i hedh poshtë kategorikisht, sepse janë mendime të

bazuara në injorancë dhe mendjeshkurtësi. Islami lartëson pozicionin njerëzor të gruas dhe e vendos në barazi me atë burrit.

Ndryshimet midis burrit dhe gruas

Siç shpjeguam më lart, nga pikëpamja e pozicionit dhe nivelit shpirtëror midis burrit dhe gruas nuk ka asnjë ndryshim. A është burri i barabartë me gruan nga pikëpamja fizike dhe psikologjike?

Rezultatet e nxjerra, mbi bazën e kërkimeve psikologjike dhe studimeve shkencore, tregojnë qartë se ekzistojnë ndryshime trupore dhe psikologjike midis tyre, pasi janë të sekseve të ndryshme. Ky mosbarazim trupor dhe psikologjik nuk nënkupton se njëri është më perfekt se tjetri, por plotësojnë njëri-tjetrin, në mënyrë që të mund të jetojnë bashkë. Ligji i krijimit donte që, me këto ndryshime, të perfeksiononte jetën e tyre të përbashkët.

Përveç ndryshimeve trupore që ekzistojnë midis burrit dhe gruas, psikologët theksojnë se ekzistojnë edhe ndryshime thelbësore në mënyrën e të menduarit dhe të këndvështrimit që kanë për botën. E thënë ndryshe, secili, nga të dy palët, është një botë më vete. Pikërisht, për këtë arsye ndodh shpesh që burri dhe gruaja të mos jenë në një mendje ose të mos veprojnë njëllor në raste të njëjta. Pra, botëkuptimi i tyre në përgjithësi është i ndryshëm. Në pjesët e mëposhtme do të analizojmë disa prej ndryshimeve midis burrit dhe gruas.

Kryevepra e krijimit

Në të vërtetë, ndryshimet midis burrit dhe gruas janë kryeveprat më të çuditshme të krijimit. Këto ndryshime flasin hapur për një sistem të saktë dhe të mirëllogaritur krijimi. Pra, me fjalë të tjera, ndryshimet midis burrit dhe gruas janë shenja të një krijimi të qëllimtë dhe aspak të rastësishëm.

Sistemi i krijimit, për të arritur qëllimin e tij që çdo krijesë të mbijetojë, ka vendosur sistemin e riprodhimit të brezave, ku për këtë qëllim ka krijuar dy gjinitë, femër dhe mashkull, ku bashkëpunimi dhe mirëkuptimi midis tyre mund të sjellë një qëllim të tillë. Në rastin e njerëzve, unifikimi dhe bashkimi i tyre është planifikuar në mënyrë të tillë që të ekzistojë: nevoja, shërbimi, sakrifica, dashuria etj, për njëri-tjetrin. Mbi bazën e këtij projekti janë planifikuar me saktësi edhe ndryshimet fizike dhe psikologjike midis femrës dhe mashkullit. Pra, me fjalë të tjera, janë pikërisht këto ndryshime që i tërheqin ata drejt njëri-tjetrit. Në qoftë se femra do të kishte po ato cilësi trupore dhe psikologjike si të mashkullit, bashkimi dhe tërheqja midis tyre do të ishte e pamundur dhe anasjelltas.

Lidhja është më e lartë se pasioni

Ligji i krijimit gruan dhe burrin i ka ndërtuar mbi bazën e dëshirës dhe dashurisë për njëri-tjetrin. Kjo dashuri dhe dëshirë nuk është si llojet e tjera të dëshirave për sende dhe gjëra të ndryshme. Ekziston një ndryshim thelbësor midis kësaj dashurie dhe dashurive të tjera. Njeriu e do një send për qetësinë dhe rehatinë e tij, duke plotësuar kërkesat e tij personale, ndërsa dëshira për bashkëshort/e është me kuptimin që të dy palët kanë nevojë për njëri-tjetrin dhe jo me kuptim të njëanshëm. Pra, dëshira ka kah të dyfishtë, gjë që nuk ndodh me sendet dhe mjetet e tjera materiale që njeriu dëshiron t'i ketë. Në këtë kontekst marrin kuptim edhe sakrifica për njëri-tjetrin, si një kënaqësi dhe jo si një mundim si dhe veprime të tjera të ngjashme me këtë që njeriu nuk do t'i bënte për sendet dhe krijesa të tjera në përgjithësi. Disa janë të mendimit se vetëm pasioni për gjininë e kundërt është shkak i lidhjes midis femrës dhe mashkullit, kur në të njëjtën kohë vetë lidhja është shumë më tepër se sa pasioni për seksin e kundërt.

Është pikërisht kjo lidhje që kurorëzohet me bashkimin e çiftit. Kur'ani i Madhëruar shprehet: *“Dhe një prej shenjave të Tij është që prej jush krijoi për ju bashkëshortet tuaja, që të qetësoheni pranë tyre, duke vënë ndërmjet jush dashuri dhe mëshirë. Me të vërtetë, në këtë ka shenja, për njerëzit që mendojnë.”* (Er- Rum: 21)

Bazat e të drejtave familjare

I vetmi libër reference kompetent, për të njohur të drejtat e vërteta të njeriut, është libri i krijimit. Po të shfletoni faqet e këtij libri të madh, mund të kuptoni të drejtat e përbashkëta të njerëzimit, si dhe të drejtat e burrit dhe të gruas në veçanti.

Çdo lloj dhuntie dhe talenti natyror është bazë për një të drejtë të vërtetë dhe qëndron si një dokument natyror për të. Për shembull, fëmija i njeriut ka të drejtë të arsimohet dhe të kërkojë dije, ndërsa “fëmija” i një kafshe nuk e ka këtë të drejtë, sepse fëmija i njeriut e ka talent për të mësuar, ndërsa ai i kafshës nuk e ka këtë talent. I njëjti arsytim është edhe me të drejtën e mendimit, me të drejtën e votës, me të drejtën e të qenit i lirë etj.

Sistemi i krijimit, çdo krijesë e ka pajisur me dhunti dhe talente të veçanta, duke e vendosur atë në një cikël të saktë jetese, në mënyrë që të përshkojë një qark të caktuar gjatë jetës së saj. Po ashtu, edhe perfeksionimi dhe lumturia e saj mbi këtë cikël jetese do të llogaritet. Sistemi i krijimit këto dokumente natyrore nuk ua ka dhënë në dorë krijesave të saj në mënyrë të rastësishme apo nga padija për këto krijesa, por u janë dorëzuar në dorë krijesave me një qëllim të përcaktuar mirë.

Në këtë kontekst, rrënja e të drejtave familjare duhet kërkuar te dhuntitë natyrore të burrit dhe të gruas. Duke studiuar talentet që ekzistojnë tek burri dhe tek gruaja, mund të gjykojmë se a ka në të vërtetë burri të drejta dhe detyra të barabarta me gruan apo jo.

Mendimi se barazia identike e të drejtave familjare midis burrit dhe gruas, që disa gabimisht e kanë quajtur me termin e të drejtave të barabarta, bazohet mbi supozimin se burri dhe gruaja kanë dhunti dhe nevoja të njëjta. Mbi bazën e kësaj logjike, secilit i takon pjesë e barabartë e të drejtave dhe detyrave familjare.

Një mendim tjetër është se të qenit bashkëshort/e do të thotë të drejta dhe detyra të veçanta, dhe kështu me radhë, të qenit baba apo nënë ose të qenit fëmijë u korrespondojnë të drejta dhe detyra të veçanta për secilin rast. Gjithsesi, në bashkësinë familjare këto të drejta dhe detyra bëhen shkas që aktiviteti, veprimtaria, si dhe bashkëpunimi midis këtyre pjesëtarëve të jetë i ndryshëm. Mendimi se gruaja dhe burri nuk kanë të drejta dhe detyra identike të barabarta, por në total ruhet barazia, pikërisht bazohet në arsyetimin e mësipërm dhe gjithashtu mbrohet edhe nga Islami. Arsyeja e një logjike të tillë është diferenca fizike dhe psikologjike që ekziston mbi burrin dhe gruan, ku si rrjedhojë kemi diferenca në nevojat, detyrat dhe të drejtat e secilit. Vetëm në këtë kontekst jemi në gjendje të kuptojmë sekretet e ndryshimeve dhe diferencës midis burrit dhe gruas në kuadrin islam dhe veçanërisht në të drejtat familjare midis tyre.

Kushtet dhe kriteret e zgjedhjes së bashkëshortit

Hapi i parë dhe më i rëndësishëm në suksesin e një familjeje është kujdesi dhe vëmendja e duhur në çastin e zgjedhjes së bashkëshortit. Përvoja ka treguar se rrënja e shumë ndarjeve dhe përçarjeve të familjeve të reja ka qenë pakujdesia në këtë çast të jetës. Disa, me shumë lehtësi dhe pa vëmendjen e duhur në rezultatin që mund të marrin, vendosin të krijojnë familje duke zgjedhur bashkëshortin e tyre pa ndonjë kokëçarje. Pas një kohe relativisht të shkurtër, ata kuptojnë se zgjedhja nuk ishte e duhur dhe nuk përshtateshin me njëri-tjetrin. Pra, në shkallë të parë duket qartë se

suksesi i një familjeje varet ngushtë nga zgjedhja me vetëdije dhe dijëni të plotë të bashkëshortit, ku kjo zgjedhje të bazohet mbi bazën e kriterëve të duhura. Më poshtë do të trajtojmë disa nga kriteret dhe kushtet më kryesore të zgjedhjes së bashkëshortit.

Besimi

Faktori më i rëndësishëm për zgjedhjen e bashkëshortit është besimi. Rëndësia e besimit shqyrtohet në disa drejtime:

1- Njeriu me besim, për arsye të lidhjeve shpirtërore që ka me Zotin, konsiderohet si njeri i besueshëm. Sa më i madh të jetë besimi i tij, aq më shumë mund të kemi besim tek fjala dhe premtimi i tij për martesë. Njerëzit që nuk besojnë, duke mos pasur një lidhje të tillë me Zotin, nuk mund t'u zihet besë për çdo lloj premtimi. Pra, me fjalë të tjera, besimi ynë te një njeri që nuk e ka besimin si forcë kontrolli në vetvete, nuk do të ishte në interesin tonë.

2- Njerëzit me besim, për shkak të ndjekjes me saktësi të rregullave të fesë së tyre, janë funksion i vlerave dhe virtyteve të unifikuara. Në këtë mënyrë kanë pikëpamje, qëllime, mendime, dëshira dhe nivel shpirtëror të ngjashëm me njëri-tjetrin. Në këtë kontekst, ata në jetën e tyre familjare kanë shumë përafërsi me njëri-tjetrin. Madje mund të themi se, në qoftë se burri dhe gruaja nuk kanë njohje të mëparshme, por janë rritur që të dy në një mjedis me besim, duke krijuar edhe ata të njëjtin besim, padyshim që kanë shumë pika të përbashkëta midis tyre dhe në qoftë se lind ndonjë mosmarrëveshje apo keqkuptim midis tyre, ata mund ta zgjedhin mbi bazën e rregullave dhe ligjeve të të njëjtit besim që kanë dhe që e pranojnë si të vërtetë që të dy. Kjo është mënyra më e mirë e zgjidhjes së problemeve të ndryshme për të arritur në një mendim të vetëm, dhe në kërkim të lumturisë.

Nga ana tjetër, përvoja ka treguar se njerëzit që nuk kanë besim edhe, në qoftë se midis tyre ka një njohje të mëparshme relativisht të gjatë, pas martesës, për arsye të mungesës së vlerave unike dhe të përbashkëta midis tyre, duke u përballur me problemin më të vogël, lidhja merr fund si një flluskë sapuni.

Këtu duhet të kemi parasysh një pikë të rëndësishme, besimi i vërtetë te njeriu. Duhet theksuar se besimi është një ndjenjë e brendshme që lë pasoja dhe gjurmë të qarta në veprimet dhe mendimet e njeriut. Mbi këto gjurmë duhet identifikuar dhe njohur besimi dhe jo në bazë të formave të jashtme që mund të shfaqet te njeriu. Njerëzve, që pretendojnë se kanë besim të caktuar mbi një fe apo doktrinë, por në të vërtetë nuk e kanë këtë lloj besimi, nuk mund t'u zihet besë. Mund t'u zihet besë vetëm njerëzve, që besimi i tyre u është sprovuar në shumë raste të ndryshme.

Edukimi i mirë

Një nga kriteret e tjera vendimtare në zgjedhjen e bashkëshortit është edhe siguria që duhet të kemi tek edukimi i mirë i njeriut përballë. Jetesa me njerëz të egër, të pa edukuar, nevrinë dhe agresivë do të ishte e pamundur dhe do të sillte vështirësi dhe dëme të shumta. Nga hadithet kemi: “*Një bashkëshort i pa edukuar të sjell plakje të parakohshme.*” Një nga shokët e imam Rezait (paqja dhe bekimi i All-llahut qoftë mbi të), në një letër dërguar këtij të fundit, duke e pyetur, shkruan: “Një nga njerëzit e mi, më ka kërkuar dorën e vajzës, por është i pa edukuar.”

Ky hazret, në përgjigje të kësaj letre, shkroi: “Në qoftë se tek ai njeri dallon shenja të një natyre dhe karakteri sado pak të shtrembër, refuzojë atë.”

Fisnikëria në familje

Një faktor tjetër që ndihmon në përcaktimin e karakterit dhe personalitetit tek njeriu është studimi i familjes së tij. Njerëzit, që bëjnë pjesë në familje të pastra dhe me bazë edukimi të gjatë në kohë, kanë sjellje dhe edukatë morale dhe shpirtërore më të zgjeruar dhe më të qëndrueshme dhe për këtë arsye janë më të besueshëm. Sigurisht që kuptimi i kësaj pike nuk është i tillë që, kurrë nga një familje jo e rregullt dhe me mungesa të theksuara në edukatën dhe propagandën e saj kundrejt fëmijëve, të mos dalë një fëmijë me të vërtetë shembullor. Por kuptimi i këtyre fjalëve është se fëmija, zakonisht, është pasqyrë e edukimit të tij familjar. Nga hadithet e profetit të Islamit (paqja dhe bekimi i All-llahut qoftë mbi të), kemi: *“Trembuni barit që mbin në plehra, sepse është si ajo vajza e bukur, që është edukuar në një familje të keqe.”* Kjo shprehje është e vërtetë edhe për njerëzit që kanë bukuri të jashtme, pasuri, pozitë të pamërituar në shoqëri dhe që janë rritur në një familje të degjeneruar.

Faktorë dhe kriterë të tjera

Përveç faktorëve kryesorë, të përmendur me sipër, duhet pasur kujdes edhe në faktorë të tjerë dytësorë. Për shembull, një kriter tjetër, që duhet të kihet parasysh, është niveli arsimor dhe kapaciteti mendor i bashkëshortit, në mënyrë që të kenë ngjashmëri dhe të mund të kuptojnë horizontet mendore të njëri-tjetrit. Po ashtu, edhe paraqitja e jashtme duhet të pëlqehet nga partneri, por jo të ekzagjerohet. Edhe bukuria e jashtme të vendoset në radhën e parë të rëndësisë midis faktorëve, sepse përvoja ka treguar se vazhdimësia e jetës nuk kërkon nga bashkëshorti vetëm bukurinë e tij, por sjelljen, edukatën, pastërtinë shpirtërore dhe faktorë të tjerë të ngjashëm me këta. Gjithashtu, duhet pasur parasysh se, në qoftë se burri ka në plan të martohet, duhet të ketë mundësi dhe kushte të sigurojë jetën e tij dhe të gruas së tij. Në lidhje me këtë imam Sadiku (paqja dhe bekimi i All-llahut qoftë mbi të), ka thënë: *“Bashkëshort i përshtatshëm është ai që është i pastër shpirtërisht dhe mund të sigurojë jetën e çiftit.”* Sigurisht që kjo nuk është me kuptimin që njeriu t’i dorëzohet vlerave të ulëta të shoqërisë dhe të njohë pasurinë si faktorin kryesor për martesë. Disa mendojnë se, në qoftë se bashkëshorti i tyre do të kishte me tepër haber nga jeta materiale, bashkëjetesa me të do të ishte më frytdhënëse. Por përvoja ka treguar se ky mendim është i gabuar dhe ajo që e mban gjallë familjen dhe ngroh lidhjen midis çiftit dhe i sjell atij lumturinë është dashuria dhe lidhja e tyre shpirtërore. Nga ana tjetër, duhet pasur parasysh se, duke u bazuar në vlera të kota, që nuk janë tjetër veçse mbështetje e injorancës, do të sjellë vetëm pendim dhe keqardhje dhe do të shqetësohemi se ndoshta në të ardhmen nuk do të mund ta kompensojmë dot. Si rezultat i këtyre fjalëve, rrjedh se pas hedhjes së këtyre hapave një nga një, çdo njeri, me besim në hapin përfundimtar të vendosjes dhe zgjedhjes së bashkëshortit, duhet të ketë besim te Zoti dhe te ndihma e tij, sepse të gjitha të mirat kalojnë nga Ai. Lidhja, që ka përkrahje qiellore dhe kryhet mbi bazë të dëshirës dhe qëllimit të Zotit, patjetër që do të shoqërohet me lumturi të pamasë.

Domosdoshmëria në zbulimin dhe kërkimin e karakterit

Përcaktimi, se cilin bashkëshort duhet të zgjedhim, është një vendim i rëndësishëm, por i vështirë. Për këtë qëllim nevojitet kërkim dhe studim serioz i partnerit. Një studim i tillë nuk duhet ngatërruar me shoqërinë dhe miqësinë apo me kapriçiot afatshkurtra që mund të kemi me këtë partner. Në këto lloj miqësish dhe shoqërish, të pa kufizuara dhe të pa kontrolluara, nën petkun e sinqeritetit dhe të dashurisë ose me pretekstin e njohjes shpirtërore të partnerit, nuk janë të këshillueshme, sepse në të vërtetë, qëllimi i tyre nuk është martesë. Nga ana tjetër, përvoja ka treguar se të tilla shoqëri dhe miqësi, jo vetëm nuk kanë pasur vlerë për forcimin e lidhjeve në familje,

por janë bërë shkak i degjenerimeve të rënda për familjet. Për këtë qëllim, Islami i parandalon miqësi të tilla.

Islami i njeh bisedimet dhe njohjen midis burrit dhe gruas që kanë qëllim të martohen pas shpalljes së dëshirës se tyre për martesë, me kusht që kjo njohje dhe bisedat në lidhje me të, të mos jenë mbi bazën e kapriçove dhe tekave të askujt. Rruga e saktë e kërkimit dhe e njohjes së bashkëshortit është që mbi përpjekjet e tij dhe me ndihmën dhe bashkëpunimin e familjes së vet të marrë informacion duke pyetur për personalitetin e personit, familjes së tij, shokëve dhe shoqeve të tij dhe me ata që kanë njohuri dhe lidhje të ndryshme me të, derisa ai të bindet plotësisht për personin që është duke zgjedhur. Në rast se atij i mbeten dyshime për pika të ndryshme të karakterit të bashkëshortit nuk duhet të nxitojë për mbylljen e kontratës së jetës së tij, sepse këto kushte janë me rëndësi aq të madhe, sa nuk mund të zgjidhen dot me hamendje dhe parashikime. Në këtë kontekst, familjet e çiftit duhet të ndihmojnë fëmijët e tyre me të gjitha forcat në këtë detyrë serioze. Gjithashtu, fëmijët, nga ana e tyre, nuk duhet ta ndiejnë të tepërt ndihmën e prindërve, por duhet të përfitojnë sa më shumë nga përvoja e familjeve të tyre. Kjo këshillë është tepër e vlefshme, sidomos për vajzat, që janë nën ndikimin e drejtpërdrejtë të dashurisë. Në ligjin islam leja e babait për vajzën në rast martesë është e detyrueshme, po ashtu babai nuk duhet ta martojë vajzën e tij pa dëshirën e saj. Pra, përfundimisht, martesë bëhet mbi bazën e dëshirës së vetë çiftit dhe çdo mënyrë tjetër, përveç kësaj, nuk është ligjore dhe e saktë.

Me çfarë njerëzish nuk mund të martohemi?

Në legjislacionin islam, një grua myslimane nuk mund të martohet kurrë me një burrë jo mysliman dhe një burrë mysliman nuk mund të nënshkruajë dot martesë të përhershme me një grua jo myslimane (por një burrë mysliman mund të martohet me kontratë me një grua të një feje tjetër, ndërsa me një grua të pa fe nuk mund të nënshkruajë asnjë lloj martesë (theksojmë se me fe qiellore nënkuptojmë ato fe që kanë libër drejtues). Madje edhe pas martesës, sikur njëri prej çiftit të humbasë besimin islam, martesë vetvetiu bëhet e pavlefshme dhe çifti kategorikisht ndahet nga njëri-tjetri.

Gjithashtu, martesë është e pa vlefshme në rastet me njerëz të palejueshëm.

Njerëzit e palejueshëm ndahen në tri grupe.

1- Njerëzit që kanë lidhje gjaku me personin në fjalë nuk mund të martohen. Për mashkullin janë: nëna, motra, vajza, vajza e motrës dhe e vëllait, halla dhe teza, ndërsa për femrën janë: babai, vëllai, djali, djali i motrës dhe i vëllait, daja dhe xhaxhai.

2- Njerëzit, që e fitojnë lidhjen në sajë të martesës së çiftit, nuk kanë të drejtë të martohen me ndonjërin prej çiftit, të tillë janë: vjehrra, vajza e gruas (por jo vajza e tij), gruaja e babait (por jo nëna e tij), dhe vajza e djalit (nusja) për mashkullin dhe për femrën janë: babai i burrit, djali i burrit (por jo i saj), babai i nënës (por jo i saj), dhe burri i vajzës (dhëndri).

Përveç këtyre, martesë me motrën e gruas, derisa motra e saj të jetë gruaja e tij, është e ndaluar. Në rast divorci apo vdekjeje të gruas, martesë me motrën e saj është e lejueshme. Në këtë kontekst, motra e gruas nuk i përputhet ligjit të përgjithshëm të njerëzve të palejueshëm, sepse martesë me të nuk është e ndaluar përjetësisht, por detyrat që mashkulli ka për femrat e tjera të palejueshme janë të barabarta edhe për të.

3- Njerëzit, që për çfarëdolloj arsye kanë pirë qumësht nga gjoksi i të njëjtës femër (jo nëna e tyre), konsiderohen të palejueshëm për njëri-tjetrin dhe martesë e tyre nuk është e pranueshme.

Rëndësia e pastërtisë së brendshme para martesës

Një nga problemet më të rëndësishme, që nuk duhet lënë pa përmendur, është pikërisht pastërtia shpirtërore në periudhën para martesore. I riu, që arrin të ruajë dhe ta mbajë të pastër zemrën dhe shpirtin e tij nga ndotjet, papastërtitë dhe degjenerimet shoqërore, është në gjendje të hedhë hapa të sigurt në familjen e vet. Duke qenë i përgatitur shpirtërisht dhe me zemër të mbushur me mirësi, e ujit këtë fidan të shenjtë me ndjenjat e tij të pastra. Ndërsa ata që janë bërë njësh me llumin e shoqërisë, që zotërojnë cilësi të ulëta njerëzore dhe që janë larguar nga boshti i mirësisë dhe pastërtisë shpirtërore, e kanë humbur përfundimisht këtë investim gjigant në brendësitë e tyre. Në këtë kontekst, këta persona janë të paafte të drejtojnë familjen e tyre drejt lumturisë dhe qëllimeve të shenjta, duke qenë të dyshimtë në besnikërinë e tyre kundrejt bashkëshortit/es. Theksojmë edhe njëherë se pastërtia e zemrës dhe qëndrimi larg ndotjeve dhe “smogut shoqëror” është një investim shpirtëror mjaft i çmuar dhe praktikisht i pazëvendësueshëm. Njeriu, me anë të këtij investimi, duhet të mbajë ndezur kandilin e familjes së vet dhe ta ndriçojë rrugën e lumturisë familjare. Pra, personat që u mungon një investim i tillë, e humbasin rrugën drejt lumturisë, sepse ëmbëlsia e bashkëjetesës është lumturi në përpjesëtim me pronarët e saj dhe që nuk mund të krahasohet me ndonjë lloj kënaqësie tjetër.

Sistemi familjar i kërkuar

Pasi gruaja dhe burri njihen me njëri-tjetrin dhe më pas lidhen duke krijuar familjen, duhet të kenë parasysh një pikë të rëndësishme, që me anë të kësaj lidhjeje fatet e tyre u unifikuan dhe janë të përbashkët. Lumturia e njërit, padyshim është funksion i lumturisë së tjetrit. Në qoftë se nuk do të arrijnë ta mbajnë të ngrohtë këtë lidhje me anë të dashurisë dhe mirësisë, asnjë prej tyre nuk do të ketë lumturi. Në këtë mënyrë, ata duhet që, të drejtat dhe dëshirat e njëri-tjetrit, t'i kenë të shenjta dhe të mos shuajnë dritën e kandilit të familjes së tyre për probleme të vogla dhe pa rëndësi. Me fjalë të tjera, asgjë më shumë se sinqeriteti dhe dashuria për njëri-tjetrin nuk do të kishte efekt në lumturinë dhe fatbardhësinë e tyre. Nëse çifti do të përdorë mirëkuptimin dhe logjikën midis tyre, do të jetë në gjendje të zgjidhë edhe problemet më të vështira, që mund t'ju dalin përpara, duke e mbajtur të ndezur dhe të ngrohtë kandilin e familjes së tyre, duke krijuar një ambient dashurie dhe sinqeriteti, si për veten e tyre edhe për fëmijët.

Fatkeqësisht, disa njerëz nuk kanë dijeni të mjaftueshme për fitimet dhe humbjet e tyre familjare dhe, për arsye të kota dhe fare pa vlerë, e fikin dritën e këtij kandili kaq të shenjtë, duke e vënë lumturinë nën kthetrat e mendjeshkurtësisë së tyre. Parashikimet e kota, mungesa për një kohë të gjatë e ndonjërit prej tyre, injoranca, zakonet e gabuara dhe, që në fillim, themeli ose boshti i lidhjes së tyre i pasaktë, shkaktojnë ftohje të zemrave, duke u ndarë dhe fikur përgjithmonë dritën e kandilit ndriçues.

Ajo që ka rëndësi në një familje është se gruaja dhe burri duhet të njohin detyrat e tyre dhe të respektojnë të drejtat e bashkëshortit. Mosmarrja parasysh e detyrave dhe shkelja e të drejtave të bashkëshortit sjell shkatërrimin total të rregullit dhe rendit në familje. Njeri perfekt në këtë drejtim është ai që është i bindur për detyrat e tij, duke njohur më së miri kufirin midis të drejtave të tij dhe të bashkëshortit dhe kurrë nuk është i gatshëm të shkelë mbi të drejtat legjitime të bashkëshortit të vet, duke u bërë motiv i dhembjeve dhe i vuajtjeve të tij.

Roli kryesor i gruas dhe detyrat e burrit përballë saj

Ndarja e detyrave në familje, në bazë të vetive fizike dhe psikologjike të burrit dhe të gruas, do të bëhej shkak i një drejtimi më të mirë të familjes. Duke pasur parasysh investimet shpirtërore, së bashku me virtytet e falura nga Zoti tek burri dhe gruaja, pikërisht mbi bazën e këtyre depozitave që disponon secili, duhet të arrihet një rendiment sa më i lartë në familje në edukimin e fëmijëve.

Gruaja, për arsye të rolit të veçantë që ka në sistemin e krijimit, është e pajisur me virtyte dhe investime të çmueshme. Shoqëria njerëzore ka shumë nevojë për zhvillimin dhe perfeksionimin e saj. Njëra nga këto virtyte është dashuria e nënës, e cila, në të gjitha kohërat dhe shoqëritë njerëzore, ka pasur një rol të pazëvendësueshëm. Dashuria e nënës është një mjet dhe domosdoshmëri që ekziston në brendësi të femrës dhe nga kjo pikëpamje femra ka prioritet në lidhje me mashkullin.

Dashuria është një ndjenjë dhe një tërheqje që arrin ta shkëpusë njeriun nga dëshira për vetveten dhe ta vendosë atë në qendër të vëmendjes së të tjerëve. Në këtë kontekst, dashuria mund të përkufizohet si zhvendosje nga “dëshira për vetveten” në “dëshirën për tjetrin”. Kjo lloj ndjenje është e vendosur te çdo njeri, por tek gratë kjo dritë qiellore është më e zhvilluar dhe e vendosur në një shkallë më të lartë, në mënyrë që ajo të mund të mbajë ndezur dritën e kandilit të familjes dhe të mund të përballojë lodhjen për rritjen dhe edukimin e fëmijëve. Burimi i dritës së këtij kandili në shoqërinë njerëzore është pikërisht zemra e nënës, që i rrezaton brezit të ri këtë dritë, në mënyrë që edhe ata të mund të rrisin fidanët e dashurisë në shpirtrat e tyre. Njerëzit egoistë, pa ndjenja, të egër janë plotësisht larg njerëzimit, sepse zemrat e tyre nuk janë lagur me dashurinë e nënave dhe nuk e gëzojnë butësinë e nevojshme shpirtërore. Pikërisht, me këto probleme po përballlet shoqëria perëndimore në ditët e sotme, ku mungesa e dashurisë njerëzore në brezin e ri ka sjellë me vete një situatë kritike dhe të pazgjydhshme. Në këtë kontekst, duhet që gruaja ta mbajë të ndezur pishtarin e shenjtë të dashurisë dhe me atë të ndriçojë hapësirën ku do të rritet dhe edukohet brezi i ardhshëm, në mënyrë që edhe ata të dinë se çfarë është dashuria njerëzore. Për këtë qëllim, burrat duhet të përgatisin një ambient sa më të përshtatshëm dhe të bashkëpunojnë pandërprerë, që gratë të mund ta zbatojnë këtë detyrë serioze.

Për të ecur në këtë rrugë duhet që, në radhë të parë, të sigurohet te gratë një gjendje e gëzueshme shpirtërore dhe të shmangen të gjitha streset e brendshme familjare, në mënyrë që gruaja të këtë mundësi, që këtë investim të brendshëm ta shfaqë në formën më të mirë, duke e pajisur familjen me dashuri, rregull, dhe respekt. Të tillë art janë në gjendje ta shfaqin vetëm gratë e rregullta, që nuk janë dëmtuar nga streset e ndryshme dhe këtë investim nuk e kanë shpërdoruar kot. Gëzimi shpirtëror i gruas qëndron i pari në lidhjen shpirtërore midis saj dhe bashkëshortit dhe kështu që reflektimi i dashurisë njerëzore dhe më së fundi i sigurisë në dashurinë e tyre varet më tepër nga ajo. Në qoftë se burri nuk do të arrijë të plotësojë dëshirat, ndjenjat dhe pasionet shpirtërore të bashkëshortes së vet, ose me anë të veprimeve dhe fjalëve të tij të pengojë të tilla kërkesa të bashkëshortes, ose të mos bashkëpunojë me të në sakrificë, dashuri dhe në dëshirat e zemrës, duke mos krijuar dot qetësinë shpirtërore të nevojshme, si mundet ky burrë të presë që nga ky kandil i fikur të ndriçohet familja e tij.

Një pikë tjetër është se gruaja, duke qenë e ngarkuar me dashuri të mëdha, zakonisht është e gatshme të bëjë të gjitha sakrificat në rrugën e bashkëshortit. Përveç kësaj, merr përsipër ngarkesën e familjes dhe sidomos atë të edukimit të fëmijëve të saj, duke qenë nën një presion të lartë fizik dhe shpirtëror. Nga ana tjetër, duhet theksuar se, pa sakrificat e saj, familja nuk ka zhvillim dhe mbarësi. Këtu me të drejtë lind

pyetja: Çfarë detyrash ka burri përballë gjithë këtyre sakrificave dhe vështirësive të gruas së vet? A duhet gjë tjetër, përveçse me fjalë dhe vepra të tregojë se ua di vlerën dhe i çmon këto sakrifica? Po në qoftë se gruaja mendon se sakrificat e saj në familje vlerësohen, a është ky mendim i arsyeshëm? Në qoftë se gruaja vepron sipas rregullave dhe edukatës së saktë në familje, duke krijuar qetësinë dhe gëzimin e pjesëtarëve të tjerë, cila është detyra e këtyre pjesëtarëve kundrejt saj? Kur'ani Famëllartë për këtë shprehet: **“A ka shpërblim tjetër për të mirën, veç të mirës?!” (Er- Rahman: 60)**

Përveç kësaj mënyre, a mund të pritët që në familje të ruhet fisnikëria njerëzore dhe ajo të shndërrohet në një qendër të edukimit të vërtetë njerëzor?

Burri duhet të kompensojë në forma të tjera sakrificat e bashkëshortes, dhe gjithashtu duhet t'i njohë fëmijët e vet që në fillim me sakrificat e nënës së tyre dhe vlerat e saj njerëzore, të shmangë dhe të eliminojë plotësisht çdo lloj mos respekti ose mos falënderimi për këto sakrifica të bashkëshortes së vet. Të gjitha këto sakrifica dhe vështirësi e gruas, në qoftë se nuk do të merren parasysh ose do të anashkalohen, atëherë kemi të bëjmë me shkelje të të drejtave të saj dhe sigurisht kemi të bëjmë me një mëkat të madh.

Drejtori i familjes

Mjedisi i familjes ka po aq nevojë për dashurinë njerëzore të gruas dhe ndjenjave të saj shpirtërore, sa ka nevojë për fuqinë, vendosmërinë, planin, kontrollin dhe drejtimin e burrit. Duke pasur parasysh se këto cilësi janë më të theksuara në karakterin e burrit, Islami i ka dhënë të drejtën e drejtimit të familjes këtij të fundit.

Kuptohet se edhe familja, si çdo organizatë, bashkësi, fondacion etj, në shoqëri ka nevojë për një drejtues. Në qoftë se burri nuk arrin të marrë përsipër këtë drejtim ose e keqdrejton, atëherë do të kemi të bëjmë me prishjen e rregullit dhe rendit të përgjithshëm brenda familjes. Këtu duhen pasur parasysh dy pika:

1- Burri duhet të vendosë drejtimin e familjes në krye të programit të tij dhe të mos anashkalojë apo ta nënvleftësojë atë. Disa burra mendojnë se detyra e tyre e vetme është sigurimi i të ardhurave familjare edhe me kaq mbyllet dhe dosja e detyrave të tyre familjare. Pra, duket qartë se të tillë burra nuk janë të informuar aq sa duhet për detyrat familjare, duke u bërë bisht pjesës më të madhe të detyrimeve të tyre. Në këtë mënyrë, nuk janë gjë tjetër veçse të huaj në shtëpinë e tyre. Padyshim, që këta tipe burrash nuk veprojnë siç duhet me drejtimin e familjeve. Prandaj theksojmë edhe një herë se familja po aq sa ka nevojë për gruan, po aq ka nevojë edhe për burrin dhe asnjëri prej tyre nuk e zëvendëson dot tjetrin.

2- Nuk duhet ngatërruar drejtimi i familjes me ligjin e më të fortit, dhunën dhe logjikën të tilla të ngjashme. Këto shprehje jo vetëm që nuk kanë kuptimin e drejtimit, por familjen e kufizojnë dhe e pengojnë nga lumturia e vërtetë e saj duke futur grindje dhe mosmarrëveshje midis çiftit. Në këtë kontekst, edhe pikëpamja qiellore e përball njeriun me rezultate dhe përfundime të rënda.

Thuhet, kur vdiq njëri nga bashkëkohësit e profetit Muhammed (paqja e All-llahut qoftë mbi të), vetë Profeti mori pjesë në ceremoninë mortore të tij. Nëna e të ndjerit, kur pa profetin midis të tjerëve, iu drejtua djalit të saj të vdekur me këto lutje: “Lum ti që shkove në parajsë!” Ndërsa Profeti u shpreh: *“Qetësohuni dhe mos flisni me bindje të plotë në punën e Zotit, sepse ai tashmë është në vuajtje dhe nën presion të plotë.”* Të pranishmit u befasuan nga këto fjalë dhe e pyetën profetin për arsyen. Profeti u përgjigj: *“Ai sillej keq me familjen e tij.”*

Kur'ani i fton të gjithë burrat që të jenë të sjellshëm dhe gjakftohtë në familjet e tyre dhe gjithashtu u ka dhënë urdhër që të jenë të sjellshëm me bashkëshortet e tyre:

Profeti Muhammed (paqja dhe mëshira e All-llahut qoftë mbi të) për këtë është shprehur:

“Më i miri nga ju është ai që është më i mirë për familjen e tij dhe unë jam më i mirë se ju për familjen time. Njerëzit që e vlerësojnë gruan do të nderohen, dhe ata që poshtërojnë ato do të poshtërohen përfundimisht.” (Naxhul Balagha)

Ja edhe një thënie tjetër po nga ky Hazret:

“Në qoftë se gruaja ose burri e keqtrajton bashkëshortin e vet, Zoti atij nuk ia pranon namazin dhe asnjë veprim tjetër të mirë të tij, derisa t’i kthejë gëzimin bashkëshortit.”

Burri duhet që të konsultohet me bashkëshorten e vet, sidomos për problemet që kanë të bëjnë me bashkëshorten e tij, që të mos gabojë dhe të bjerë në despotizëm. Nga ana tjetër, gruaja duhet të pranojë udhëheqjen e burrit dhe me bindje dhe me mundësitë e saj duhet ta ndihmojë bashkëshortin për ta drejtuar më mirë familjen. Por sidoqoftë, duhet të ketë parasysh se asnjë lloj shoqërie, organizate, bashkësie, grupimi, ku edhe familja nuk bën përjashtim nga këto, nuk drejtohet dot pa një drejtor ose përgjegjës që të tjerët ta dëgjojnë dhe t’i binden fjalëve të tij. Familjet, ku roli i përgjegjësish së burrit është i dobët, përballen me probleme të shumta. Në këtë kontekst, Islami rregullat e tij i mbështet mbi bazën e karakterit dhe krijimit të njeriut. Në sistemin familjar drejtimin e familjes ia ka besuar burrit, ku të tjerët, me bindje dhe me bashkëpunimin e tyre, ndihmojnë në këtë drejtim.

Në këtë mënyrë është bërë shpërndarja e detyrave dhe e të drejtave, me qëllim që drejtimi i familjes të jetë më i përkryer dhe asnjë prej tyre të mos ketë përparësi te tjetri.

Ekonomia familjare

Islami, shpenzimet e familjes ia ka besuar burrit, që me aktivitetin dhe punën e tij të përballojë kërkesat materiale të gruas dhe fëmijëve të tij. Edhe në qoftë se gruaja e tij nuk do të kishte nevojë, nga pikëpamja financiare, kjo gjë nuk do t’ia hiqte dot atij këtë detyrë. Në këtë fushë, pjesëtarët e tjerë të familjes dhe në veçanti bashkëshortja e tij duhet të bashkëpunojë në mënyrë të sinqertë me burrin, me qëllim që ekonomia e shtëpisë dhe buxheti i saj të ndahet sa më drejt. Pakujdesia në këtë pikë shoqërohet me probleme dhe pakënaqësi të shumta dhe ngandonjëherë rëndohet në shkallë të tillë, sa që problemet e tjera themelore të familjes lihen pas dore. Diçka që duhet të theksohet është se plotësimi i disa prej dëshirave nuk mund ta mbushë dot boshllëkun e krijuar nga marrëdhënie jo të sinqerta dhe ta shoqërojnë njeriun drejt lumturisë së tij. Njerëzit, që lumturinë e familjes së tyre e terrorizojnë për dëshira dhe kërkesa pa vlerë, sikur e djegin atë dhe tymi i saj, para se gjithash, mbulon sytë e tyre. Përballimi i shpenzimeve të rënda që në fillim të krijimit të familjes, si dhe shpenzimet e kota dhe pa vend në stadi të tjera të jetës, bëhen shkak që familja, që në fillimet e saj, të dalë nga rruga e drejtë.

Në qoftë se ndonjë do të gjejë rezultatet që sjellin këto dëshira të kota dhe ndikimin që kanë në jetën dhe në fatin e tij, do të kuptojnë fare qartë se qëllimi i tyre është i papërfillshëm në lidhje me qëllimin kryesor të bashkëjetesës dhe padyshim që do të pendohet kur të kuptojë se e ka përzier këtë bashkëjetesë me dëshira të tilla kaq të ulëta.

Ka shumë familje që bëjnë një jetë të thjeshtë, jashtë luksit dhe ekstravagancës, por, për shkak të lidhjeve të sinqerta dhe dashurisë që kanë për njëri-tjetrin, ndihen shumë herë më të lumtur se ato familje që i mbulojnë të mirat materiale, por që janë të dënuara nga sinqeriteti dhe dashuria për njëri-tjetrin dhe nuk u mbetet gjë tjetër veçse sherrit, grindjes dhe vuajtjes në jetën e tyre. Arsyeja, që disa njerëz i japin rëndësi jetës plot shpenzime të kota dhe pa vlerë, është se nëpërmjet tyre kërkojnë të mbushin

boshllëkun e krijuar në jetën e tyre dhe lumturinë e brendshme ta kompensojnë me atë të jashtme. Por meqenëse rrugën e kanë të mbyllur, nga dita në ditë gjendja e tyre përshkallëzohet dhe gjithmonë e më tepër e ndiejnë veten të huaj në familje.

Sidoqoftë, gruaja luan një rol të rëndësishëm në ndarjen e ekonomisë familjare dhe duhet që me një plan të logjikshëm të mbështesë bashkëshortin e saj në administrimin sa më të mirë të ekonomisë së tyre familjare. Gjithashtu, edhe fëmijët me kontributin e tyre, duke pasur parasysh gjendjen e familjes dhe me modifikimin e dëshirave të tyre, mund t'i vijjnë në ndihmë familjes në kapërcimin e problemeve ekonomike dhe përmirësimin e ekonomisë familjare.

Bashkëpunimi në familje

Nuk ka dyshim që mirëkuptimi dhe bashkëpunimi është themeli i bashkëjetesës familjare. Bashkëpunimi mund të jetë në forma të ndryshme, sipas gjendjes së familjes. Në disa familje gruaja nuk ka aktivitet jashtë shtëpisë dhe në këtë mënyrë përpiqet që të jetë pjesëmarrësja dhe partnerja kryesore në punët brenda shtëpisë, duke i krijuar mundësi më të mëdha burrit në aktivitete jashtë shtëpisë, për të siguruar të ardhurat e jetës së familjes. Ndërsa në disa familje të tjera, ku gratë zotërojnë profesione të ndryshme dhe kanë aktivitete jashtë shtëpisë, u ngelet më pak kohë për problemet brenda shtëpisë. Në këto raste është e domosdoshme ndihma e burrit që të plotësohet ky boshllëk i krijuar në familje. Pra, mund të ndodhë që në një familje, për arsye të kushteve ekonomike të veçanta, burrit i duhet të shpenzojë me tepër kohë në aktivitetet e tij jashtë shtëpisë për të siguruar ekonominë e familjes dhe është e natyrshme që t'i mbetet pak kohë për problemet e brendshme të familjes, por me sakrificat e bashkëshortes, në këtë pikë, ky boshllëk mund të plotësohet më së miri. Sidoqoftë, në rregullat islame, aktiviteti i burrit ose i gruas në problemet e brendshme familjare ka vlera të mëdha shpirtërore dhe si i tillë do të shpërblehet në stacionin qiellor.

Profeti Muhammed (paqja dhe mëshira e All-llahut qoftë mbi të) ka thënë: *“Në qoftë se gruaja brenda shtëpisë do të punojë si burrë, atëherë Zoti do të vendosë mirësinë e tij mbi të dhe në qoftë se Zoti vendos mirësinë e tij mbi dikë, do të thotë që ky njeri është i sigurt nga torturat e xhehenemit.”*

Imam Aliu (paqja dhe mëshira e All-llahut qoftë mbi të) aktivitetin e burrit brenda familjes e prezanton si falje të mëkateve të mëdha të tij. Nga këto fjalë kuptojmë se sistemi familjar duhet të bazohet në sakrificat dhe shërbimet reciproke, ku këto të fundit janë funksion i sinqeritetit dhe i dashurisë për njëri-tjetrin. Jeta e profetëve dhe e imamëve është një shembull i përkryer i këtij problemi, sepse ata, përveç punëve dhe aktiviteteve të rënda shoqërore jashtë familjeve të tyre, gjenin kohë edhe për problemet e brendshme në familjet e tyre.

Një pikë me rëndësi të madhe për këtë problem është falënderimi i partnerëve ndaj njëri-tjetrit, për sakrificat dhe shërbimet që janë kryer. Mos vlerësimi dhe mos falënderimi nga tjetri konsiderohet si edukatë e shëmtuar që shkakton ndërprerjen e sakrificës dhe lindjen e urrejtjes.

Roli i edukimit të njëri-tjetrit tek çifti

Siç e kemi theksuar edhe më lart, burri dhe gruaja janë të pajisur me veçori të ndryshme fizike dhe psikologjike, për arsye të forcimit të lidhjes së tyre dhe ndarjes më të përshtatshme të detyrave dhe të drejtave. Në këtë kontekst, burrin dhe gruan mund t'i përkufizojmë si plotësues të njëri-tjetrit, ku në plotësimin e tyre kanë nevojë për njëri-tjetrin.

Duke qenë në një rrjedhe sinqeriteti në familje, secili mund të përfitojë nga virtytet dhe investimet shpirtërore të tjetrit dhe t'i vendosë ato në shërbim të perfeksionimit të vet. Dashuria e brendshme te gruaja dhe ndjenjat e saj të zhvilluara në këtë dimension mund të jenë faktorë për pastrimin e shpirtit të burrit dhe përforcimin e dimensionit të dashurisë në karakterin e tij dhe anasjelltas gruaja mund të ndikohet nga qëndrueshmëria shpirtërore e burrit dhe forca e tij logjike që të stabilizojë lëkundjet e veta shpirtërore dhe të modifikojë karakterin e saj në favor të qëndrueshmërisë së personalitetit të saj, i cili është i paqëndrueshëm në sajë të ndjenjave të forta të dashurisë që ekzistojnë tek ajo.

Nga ana tjetër, burri dhe gruaja, për shkak të lidhjes së vazhdueshme, të sinqertë të afërt që kanë me njëri-tjetrin, mund ta ndihmojnë në njohjen dhe eliminimin e pikave të dobëta më mirë se askush tjetër njëri-tjetrin. Është me rëndësi të theksohet se kjo detyrë është më e lartë se detyrat e tjera të përgjithshme që kemi për njëri-tjetrin. Familjet që kanë themele të shëndosha dhe drejtohen mbi bazën e boshtit të së vërtetës dhe virtytit, secili prej tyre (burri dhe gruaja) janë faktorë të përsosmërisë dhe të lumturisë së njëri-tjetrit. Në këto familje, bashkëpunimi i sinqertë duket qartë jo vetëm në problemet e brendshme, por në të gjitha fushat, ku secili lumturinë e tij e kërkon te tjetri.

Koordinimi i përgjegjësive familjare dhe shoqërore

Aktiviteti i burrit apo i gruas në problemet e brendshme të familjes nuk duhet të bëhen shkak që ata të mbeten prapa dhe të lenë pas dore aktivitetet e tjera shoqërore jashtë familjes. Një shoqëri e zhvilluar ka nevojë për aktivitetin serioz të gruas. Në qoftë se të gjitha gratë do të ishin të angazhuara me problemet e brendshme të familjes dhe nuk do të kishin kohë për aktivitetet shoqërore jashtë familjes, atëherë kjo gjë nuk është në të mirë as të shoqërisë, as të vetë grave. Në shoqëritë ku gratë janë të kufizuara nga aktivitetet e jashtme shoqërore, padyshim që janë shoqëri të prapambetura dhe të pa zhvilluara. Nga ana tjetër, ekzistojnë profesione ku gratë mund të jenë shumë të suksesshme, si në edukimin e fëmijëve apo në profesione ku mbrohen dhe zhvillohen interesat e vetë femrave, si: profesione mjekësore për femra. Në këtë kontekst, koordinimi dhe modifikimi midis këtyre dy lloj aktivitetesh do të bënte të mundur zhvillimin e familjes së bashku me aktivitetet e gruas brenda saj, që pa dyshim, ka përparësi në lidhje me punët e tjera, si dhe pjesëmarrjen e gruas në aktivitetet e shumta shoqërore. Për realizimin e këtij projekti nevojitet bashkëpunimi i pandërprerë i burrit.

Këtu duhet të trajtohet seriozisht një pikë me rëndësi, që në shoqërinë e sotme, aktiviteti i grave, duke dalë jashtë kontrollit, na paraqitet me pamje tjetër, duke u shoqëruar me degjenerime të shumta. Që nga koha e revolucionit industrial në botën perëndimore, kur kapitalistët kërkonin krah pune të lirë, me slogane mashtruese planifikuan shfrytëzimin e padrejtë të grave dhe deri më sot, duke kaluar dhjetëra dekada, ne jemi të ndërgjegjshëm për shfrytëzimin e grave në favor të degjenerimit të shoqërisë.

Ëil Durant në librin e tij “Kënaqësia e filozofisë” në lidhje me këtë temë shkruan: “Gratë ishin punëtore më të lira dhe ishin më të preferuara nga pronarët se sa burrat e revoltuar me çmim të lartë. Një shekull më parë, në Angli, të gjeje punë për burrë, nuk ishte gjë e lehtë, por lajmërimet dhe njoftimet thoshin që të dërgonin gratë dhe fëmijët e tyre nëpër fabrika. Pronarët duhet që të llogarisin fitimet dhe të ardhurat e tyre dhe nuk duhen shqetësuar nga tradita, edukata, qeveria etj. Njerëzit që thurën komplot “pa dashje” për shkatërrimin e familjeve ishin pronarët e fabrikave, atdhetarë të shekullit të XIX në Angli.” (faqe 151)

Në të tilla shoqëri, dinjiteti, personaliteti dhe nderi i gruas janë të pambrojtur, ku aktivitetet e jashtme shoqërore janë vetëm një pretekst për të mbuluar përkeqësimin e mëtejshëm të degjenerimit total, duke përfshirë këtu, si atë shoqëror, ashtu edhe atë edukativ. Rezultati i parë negativ, që vërehet në këto shoqëri, është dobësimi dhe shkatërrimi i familjes dhe i ligjeve të ngrohta të saj. Duhet ditur që një humbje me përmasa të tilla, siç është familja, nuk mund të kompensohet me asnjë lloj fitore në çfarëdolloj fushe.

Si shembull mund të merret gjendja e familjes në Itali. Martesat zyrtare në këtë vend kanë pësuar ulje, duke e mbajtur rritjen e popullsisë nën zero dhe duke sjellë shqetësime të shumta. Divorcet janë shtuar, ndërsa lindjet janë drejt zeros. Në çdo tri italianë, njëri prej tyre ka dëshirë të jetojë i vetëm. Njerëzve u mungon dëshira për të krijuar familje dhe për të pasur fëmijë. Janë krijuar dyshime dhe frikë në lidhje me martesën në këtë vend. Një nga arsyet që pengon martesat dhe krijimin e familjeve është punësimi i grave dhe papunësia false për burrat. Në Suedi, gjithashtu, një e treta e martesave përfundojnë me divorc. (Nxjerrë nga statistikat civile të këtyre vendeve). Edhe në librin “Dallga e tretë” e autorit Alvin Tofler trajtohet gjendja e paekuilibruar e familjeve amerikane: “Pothuajse nuk gjendet asnjë familje që mos të ketë parregullsi psikologjike.” (faqe 504) dhe “Sot edhe njëherë tjetër njerëzit e ndiejnë se personaliteti i tyre thyhet tamam si një vezë e përplasur në mur, por sikundër të kaluarës, konsiderohet si mëkat ligjor, i shkaktuar nga shthurja e familjes dhe jo nga faktorë ekonomikë.” (faqe 288)

A mund t’i shikojmë me naivitet këto slogane që shpërndahen anë e kënd dhe të gënjehemi prej tyre, duke qenë dëshmitarë të këtyre përvojave të hidhura në shoqërinë e sotme?

Për të parandaluar degjenerime të tilla në shoqëri, duhet hequr dorë nga përzjerjet e padisiplinuara të grave dhe burrave në shoqëri dhe aktivitetet e tyre duhet të bazohen në aureolën e pastërtisë shpirtërore. Aktivitetet e jashtme të tyre të mos mbeten peng si pretekste për piratët e shoqërisë së sotme dhe qëllimeve të tyre satanike.

Islami, burrat i detyron të respektojnë pastërtinë shpirtërore të grave dhe me zemër të artë dhe të papërlyer të bashkëpunojnë me gratë në shoqëri dhe të mos shkelin kufijtë e modestisë dhe të virtytit. Në qoftë se burrat e një shoqërie do të ishin të pakorrigjueshëm, atëherë nuk ka dyshim që edhe gratë do të tërhiqeshin në degjenerim. Profeti Muhammed (paqja dhe mëshira e All-llahut qoftë mbi të) për këtë thotë: “*Në fillim pastroni burrat, në mënyrë që gratë tuaja të mbeten të virtytshme.*”

Nga ana tjetër, Islami i fton gratë në ruajtjen dhe respektimin e pastërtisë së tyre, në mënyrë që të mbrojnë virtytet e tyre nga piratët njerëzorë. Po ashtu, në lidhje me këtë, profeti i nderuar i Islamit (paqja dhe mëshira e All-llahut qoftë mbi të) thotë: “*Pastërtia shpirtërore është veshja e gruas.*”

Kur’ani Famëllartë në historinë e hazretit Musa thekson pikërisht këtë virtyt, në lidhje me vajzën e hazretit Shuaib, kur thotë: “*Ajo ecte me modesti.*” (Kasas:25)

Nga këtu kuptohet qartë se modestia dhe pastërtia janë nga virtytet më të larta shoqërore dhe edukative tek gratë dhe duhen pasqyruar në çdo kohë dhe lëvizje.

Pastërtia shpirtërore tek burrat dhe gratë e ruan shoqërinë të shëndetshme dhe e forcon familjen. Në një shoqëri islame gruaja ruan pastërtinë dhe modestinë e saj. Ajo nuk duhet të jetë në kërkim të vlerave të ulëta, si: egoizmi dhe përpjekjet për t’u shfaqur ndryshe nga ç’është. Gruaja në Islam mund të zbatojë rolin e vetë dhe të jetë aktive në shoqëri, gjithashtu nevojitet të jetë aktive edhe në dije, shkencë dhe specialitete të ndryshme, ku të zbatojë detyrat e saj serioze dhe në të njëjtën kohë të mos lërë pas dore përgjegjësitë e saj familjare. Një përvojë e tillë në shoqërinë e sotme është e çmuar dhe mund të jetë shembull për shoqërinë e së nesërme.

Kushti më i rëndësishëm për vazhdimin e sinqeritetit

Siç është theksuar edhe në pjesët e tjera, vetia më e rëndësishme e familjes, që e dallon atë nga shoqëria civile, është se në familje qeveris dashuria dhe sinqeriteti. Pra, në qoftë se në shoqërinë civile qeverisin dhe mbretërojnë ligjet, në familje, ato do të ishin: dashuria për njëri-tjetrin, sinqeriteti dhe falja njerëzore, që mbretërojnë tek pjesëtarët e saj.

Një pyetje me rëndësi, që i duhet dhënë përgjigje këtu, është: Si mund të shpëtojmë nga rreziku i dëmtimit dhe zhdukjes së lidhjes një çift, kur ata kanë krijuar sinqeritetin dhe besimin te njëri-tjetri?

Është e nevojshme të rikujtohet se lidhjet njerëzore janë të ndërtuara mbi bazën e vetive të veçanta, ku pakujdesia më e vogël mund të krijojë dëme të pallogaritshme. Pra, me fjalë të tjera, krijimi i ekzistencës së sinqeritetit, në një lidhje shpirtërore nuk është gjë e lehtë, por vazhdimësia dhe mbajtja gjallë e kësaj lidhjeje është akoma dhe më e vështirë dhe kërkon kujdes më të madh. Sa e sa bashkëshortë, edhe pse në fillimet e lidhjes së tyre gëzonin sinqeritet të plotë, lidhja e tyre u shndërrua në armiqësi dhe urrejtje për njëri-tjetrin. Në këtë kontekst, duket qartë se njeriu nuk duhet të gënjëhet në fillim nga sinqeriteti i lidhjes, por duhet të jetë i kujdesshëm gjatë tërë periudhës së lidhjes, në mënyrë që të shmangë rreziqet e shkatërrimit të lidhjes, që mund të dalin gjatë rrugës së tij të gjatë.

Një rregull themelor për ruajtjen dhe forcimin e lidhjes së sinqertë midis dy njerëzve është se, që të dy palët e çiftit duhet, që pas krijimit të një lidhjeje të tillë shpirtërore, në të gjitha etapat e jetës, të përpiqen të krijojnë kënaqësinë e tjetrit, aq sa u lejon horizonti mendor dhe kushtet e jetesës. Në qoftë se nuk do të arrinin të krijojnë dot kënaqësi dhe dashuri për tjetrin, padyshim që do të lindë vuajtja dhe urrejtja dhe do të krijohet boshllëk midis tyre. Në këtë kontekst, pakujdesia tek dëshirat shpirtërore të tjetrit, si dhe anashkalimi dhe nënvleftësimi i krijimit të dashurisë dhe lumturisë për tjetrin, i cili ka një lidhje të sinqertë, është në vetvete një mos falënderim i kësaj dhurate, duke shkaktuar shkatërrimin përfundimtar të lidhjes. Por, në qoftë se dëshira shpirtërore e tij dhe krijimi i lumturisë dhe i kënaqësisë bie ndesh me logjikën, ligjet dhe kushtet e jetës, në këto raste të veçanta duhet vepruar në një mënyrë të përshtatshme, ku, me anë të mirëkuptimit dhe bindjes së tjetrit, të arrihet ndryshimi i mendimit dhe i dëshirës së tij. Ato që shkaktajnë shkatërrimin e lidhjes dhe i largojnë zemrat nga njëra-tjetra, padyshim që janë problemet që lindin si rezultat i preferencave dhe shijeve të ndryshme ose i pakujdesive dhe i mos vëmendjes. Njerëzit që janë në dijeni për vlerat e sinqeritetit nuk janë kurrë të gatshëm që për arsye boshe dhe pavlerë ta shkatërrojnë këtë virtyt, por gjithmonë përpiqen që, duke falur, të shmangin rrezikun e zhdukjes së sinqeritetit dhe bashkë me të edhe të lidhjes shpirtërore.

Diçka që duhet pasur parasysh këtu është se asnjëherë dy njerëz nuk janë të ngjashëm në të gjitha drejtimet dhe si rezultat, do të kemi ndryshim në preferencat dhe shijet e tyre, të shoqëruar edhe me mendime dhe pikëpamje të ndryshme. Përveç kësaj, askush nuk është personalitet qiellor, pa defekte dhe gabime. Të gjithë jemi të gabueshëm dhe duhet të mendojmë se si t'i eliminojmë ato. Prandaj mendimi se ekziston ndonjë njeri i ngjashëm me ne në të gjitha drejtimet është praktikisht i gabuar. Pra, duhet që në lidhjet njerëzore dhe ato familjare në veçanti, me anë të faljeve dhe kompromisit, të përpiqemi t'i forcojmë dhe asnjëherë të mos krijojmë ftohje për arsye të mendimeve jo të logjikshme, kokëfortësisë, kapriçove dhe të tjera të ngjashme me këto. Pra, me fjalë të tjera, duhen shmangur me çdo kusht moskokëçarjet, armiqësitë,

zënkat, sepse të parët, që dëmtohem nga këto sjellje jo të drejta, jemi ne duke ia mohuar vetes dhuratën e lidhjes shpirtërore.

Përfundimi për sa thamë më lart është se mjedisi familjar është një mjedis i shenjtë, ku secili, burri dhe gruaja duhet të ndihmojnë njëri-tjetrin dhe veten në eliminim e defekteve të ndryshme që mund të ketë. Rruga më e mirë në këtë drejtim për të dy është se me shpirtmadhësi dhe thjeshtësi të falin gabimet dhe pakujdesitë e tjetrit, duke e ndihmuar atë në perfeksionimin e tij. Asnjëherë nuk duhet lejuar që gabimet tona të njihen si të pafajshme, si nga vetë ne, edhe nga të tjerët.

Së fundi, duhet të përpiqeni që të krijohet lumturia dhe gëzimi i tjetrit, në mënyrë që lidhja shpirtërore të thellohet dalëngadalë.

